



Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë 2010-2015

Raport studimi





REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEKNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE AND TECHNOLOGY



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

*Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat e mesme
profesionale në Kosovë, 2010-2015*

Raport studimi



Prishtinë, 2015



Autorë të raportit

Haxhere Dervisholli - Zylfiu, udhëheqëse e projektit
Ismet Potera, bashkëpunëtor profesional
Ramadan Alija, bashkëpunëtor i jashtëm

Ekipi hulumtues:

Binak Gerguri
Irir Morina
Shaip Hasani

Lektor:

Bekim Morina

Falënderime

Falënderojmë të gjithë ata që mundësuan dhe dhanë mbështetje të pakursyer në realizimin e studimit “Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë, 2010-2015”, pa ndihmën e të cilëve studimi nuk do të mund të realizohej dhe të përfundonte me suksesin e synuar!

Në veçanti falënderojmë të gjithë koordinatorët e AARr-së, vijuesit, mësimdhënësit, udhëheqësit e shkollave, përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave për informacionin dhe bashkëpunimin e ofruar për realizimin e studimit!

Përmbajtja:

Lista e shkurtesave:	6
Tabela dhe figura:	7
I. PËRMBLEDHJE.....	8
II. HYRJE	13
2.1. Arsyeja e studimit.....	13
2.2. Qëllimi dhe objektiva e studimit.....	14
2.3. Metodologjia e studimit	14
2.5. Organizimi i studimit.....	16
III. ARSIMI DHE AFTËSIMI I TË RRITURVE NË LEGJISLACIONIN AKTUAL NË KOSOVË.....	18
IV. TË DHËNAT PËR PROGRAMET E ARSIMIT FORMAL PËR TË RRITUR NË SHKOLLAT E AAP-SË ...	27
4.1. Të dhënat e përgjithshme për 36 shkollat e AAP-së	27
4.2. Të dhënat e specifikuar për 15 shkollat e AAP-së	30
V. PRAKTIKAT E INSTITUCIONEVE PËRKATËSE PËR REALIZIMIN E AARr-SË NË SHKOLLAT PROFESIONALE NË KOSOVË.....	34
5.1. Opinionet e koordinatorëve, mësime të mësimdhënësve dhe vijuesve të mësimin për të rritur për specifikat e mësimin për të rritur në shkollat e tyre.....	34
5.1.1. Të dhënat bazë për mostrën e përfshirë në anketim.....	34
5.1.2. Roli i koordinatorëve të AARr-së, zhvillimi profesional dhe detyrat e tyre të punës.....	36
5.1.3. Përzgjedhja e stafit të mësime të mësimdhënësve për AARr	37
5.1.4. Format e realizimit të programeve të AARr-së.....	38
5.1.5. Informimi i vijuesve lidhur me programin e AARr-së	39
5.1.6. Planet dhe programet si dhe tekstet / materialet mësimore në programet e AARr-së	39
5.1.7. Bashkëpunimi/komunikimi mësime të mësimdhënës/vijues në programet e AARr-së.....	41
5.1.8. Praktika profesionale në programet e AARr-së.....	42
5.1.9. Matja dhe vlerësimi i rezultateve mësimore në programet e AARr-së.....	42
5.1.10. Vlerësimi i përparësive/mangësive dhe sfidave për realizimin e programeve të AARr-së	43
5.2. Opinionet e përfaqësuesve të institucioneve arsimore për aspekte të caktuara të AARr-së....	47
5.2.1. Struktura e mostrës së përfshirë në intervistë	47
5.2.2. Legjislacioni aktual që rregullon organizimin dhe realizimin e AARr-së.....	48
5.2.3. Akreditimi i shkollave të AAP-së.....	48
5.2.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional për realizimin e AAP-së dhe AARr-së	49
5.2.5. Roli dhe detyrat e koordinatorit të AARr-së.....	51
5.2.6. Angazhimi i mësime të mësimdhënësve në programet e AARr-së.....	52

5.2.7. Regjistrimi i vijuesve në AARr.....	52
5.2.8. Dokumentacioni i brendshëm shkollor për realizimin e AARr-së.....	53
5.2.9. Tekstet dhe materialet mësimore për realizimin e AARr-së.....	54
5.2.10. Format e realizimit të AARr-së.....	54
5.2.11. Pagesat për shërbimet dhe angazhimet në AARr.....	54
5.2.12. Shkollat model për realizimin e AARr-së	57
5.2.13. Njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në programet e AARr-së	57
5.3. Raportet e inspektorëve të arsimit, të nivelit rajonal për AARr-në	59
VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	62
6.1. Përfundime	62
6.2. Rekomandime	72
Literatura:	76
SHTOJCA. Tabela nga rezultatet e hulumtimit në shkollat e AAP-së	78

Lista e shkurtesave:

AAAPARr	Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AARr	Arsimi dhe Aftësimi i të Rriturve
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DVV International	Bashkësia e Shkollave të Larta Popullore Gjermane
IAAPRr	Institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KM	Këshilli i Mësimdhënësve
KN	Këshilli i Nxënësve
KP	Këshilli i Prindërve
LAAP	Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
LAARr	Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve
LAP	Ligji për Arsimin Parauniversitar
LMSH	Ligji për Maturën Shtetërore
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
SIA	Sistemi i Inspektimit Arsimor
SMIA	Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim
ECDL	Patenta Evropiane për përdorimin e kompjuterit (European Computer Driving Licence)

Tabela dhe figura:

Figura 1. Shpërndarja e mostrës së studimit.

Figura.2. Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2014.

Figura 3. Numri i vijuesve të AARr-së në 19 komuna.

Figura 4. Numri i vijuesve sipas viteve të regjistrimit.

Figura 5. Përqindja e të diplomuarve në programin e AARr-së.

Figura 6. Trendët e përfundimit të testit të maturës/diplomimi i vijuesve.

Figura 7. Përqindja e gjinisë në 15 shkollat e përfshira në mostër.

Figura 8. Përqindja e vijuesve nga e njëjta shkollë

Figura 9. Suksesimi i vijuesve në AARr.

Figura 10. Angazhimi i mostrës së mësimdhënësve në lëndët specifike dhe funksionet e tjera në shkollë.

Figura 11. Arsye për kalim të vijuesve nga mësimi i rregullt në mësimin për të rritur.

Figura 12. Format e realizimit dhe komunikimit në program.

Figura 13. Format e informimit të vijuesve për aspekte të AARr-së.

Figura 14. Planet dhe programet mësimore në AARr.

Figura 15 . Tekstet dhe materialet mësimore në AARr.

Figura 16. Bashkëpunimi/komunikimi mësimdhënës/vijues.

Figura 17. Praktika profesionale (PP) në AARr.

Figura 18. Kushtet e shkollave për realizimin e AARr-së.

Tabela 1. Mostra e përfshirë në anketim

Tabela 2. Mostra e përfshirë në intervistë

Tabela 3. Numri i vijuesve të AARr-së në 36 shkollat e AAP-së

Tabela 4. Gjithsej vijues në 36 shkolla profesionale që kanë përfunduar provimin e maturës

Tabela 5. Profilet profesionale të ofruara nga shkollat në AARr

Tabela .6 Numri i vijuesve dhe gjinia e tyre në 15 shkollat e përfshira në hulumtim

Tabela 7. Moshë e vijuesve të përfshirë në AARr

Tabela 8. Numri i vijuesve nga e njëjta shkollë

Tabela 9. Viti i regjistrimit në AARr

Tabela 10. Suksesimi i vijuesve nga shkollimi paraprak/suksesimi hyrës në AARr

Tabela 11. Pritja nga përfundimi i shkollimit/klasës paraprake deri në regjistrimin në AARr

Tabela 12. Klasa paraprake e përfunduar para regjistrimit në AARr

Tabela 13. Klasa e regjistruar në AARr

Tabela 14. Profilet e vijuar para regjistrimit të vijuesve në AARr

Tabela 15. Profilet e vijuar në programin e AARr-së

Tabela 16. Suksesimi i vijuesve në AARr

Tabela 17. Klasa e përfunduar në AARr në shkollën përkatëse

Tabela 18. Numri i të çertifikuarve në nivelet përkatëse në AARr

Tabela 19. Matura/diplomimi i vijuesve

Tabela 20. Moshë dhe përvoja e punës e mostrës

Tabela 21. Zhvillimi profesional/trajnimet e mostrës mësimdhënësve dhe koordinatorëve

Tabela 22. Viti i regjistrimit të vijuesve në AARr dhe klasa aktuale

Tabela 23. Arsye të regjistrimit të vijuesve në AARr

Tabela 24. Detyrat e koordinatorëve të AARr-së

Tabela 25. Vlerësimi i vijuesve për pranim në program

Tabela 26. Format e realizimit dhe komunikimit në program

Tabela 27. Informimi i vijuesve për aspektet të AARr-së

Tabela nr. 28. Planet dhe programet mësimore në AARr

Tabela 29. Bashkëpunimi/komunikimi mësimdhënës/vijues

Tabela 30. Praktika profesionale e vijuesve

Tabela 31. Instrumentet e matjes dhe vlerësimit në program

Tabela 32. Vlerësimi përfundimtar i vijuesve

I. PËRMBLEDHJE

Raporti i hulumtimit “*Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale të Kosovës, 2010-2015*” paraqet një analizë të realizimit të programeve të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur në AAP dhe rezultatet e arritura në këtë nënsektor.

Hulumtimi është realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) në mbështetje financiare nga ‘DVV International’. Rezultatet e studimit dhe rekomandimet e dalta nga ky studim synojmë të shërbejnë si një bazë orientuese për avancimin e këtyre programeve në të ardhmen. Hulumtimi u realizua në periudhën mars-korrik 2015. Popullacionin e studimit e përbëjnë vijuesit, mësimdhënësit, koordinatorët dhe udhëheqësit e shkollave profesionale, të cilat në periudhën 2010-2015 kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur. Për mostër të studimit janë marrë respondentë nga 15 shkolla profesionale (përfshirë edhe Qendrat e kompetencës) të 10 komunave të Kosovës: Prishtinë, Podujevë, Pejë, Prizren, Malishevë, Gjilan, Dardanë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Lipjan. Kriteri për përzgjedhjen e shkollave dhe mostrës përfaqësuese ka qenë të përfshihen shkollat të cilat në periudhën 2010-2015 kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësimin për të rritur. Mostra e përfshirë në hulumtimin në terren përbëhet nga 284 respondentë (përfaqësues të institucioneve arsimore, udhëheqës të shkollave, mësimdhënësit, koordinatorë dhe vijues të programeve të AARr-së). Rezultatet e studimit janë të përmbledhura në gjashtë pjesë kryesore të raportit dhe në shtojcën dhe pjesët plotësuese.

Kapitulli II - Hyrja, paraqet arsyen e studimit, qëllimin dhe objektivat e studimit, fushat kryesore të hulumtuara dhe metodologjinë e zbatuar.

Kapitulli III - Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në legjislacionin aktual në Kosovë, paraqet bazën legjislative të rregullimit të organizimit dhe realizimit të AAP-së dhe AARr-së në Kosovë, në mënyrë specifike organizimin dhe realizimin e programeve të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur në shkollat e AAP-së në Kosovë.

Kapitulli IV – Të dhënat për programet e mësimin formal për të rritur në AAP, prezanton të dhënat e përgjithshme për 36 shkollat e AAP-së, të cilat në periudhën 201-2015 kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur, dhe të dhënat e specifikuar për 15 nga 36 shkollat e AAP-së të përfshira në mostër të studimit.

Kapitulli V - Praktikave të institucioneve përkatëse për realizimin e programeve të AARr-së në shkollat profesionale në Kosovë, prezanton gjetjet për praktikave, format e organizimit dhe bashkëpunimit lidhur me realizimin e programeve të mësimin për të rritur në shkollat profesionale të Kosovës.

Kapitulli VI - Përfundime dhe rekomandime, prezanton përfundimet lidhur me specifikat e programeve të mësimin për të rritur, të realizuar në shkollat e AAP-së, në periudhën 2010-2015, si dhe rekomandimet për avancim të praktikave të organizimit dhe realizimit të programeve të AARr-së në të ardhmen.

Shtojca përfshin të dhënat e detajuara lidhur me mostrën e studimit, tabelat me rezultatet specifike lidhur me statistikat e shkollave për AARr-në dhe përgjigjet e respondentëve për aspekte të trajtuara në hulumtim.

Të gjeturat më të rëndësishme nga studimi për programet e arsimit dhe aftësimin formal të të rriturve janë përmbledhur në pjesën në vijim.

1. Arsimi dhe aftësimi profesional i të rriturve në legjislacionin aktual në Kosovë tregon se rregullimi i sektorit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe Arsimit dhe Aftësimin të të Rriturve (AARr) i nënshtrohet legjislacionit aktualisht në fuqi në Kosovë, përfshirë ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë, rregulloret dhe dokumentacionin përcjellës. Në periudhën 2010-2015 janë rishikuar ligje dhe janë hartuar akte nënligjore që rregullojnë AARr-në.

Ka ende mangësi në plotësimin e legjislacionit që rregullon proceset në AARr sa i përket mbledhjes dhe shfrytëzimit të të hyrave vetjake në shkolla. Deri më tani, rregullimi i pagesave për shërbimet e ofruara në program është bazuar në *Rregulloren për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake*, e cila është hartuar nga MASHT-i në vitin 2004, por që nuk është ende e miratuar nga institucionet përkatëse.

Përveç ligjeve dhe udhëzimeve administrative, nga MASHT -i dhe partnerë bashkëpunues janë hartuar edhe dokumente të tjera strategjike mbështetëse të proceseve për këtë nënsektor të arsimit, si Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT 2011, *dhe Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016*, MASHT 2011.

Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim (SMIA) për regjistrimet e nxënësve në vitin shkollor 2011/12 deri në 2014/15 nxjerr në pah një rënie të lehtë të përfshirjes së nxënësve në AAP. Ky sistem nuk ka hapësirë të veçantë për evidentimin e përfshirjes në programet e mësimin formal të të rriturve në AAP.

Rezultatet e studimit të realizuar informojnë se përfaqësuesit e DKA-ve dhe të shkollave nuk janë edhe aq të informuar dhe familjarizuar me legjislacionin aktual në fuqi që rregullon aspekte të AARr-së.

2. Statistikat për vijuesit e AARr-së për periudhën 2010-2015 informojnë se programe të arsimit formal me të rriturit janë realizuar në 6 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Ferizaj, të përfaqësuara me 19 komuna dhe 36 shkolla profesionale nga komunat përkatëse.

Numri i vijuesve të programeve të arsimit formal për të rritur në 36 shkolla të AAP-së ka qenë **15535**, ndërsa të diplomuar gjithsej 3267 vijues ose 21%.

Në 15 shkollat e përfshira në mostër të studimit, numri vijuesve të programeve të arsimit formal për të rritur në periudhën 2010-2015 ka qenë **6085**, femra 34,9%, mosha me përqindje më të madhe ka qenë ajo 21-30 vjeç. Vijues të moshës 15-17 vjeç kanë qenë 16,31%, vijues që vijnë nga e njëjta shkollë gjithsej rreth 23,1%. Numri më i madh i vijuesve ka qenë në vitin shkollor 2013/14, me 23,7%, suktesi nga shkollimi paraprak me përqindje më të lartë ka qenë i mjaftueshëm me 29,3%, pritjet më të gjata për regjistrim në AARr kanë qenë 2 deri 5 vite me 19,1%. Kemi edhe vijues të AARr-së që nuk kanë pritur asnjë vit për kalim nga mësimi i

rregullt në AARr (12,8%), numër më të madh të vijuesve kemi prej atyre që paraprakisht e kanë përfunduar klasën e tetë ose nëntë (44,3%). Rezultatet e treguara në AARr janë kryesisht të mjaftueshme me 33,6%. Vijues të diplomuar në 15 shkollat mostër të studimit janë 1464 ose 24,1%, ndërsa përqindje më të lartë të të diplomuarve kemi në vitin 2013, me 42,6%.

Shkollat e përfshira në studim i shfrytëzojnë librat amë për evidenca në AARr, të ngjashme me ato në mësimin e rregullt. Ka mangësi në plotësimin e librave amë nga shkollat me të dhënat për vijuesit.

Raportimi i statistikave për vijuesit nga shkollat në DKA është i rregullt, përderisa raportimi nga shkollat në MASHT zakonisht bëhet me rastin që MASHT-i kërkon këto statistika. DKA-ja dhe MASHT-i nuk kanë statistika për programet e arsimit formal në AAP, për nevojat e studimit, ndërsa statistikave për vijuesit janë marrë nga IPK-ja drejtpërdrejt në shkollat përkatëse. Ka mangësi në respektimin e plotë të legjislacionit përkatës sa u përket disa specifikave për AARr-në, si kriteri i moshës për regjistrim në AARr, kriteri i kalimit nga mësimi i rregullt në AARr, mbajtja e evidencave për programet etj.

3. Praktikat e institucioneve përkatëse për realizimin e programeve të AARr-së në shkollat profesionale në Kosovë informojnë se rregullimi i AAP-së dhe AARr-së bazohet në legjislacionin në fuqi. Më të familjarizuar me legjislacion janë përfaqësuesit e institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal (MASHT, DKA dhe AAAPARr), përderisa nga përfaqësuesit e shkollave me legjislacion arsimor nënkuptohet ndonjëherë edhe dokumentacioni shkollor, si librat amë, librat e klasave, planet dhe programet mësimore etj.

Realizimit të programeve të AARr-së nuk i ka paraprirë ndonjë analizë e tregut të punës dhe identifikimit të nevojave për profile profesionale. Shkollat e AAP-së që kanë kushte të mira kadrovike dhe hapësirë të përshtatshme mund të ofrojnë programe të AARr-së, varësisht nga kërkesat e komunave, ndërsa MASHT-i vetëm informohet për këto programe.

Shkollat ofrojnë AARr dy herë në vit, ndërsa një vit shkollor zgjat 18 javë, konkursin e harton shkolla dhe publikohet në shkollë dhe në DKA. Në disa raste ka paqartësi në përgjegjësitë dhe rolet e shkollave dhe DKA-ve me rastin e konkursit. Procedurat për pranim të vijuesve janë të njëjta me ato të pranimit të nxënësve në mësimin e rregullt. Nuk ka kriteret e unifikuar për pranim në AARr.

Në shkollat përkatëse janë angazhuar koordinatorë të mësimit për të rritur, por pozita, roli, mandati dhe detyrat e tyre nuk janë të rregulluara me legjislacion, vendim, rregullore ose marrëveshje të veçantë. Roli dhe detyrat përshkruhen si të barabarta me ato të një kujdestari klase.

Mësimdhënësit e angazhuar në AARr janë mësimdhënës të angazhuar në mësimin e rregullt në shkollën përkatëse dhe nuk ka ndonjë kriter të shkruar për angazhimin e tyre, zakonisht për këtë vendos drejtori i shkollës. Me rëndësi është që të përfshihen të gjithë mësimdhënësit e interesuar, me rrotacion.

Programet e AARr-së realizohen zakonisht ditëve të punës, pas orarit të mësimit të rregullt, ose të shtunave. Në lëndët e përgjithshme mbahen orë mësimore (mësim i rregullt), ndërsa në lëndët profesionale realizohen konsultime me vijuesit. Komunikimi i vijuesve me shkollën/mësimdhënësit ndodh zakonisht në shkollë dhe shumë pak është i shprehur komunikimi/informimi përmes e-mailëve, telefonit etj.

Shkollat nuk kanë plan zhvillimor për arsimin formal të të rriturve të integruar në PZSHSH-në e shkollës, përderisa shumica e shkollave kanë plan vjetor të punës për AARr-në, i cili është i hartuar veçmas.

Planet dhe programet mësimore janë të njëjta me ato të mësimit të rregullt dhe për nevojat e AARr-së këto plane dhe programe reduktohen, përshtaten për kohën në dispozicion. Zakonisht mësimdhënësit e lëndëve përkatëse i hartojnë/përshtatin këto plane dhe programe.

Ka mungesë të teksteve dhe materialeve mësimore dhe zakonisht shfrytëzohen ato pak tekste dhe materiale mësimore që janë në dispozicion edhe për mësimin e rregullt. Ka raste kur mësimdhënësit përgatisin materiale të shtypura dhe i shpërndajnë ato te vijuesit.

Shkollat nuk kanë bashkëpunim të ndërsjellë për hartimin e planeve dhe programeve dhe shkëmbimin e teksteve dhe materialeve mësimore, nuk kanë mbështetje nga DKA-të përkatëse dhe mësimdhënësit nuk kanë vijuar ndonjë program trajnimi për harmonizimin e planeve dhe programeve dhe materialeve mësimore me nevojat e AAR-së.

Aktorët brendapërbrenda shkollës kanë bashkëpunim dhe komunikim të mirë sa i përket AARr-së, me DKA-të shkollat kanë komunikim më të lehtë dhe më të drejtpërdrejtë, edhe pse ky komunikim ndodh më tepër sa i përket mësimit të rregullt. Me MASHT-in komunikimi është më i mangët, meqenëse shkollat nganjëherë duhet të presin më gjatë për përgjigje nga MASHT-i. Bashkëpunimi i shkollave me bizneset për praktikën profesionale rezultojnë të jetë akoma sfidë edhe për mësimin e rregullt, ndërsa vijuesit e AARr-së pak janë pjesë e kësaj praktike në biznese dhe kompani, PP ata e realizojnë në laboratorët dhe punëtoritë e shkollave. Ka filluar bashkëpunimi i agjencisë me shkollat/Qendrat e Kompetencës që janë nën ombrellën e tij. Lidhur me AARr-në ka pasur vetëm konsultime dhe diskutime për format e realizimit, më intensivisht me AARr-në agjencia do të merret në të ardhmen.

Ka përparësi sa i përket realizimit të programeve të AARr-së në AAP. Shkollat tanimë e kanë një përvojë të mirë në realizimin e këtyre programeve, ka kushte të infrastrukturës dhe të kuadrove. Duhet punuar më tepër në plotësimin e legjislacionit dhe në rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të avancimit të programeve të AARr-së në shkolla.

4. Raportet e inspektorëve rajonalë të arsimit i referohen organizimit dhe realizimit të AAP-së dhe AARr-së që nga viti 2007/2008 deri në vitin 2015 (periudhë gati dhjetëvjeçare e raportimit). Nuk ka një formë të unifikuar të raportimit, prandaj ndryshon struktura dhe forma e raportimit. Gjetjet e prezantuara në raportet e inspektimit nuk përputhen me gjetjet e Institutit Pedagogjik të Kosovës lidhur me numrin e vijuesve dhe specifikat e tjera të AARr-për shkollat përkatëse dhe referuar periudhës së njëjtë kohore. Për të dhënat e ofruara në raportet e inspektorëve arsimorë nuk figuron pjesa e metodologjisë së grumbullimit dhe përpunimit të të

dhënave dhe mbetet të ofrohen sqarime nga shkollat (burimi i informacionit) dhe inspektorët (përpunuesit) për saktësinë e të dhënave.

Me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të aspekteve që kanë të bëjnë me programet e AARr-së në shkolla, IPK-ja ka dhënë edhe rekomandime orientuese për institucionet dhe aktorët e përfshirë në këtë proces. Rekomandimet e dhëna orientohen në:

- Plotësimin e legjislacionit që rregullon AARr-në dhe informimin/familjarizimin e aktorëve me legjislacion;
- Përmirësimin e praktikave të shkollave për mbajtjen e evidencave lidhur me programet e AARr-së dhe analizën, raportimin e tyre;
- Vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të AARr-së dhe raportimi i gjetjeve,
- Hartimin e strategjive zhvillimore për AARr-në bazuar në të dhëna;
- Inicimin e bashkëpunimit në mes të të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, koordinimin e aktiviteteve lidhur me AARr-në;
- Përmirësimin e praktikave të shkollave për të gjitha aspektet e AARr-së;
- Etj.

II. HYRJE

Studimi “Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale të Kosovës, 2010-2015” analizon praktikat e shkollave profesionale për realizimin e arsimit dhe aftësimin formal për të rriturit, për periudhën 2010-2015. Studimi është realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës, me mbështetje financiare nga ‘DVV International’.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë informacione për institucionet e arsimit në Kosovë dhe partnerët e tjerë që merren me fushën e AAP-së dhe AARr-së në Kosovë, lidhur me: (a) Legjislacionin në fushën e AAP-së dhe AARr-së, (b) statistikat e përfshirjes së vijuesve në programet e AARr-së, (c) praktikat e shkollave në realizimin e programeve të arsimit formal për të rriturit, (ç) rekomandimet për avancimin e këtyre programeve në të ardhmen.

Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion publik, hulumtues, kërkimor-shkencor, i themeluar nga MASHT-i, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Funkcionet e IPK-së janë analizat, hulumtimet, trajnimet, krahasimet dhe vlerësimet në arsimin parauniversitar në Kosovë. Këto aktivitete realizohen si aktivitete të hulumtimit, në aspektin didaktik-metodik dhe në aspektin e trajnimit të personelit të shkollës, për zhvillimin e së cilave IPK-ja koordinohet me universitete dhe agjenci të tjera trajnuese, publike dhe private¹.

Asociacioni Gjerman për Arsimimin e të Rriturve (DVV) bashkon rreth një mijë qendra të arsimit, të quajtura "Volks-hochschulen" (shkolla të larta popullore) në Gjermani. Instituti për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Bashkësisë së Shkollave të Larta Popullore Gjermane (‘DVV International’) ndihmon në modernizimin e strukturave të arsimit për të rritur në përgjithësi dhe arsimit dhe trajnimit profesional, si dhe në shpërndarjen e politikës së BE-së për të mësuarit gjatë gjithë jetës, në disa vende në mbarë botën. Si rezultat, ata e mbështesin procesin e përshtatjes me standardet e BE-së dhe ndihmojnë përgatitjen e këtyre vendeve për t'u integruar në BE. Parimet kryesore të ‘DVV International’ janë:

- Punësimi: aftësi më të mirë konkurruese në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës;
- Toleranca: si një pikë kyçe për demokracinë dhe shoqërinë civile;
- Integrimi: një shans për të marrë pjesë në të gjitha aspektet e shoqërisë².

2.1. Arsyeya e studimit

Shkollat profesionale në Kosovë, përveç mësimin të rregullt me nxënës, të cilët kanë moshën për përfshirje në nivelin e arsimit të mesëm të lartë (klasa 10-12), realizojnë edhe programe të

¹ Informacioni i plotë për rolin, funksionin, strukturën dhe fushëveprimtarinë mund të gjendet në UA 10/2014 për Institutin Pedagogjik të Kosovës, MASHT, 2014 www.masht.rks-gov.net dhe në faqen zyrtare www.ipk-rks.net

² Informacioni për misionin, aktivitetet, projektet, kalendarin e aktiviteteve etj. lidhur me ‘DVV internacional’ mund të gjendet në faqen zyrtare të organizatës www.dvv-soe.org

arsimit dhe aftësimin formal për të rriturit, moshën e të cilëve është më e madhe se moshën e paraparë në Ligjin për arsimin parauniversitar për të ndjekur këtë nivel arsimor. Qëllimi i arsimit dhe i aftësimin të të rriturve është zhvillimi i shkathtësive, njohurive dhe parimeve të duhura të të rriturit, si pjesë e kornizës së të mësuarit gjatë gjithë jetës (LAP: MASHT, 2011).

Në vitin 2009, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) ka realizuar hulumtimin „*Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale të Kosovës, 2004-2008*”, mbështetur po nga ‘DVV International’, në të cilin ka përfshirë hulumtimin e aspekteve të përgjithshme të statistikave, ofertave programore të shkollave profesionale, kushteve të përgjithshme të shkollave për realizimin e këtyre programeve, si dhe përgatitjen/zhvillimin profesional të mësuesve për punën me të rriturit. Rezultatet e studimit janë të publikuara nga IPK-ja në përmbledhjen e punimeve ‘*Kërkime Pedagogjike*’, në vitin 2010 (Haxhere Zylfiu & Binak Gerguri, 2010).

Meqenëse nga viti 2010 e këndej në sektorin e AAP-së janë zhvilluar ndryshime në aspektin e legjislacionit dhe janë realizuar reforma në këtë nënsektor, të përcjella me ndryshime edhe në praktikën e realizimit të programeve të arsimit dhe aftësimin për të rriturit, IPK-ja ka vlerësuar nevojën e hulumtimit të këtyre praktikave.

2.2. Qëllimi dhe objektiva e studimit

Realizimi i studimit “*Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë, 2010-2015*” ka për qëllim hulumtimin e praktikave të realizimit të programeve me të rriturit në shkollat profesionale të Kosovës, në periudhën 2010-2015, me objektiva specifike të hulumtimit të orientuara në evidentimin e:

- Legjislacionit që rregullon fushën e AAP-së dhe AARr-së;
- Trendëve të përfshirjes në programet e arsimit formal për të rritur në shkollat profesionale në Kosovë;
- Praktikave të shkollave në realizimin e këtyre programeve;
- Përfshirjen e të rriturve dhe rezultatet e tyre në testin e Maturës Shtetërore;
- Rekomandimeve për avancimin e programeve për të rritur në shkollat profesionale në Kosovë.

Hulumtimi u realizua në periudhën shkurt - korrik të vitit 2015.

2.3. Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit konsiston në një kombinim të qasjes sasore dhe cilësore, e cila u realizua përmes studimit kabinetik dhe studimit në terren. Përmes studimit kabinetik u realizua analiza e dokumenteve legjislative dhe atyre shkollorë dhe materialeve/dokumenteve përcjellëse. Ndërsa, përmes studimit në terren u administruan teknikat dhe instrumentet e studimit, si pyetësori i anketës, pyetësori i intervistës dhe u organizuan diskutimet me fokus-grupe.

Metodat dhe teknikat e përdorura

Për të realizuar studimin, u përdorën metoda e analizës së dokumentacionit, metoda përshkruese, metoda krahasuese dhe metoda e analizës statistikore, si dhe teknikat e anketimit, intervistës dhe e fokus-grupit.

Analiza e dokumenteve. Përfshiu analizën e kornizës ligjore që adreson fushën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, si dhe Arsimit dhe Aftësimin të të Rriturve, si: ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret e ndryshme dhe dokumentet përcjellëse, dokumentacionin shkollor, raportet e zyrave rajonale të inspektimit në arsim, raportet e studimeve dhe informacione plotësuese për fushën.

Analiza e statistikave u realizua përmes hartimit dhe plotësimit të dy platformave elektronike lidhur me programet e AARr-së: (1) platforma e parë përfshin të dhënat e përgjithshme për AARr-në në të gjitha shkollat profesionale, të cilat në periudhën 2010-2015 kanë realizuar programe të mësimin formal me të rriturit. U hartua nga IPK-ja, ndërsa u plotësua nga shkollat përkatëse³; (2) platforma e dytë përfshin të dhënat e specifikuar për AARr-në në 15 shkollat e përfshira në cilësinë e mostrës së studimit. U hartua nga IPK-ja dhe u plotësua nga koordinatorët e AARr-së në shkollat përkatëse, nën mentorimin dhe monitorimin e IPK-së. Bazë dhe burim i të dhënave për plotësimin e platformave u shfrytëzuan librat amë të shkollave dhe dokumentet përcjellëse, ndërsa përpunimi i të dhënave të të dy platformave u realizua nga IPK-ja në programin 'Excel-Pivot Table'. Vlen të përmendet që raporti i IPK-së u referohet kandidatëve të regjistruar në program në vitet përkatëse, nuk ka përsëritje, një kandidat mund të figurojë i regjistruar vetëm në një vit shkollor, i njëjti nuk përsëritet në vitet vijuese.

Anketimi. Anketimi u realizua përmes pyetësorëve që u realizuan me koordinatorët, mësimdhënësit dhe vijuesit e programeve, përmes të cilëve u morën informacionet për aspekte të AARr-së në këto shkolla.

Intervistimi. Me ndihmën e pyetësorit të intervistës u realizuan intervista me udhëheqësit e shkollave të përfshira në studim (drejtorët, zëvendësdrejtorët ose sekretarët e shkollave), me përfaqësues të DKA-ve, si dhe me përfaqësues të MASHT-it, Agjencisë për AAP-në dhe AARr-në, si dhe përfaqësues të AKK-së.

Punëtori me fokus-grupin. U realizuan dy takime me koordinatorët e programeve të mësimin për të rritur në shkollat e përfshira në studim. Në punëtori u diskutuan aspekte që kanë të bëjnë me AARr-në në shkollat përkatëse, si dhe u mbështetën koordinatorët në përpunimin e të dhënave statistikore, analizën dhe raportimin e tyre.

³ Planifikimi i IPK-së ka qenë që informacioni i përgjithshëm për AARr-në të sigurohet nga DKA-të përkatëse. Hulumtimi në terren evidentoi se DKA-të posedojnë vetëm informacionin se cilat shkolla kanë realizuar programe të AARr-së në komunën përkatëse, listën e së cilave e ofruan në IPK, por ato nuk posedojnë asnjë informacion për numrin e vijuesve, profilet profesionale të realizuara me ta, diplomimin e vijuesve dhe specifika të tjera për këto programe. Të gjitha të dhënat e nevojshme për hulumtim u siguruan nga IPK-ja drejtpërdrejt në shkollat përkatëse.

2.4. Popullacioni dhe mostra

Popullacionin e studimit e përbëjnë vijuesit, mësimdhënësit, koordinatorët dhe udhëheqësit e shkollave profesionale, të cilat në periudhën 2010-2015 kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësisimit formal për të rritur. Për mostër të studimit janë marrë respondentë nga 15 shkolla profesionale (përfshirë edhe Qendrat e kompetencës) të 10 komunave të Kosovës: Prishtinë, Podujevë, Pejë, Prizren, Malishevë, Gjilan, Dardanë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Lipjan. Kriteri për përzgjedhjen e shkollave dhe mostrës përfaqësuese ka qenë të përfshihen shkollat të cilat në periudhën 2010-2015 kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësisimit për të rritur. Është planifikuar që në studim nga secila shkollë të përfshihen 10 vijues, 10 mësimdhënës, udhëheqësi aktual i shkollës dhe koordinatori i programit të AARr-së, ndërsa kriteri për përzgjedhjen e koordinatorëve, mësimdhënësve dhe vijuesve ka qenë që ata të kenë qenë të angazhuar/ përfutues në programet e AARr-së në këto shkolla në periudhën 2010-2015. Pas përfundimit të hulumtimit në terren, është identifikuar se mostra e përgjithshme e studimit është përbërë nga 284 respondentë, me shpërndarje si në figurën nr. 1.




Figura 1. Shpërndarja e mostrës së studimit.

Informacione më të detajuara lidhur me mostrën e përfshirë në studim mund të gjenden në tabelat nr. 1 dhe 2, në shtojcën nr. 1 në raport.

2.5. Organizimi i studimit

Organizimi i studimit në terren është bërë në periudhën prill–maj 2015. Studimi në terren u realizua gjatë ditëve të punës dhe vikendeve, për shkak të specifikave të mostrës së zgjedhur, sidomos për faktin se mësimi me të rriturit në disa shkolla është realizuar gjatë ditës së shtunë. Për realizimin e anketës, paraprakisht u përcaktuan shkollat përfaqësuese për secilin rajon, u kontaktuan ato përmes telefonit dhe e-mailit dhe u dakorduan për datat e vizitave në shkolla.

Realizimi i intervistës me përfaqësuesit e përfshirë i parapriu përgatitja e listës me të dhënat e tyre, pastaj u kontaktuan ata përmes telefonit dhe e-mailit, u dakorduan për datën, kohën dhe vendin e realizimit të intervistave.

Realizimit të analizës statistikore të të dhënave i parapriu përpilimi i platformës elektronike në programin Excel, kërkesat e së cilës u bazuan kryekëput në rubrikat e librit amë për specifikat e vijuesve, si: gjinia, moshë, vendi, shkolla, shkollimi paraprak, viti i regjistrimit, profili, certifikimi, diplomimi, etj. Të dhënat për këto specifika u bartën nga libri amë në këtë platformë, dhe pastaj me veprimet që mundëson programi 'Pivot Table' u nxorën të dhënat, u krahasuan dhe raportuan gjetjet në formë të tabelave numerike dhe grafikëve përkatës.

Takimi me fokus-grupin e koordinatorëve është realizuar në njërin nga shkollat e përfshira në studim, gjegjësisht në kabinetin e informatikës në kuadër të shkollës, dhe koordinatorët patën mundësinë të punojnë drejtpërdrejt në kompjuterët e shkollës për bartjen dhe përpunimin e të dhënave në programin 'Excel-Pivot Table'.

Analiza e të dhënave

Gjetjet e dala nga analiza e dokumenteve të konsultuara fillimisht janë evidentuar, shqyrtuar e diskutuar me ekipin hulumtues dhe pastaj në raport janë përfshirë gjetjet kryesore, që lidhen me kontekstin e AARr-së.

Të dhënat kualitative të intervistave janë nxjerrë në bazë të një modeli të përgatitur me konceptet bazë të kërkesave/pyetjeve të intervistës dhe temave të studimit për të arritur në përfundime të përbashkëta lidhur me çështjet specifike dhe për të nxjerrë dallimet ekzistuese në pasqyrimin e pikëpamjeve të respondentëve të përfshirë në studim.

Të dhënat kuantitative nga pyetësorët janë analizuar me programin kompjuterik SPSS, programin për statistika në shkencat sociale, dhe ato janë raportuar dhe përmbledhur në aspektin e të dhënave numerike dhe në aspektin e përqindjeve.

III. ARSIMI DHE AFTËSIMI I TË RRITURVE NË LEGJISLACIONIN AKTUAL NË KOSOVË

Rregullimi i Sektorit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe nënsektorit të Arsimit dhe Aftësimin të të Rriturve (AARr) i nënshtrohet politikave arsimore në fuqi në Kosovë, përfshirë ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë, rregulloret dhe dokumentacion përcjellës. Në vitet e fundit, reformat në arsimin parauniversitar, si hartimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (2011), miratimi i Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011), procesi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe licencimi i tyre etj., shtruan nevojën për rishikimin e disa prej dokumenteve legjislativë që rregullojnë sistemin arsimor në Kosovë, në përgjithësi, përfshirë edhe arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, i rishikuar dhe miratuar në vitin 2011, ka për qëllim të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.

Arsimi i mesëm i lartë, sipas ligjit, fillon që nga mosha pesëmbëdhjetëvjeçare, zgjat tre vjet dhe përfshin gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit, varësisht nga kurrikulumin i përcaktuar nga ministria. Arsimimi dhe aftësimi i të rriturve, sipas ligjit, përfshin mësimin dhe aftësimin publik dhe privat që ofrohet për të rriturit dhe për fëmijët e moshës mbi pesëmbëdhjetë vjeç, që i plotësojnë kushtet për të vijuar programet mësimore të përcaktuara për të rritur (Neni 9), ndërsa qëllimi i arsimit dhe i aftësimin të të rriturve është zhvillimi i shkathtësive, njohurive dhe parimeve të duhura të të rriturit, si pjesë e kornizës së të mësuarit gjatë gjithë jetës (Neni 12).

Neni 12 i këtij ligji jep bazë për rregullimin e arsimit dhe aftësimin të të rriturve, sipas të cilit të rriturit mund të arsimohen ose aftësohen në institucionet e licencuara private, publike dhe të partneritetit të niveleve 3 dhe 4 të ISCED-it, sipas dispozitave të këtij ligji, me ndryshimet në vijim, të cilat specifikohen në një akt nënligjor:

- Përshtatja e kurrikulimit, vlerësimi i të mësuarit paraprak, kohëzgjatja e programeve, vijimi, vlerësimi dhe procedurat e tjera për të mësuarit e të rriturve;
- Caktimi i pagesave për vijim dhe kriteret e pranimit;
- Përcaktimi, në bazë të këshillave të Këshillit Shtetëror për Licencimin të Mësimdhënësve (KSHLM), i kualifikimeve për mësimdhënës, trajnerë, instruktorë, apo personel tjetër i përfshirë në arsimin dhe aftësimin profesional;
- Përcaktimi i kriterëve shtesë për licencimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimin, të cilat ofrojnë programe për arsimin dhe aftësimin e të rriturve;
- Financimi i institucioneve të arsimit dhe aftësimin për ofrimin e programeve efektive për arsimin dhe aftësimin e të rriturve (MASHT: LAP 2013, neni 12 - Dispozitat specifike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve).

Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, i miratuar në vitin 2008, ka për qëllim të rregullojë organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komunitet e Republikës së Kosovës (MASHT: LAK 2008). Ligji potencon përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve të Republikës së Kosovës në arsim. Sipas ligjit, kompetencat e komunave përfshijnë kompetencat e veçanta komunale në arsimin publik për nivelet parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, në pajtim me legjislacionin, procedurat dhe standardet e përgjithshme të përcaktuara lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore, regjistrimin dhe pranimin e nxënësve, punësimin e mësimitdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave, zgjedhjen e drejtorit dhe/ose zëvendës drejtorit të institucioneve edukativo- arsimore, regjistrimin, inspektimin e shëndetit publik dhe sigurisë dhe licencimin e institucioneve arsimore, pagesën e stafit menaxherial, si dhe të personelit tjetër të punësuar, trajnimin e edukatorëve dhe stafit tjetër profesional dhe mbikëqyrjen e procesit arsimor në institucionet arsimore (LAK, neni 5-kompetencat e komunave).

Ligji për Kualifikime Kombëtare, i miratuar në vitin 2008, ka për qëllim krijimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), të rregulluar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), ndërsa objektivat e ligjit janë:

- Të përmirësojë njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin formal dhe joformal;
- Të sigurojë se kualifikimet përmbushin nevojat e tregut të punës, ekonomisë dhe shoqërisë;
- Të rregullojë kualifikimet, vlerësimin dhe certifikimin, në bazë të cilësisë dhe standardeve;
- Të përmirësojë qasjen në vlerësim dhe njohjen e mësimit paraprak;
- Të bëjë sistemin e kualifikimeve fleksibil dhe transparent;
- Të përmirësojë mundësitë për përmirësim dhe transferimin për të gjithë (LKK, neni 1-Qëllimi dhe objektivat e ligjit).

Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, i rishikuar dhe miratuar në vitin 2013, ka për qëllim të rregullojë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës. Ligji rregullon strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional në Kosovë.

Fushëveprimtaritë e arsimit dhe aftësimin profesional sipas ligjit janë:

- Zhvillimi i kompetencave dhe aftësimi për punësim të individëve në përputhje me profesionin dhe karrierën e tyre, sipas kërkesave të tregut të punës;
- Krijimi i kulturës së përgjithshme dhe profesionale në pajtim me parimet e arsimit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimet ekonomike, shkencore dhe teknologjike;

- Njohja e kompetencave të individëve bazuar në standardet e profesioneve të nivelit përkatës (LAAP, neni 4 - Fushëveprimtaritë e arsimit dhe aftësimit profesional).

Sipas ligjit, institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional formal ofrojnë kualifikime dhe module të niveleve 3, 4 dhe 5 sipas Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare. Kualifikimet dhe modulet e arsimit të mesëm të lartë profesional janë të hapura për personat që kanë kryer arsimin e detyrueshëm ose kualifikimet ekuivalente me të. Sipas ligjit, MASHT-i themelon Këshillin për arsimin dhe aftësimin profesional dhe për të rritur (KAAPRr), me qëllim që të këshillojë në orientimin e përgjithshëm për politikën e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimin e të rriturve në Kosovë, dhe gjithashtu parasheh themelimin e Agjencisë për arsim dhe aftësim profesional dhe për të rritur, përgjegjësi e së cilës, përveç administrimit dhe udhëheqjes së institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe për të rritur (IAAPRr) lidhur me burimet financiare, objekteve ndërtimore dhe infrastrukturës të të gjitha institucioneve publike të AAP-së në administrimin e vet rregullativ, është edhe zhvillimi i burimeve njerëzore etj. (LAAP, MASHT - 2013).

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve, i rishikuar dhe i miratuar në vitin 2013, ka për qëllim të rregullojë tërësinë e proceseve për arsimimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor në Kosovë. Sipas ligjit, sistemi arsimor për të rritur përfshin arsimin dhe aftësimin formal, joformal dhe informal, i cili shpie në një kualifikim të bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe përmbush kriteret dhe standardet e parapara me legjislacionin në fuqi. I rritur sipas ligjit konsiderohet çdo person që i ka mbushur pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa kandidatët e AARr-së janë të gjithë ata persona mosha e të cilëve është më e madhe se mosha e paraparë në Ligjin për arsimin parauniversitar për të ndjekur një nivel arsimor (Neni 7).

Disa nga specifikat lidhur me AARr-në që ligji i sjell janë:

- Struktura e sistemit arsimor për të rritur, kriteret dhe standardet e parapara me legjislacionin në fuqi;
- Përkufizimi se çfarë ligji konsideron me *i rritur* dhe cilët janë kandidatët e mundshëm të AARr-së;
- Institucionet dhe palët me interes në analizën dhe planifikimin për zhvillimin e AARr-së;
- Struktura e organizimit dhe realizimit të AARr-së (Plani vjetor i punës dhe Plani zhvillimor i institucionit);
- Informimi publik/publikimi i programit formal për AARr-në;
- Regjistrimi i kandidatëve në programet për AARr-në, konkursi publik dhe kriteret për regjistrim;
- Certifikatat dhe diplomat që iu lëshohen kandidatëve në programet kompensuese dhe në arsimin e mesëm të lartë për të rritur;
- Njohja e mësimit paraprak bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- Vlerësimi i kandidatëve në institucionet ku organizohet AARr-ja,
- Dokumentacioni shkollor në AARr/ libri amë;

- Mekanizmat për organizimin, udhëheqjen dhe monitorimin e AAR-së brenda institucionit arsimor;
 - Kompetencat e MASHT-it për nxjerrjen e akteve nënligjore për të plotësuar dhe implementuar këtë ligj dhe për çështje që nuk rregullohen me këtë ligj etj.
- (MASHT 2013: Ligi për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve).

Ligji për Maturën Shtetërore, i miratuar në vitin 2008, në nenin 5 të tij, potencon se provimit përfundimtar dhe të maturës i nënshtrohen edhe kandidatët nga arsimi i të rriturve, ndërsa kushtet dhe kriteret e vlerësimit të kandidatëve të arsimit për të rritur do të përcaktohen me akte nënligjore të veçanta.

Mbi bazën e rishikimit dhe miratimit të LAP, LAAP dhe LAARr janë hartuar edhe një sërë aktesh nënligjore dhe dokumente përcjellëse, të cilat kanë për qëllim rregullimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, si dhe nënsektorin e AAP-së dhe AARr-së, në kuadër të këtij niveli arsimor në Kosovë.

Disa nga udhëzimet administrative që për qëllim kanë rregullimin e këtij nënsektori janë:

UA 1/2014, Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional, sipas të cilit institucioni i AAP-së hulumton dhe analizon nevojat e tregut të punës dhe mbi këto nevoja planifikon dhe organizon AAP, planifikon kuadrin e nevojshëm profesional, siguron infrastrukturën e nevojshme për profilet e nevojshme dhe bën kërkesë për hapjen e profileve përkatëse, respekton konkursin e shpallur nga MASHT-i, formon këshillat brenda shkollës, lidh marrëveshje me tregun e punës për realizimin e praktikës profesionale, planifikon dhe organizon mësimin për të rritur, etj.

UA 13/2014, Plani vjetor i punës dhe Plani zhvillimor i ofruesve të arsimit formal për të rritur, potencon se PZH për AARr duhet të integrohet në PZSH të institucionit, ndërsa në planin vjetor të punës së institucionit përfshihen të gjitha aktivitetet rreth organizimit të mësimin dhe realizimit të programeve për të rritur. Sipas UA:

- Përmes mësimin për të rritur, vijuesit mund të përfundojnë dy klasë të mësimin të rregullt brenda një viti shkollor. Shkolla përcakton fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor për të rritur;
- Vijuesit janë të obliguar që të ndjekin AARr-në në afat kohor prej 18 javësh. Për grupin më të vogël se 12 vijues shkolla është e obliguar që të organizojë mësim konsultativ, të cilët duhet të mbajnë 10% të orëve të mësimin të parapara për të rritur;
- Vijuesve që ndërrojnë profilin arsimor u mundësohet dhënia e profileve diferenciale, dy klasë brenda një afati;
- Numri i vijuesve që regjistrohen në AARr përcaktohet nga këshilli drejtues i institucionit;
- Institucionet mund të regjistrojnë vijues vetëm në profilet dhe modulet e licencuara dhe të akredituara nga legjislacioni në fuqi;
- Regjistrimi i vijuesve duhet të bëhet sipas nenit 12 të LAP-së;
- Nëse në konkurs paraqitet numër më i madh i vijuesve, atëherë përzgjedhja bëhet sipas kriterëve të parapara me legjislacionin në fuqi për nxënësit e rregullt;

- Konkursi për pranimin e kandidatëve në mësimin për të rritur duhet të shpallet sipas legjislacionit në fuqi (Ligji për AAP);
- Shkolla pas pranimin të kandidatëve harton dhe publikon kalendarin e punës më së largu 15 ditë pas pranimin të kandidatëve dhe duhet të publikojë atë në tabelat e institucionit si dhe të dërgohet në DKA dhe MASHT;
- Kalendarin duhet të përmbajë orarin mësimor, planet dhe programet mësimore, angazhimin e mësimeve për lëndët përkatëse, kujdestarët e klasave, komisionet për vlerësim dhe komisionet për vlerësimin e kandidatëve për provimet diferenciale, vlerësuese, afati i mësimit konsultativ, afati i provimeve, planifikimi i PP-së, etj.

UA 2/2014, Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP-së, resurset dhe infrastruktura shkollore, siguria e nxënësve, potencion aspekte që kanë të bëjnë me kualifikimet e AAP-së, modulet në AAP, infrastrukturën shkollore, resurset dhe me sigurimin e nxënësve.

UA 16/2011, Kalimi i nxënësve të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në shkollën tjetër, sipas të cilit të drejtë kalimi prej një profili arsimor në tjetrin, përkatësisht prej një shkolle në tjetrën, kanë të gjithë nxënësve të arsimit formal dhe joformal të shkollave të mesme të larta, publike dhe private, të licencuara nga MASHT-i, të cilët:

- Ndërrojnë vendbanimin dhe në vendbanimin e ri nuk kanë shkollë të profilit përkatës;
- Për shkak të aftësive të kufizuara fizike janë të detyruar të ndërrojnë profilin arsimor ose shkollën;
- Për shkak të reformës arsimore, nevojës së tregut, apo për arsye të ndryshme të ndërprerjes së procesit mësimor;
- Për shkak të mospërbushjes së kompetencave në një fushë të caktuar mësimore

UA përkatës i ka të specifikuar edhe kriteret dhe procedurat e realizimit të këtij kalimi.

UA 14/12, Testi pranues për shkollat të caktuara profesionale të nivelit 3 të ISCED-it, sipas të cilit, në mënyrë që një nxënës të regjistrohet në një shkollë të caktuar profesionale, duhet të plotësojë kërkesat e testit pranues, i cili hartohet nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe e të Rriturve. Deri në themelimin e agjencisë, regjistrimi i nxënësve në këto institucione do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

UA 12/2014, Përfundimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur, qëllimi i të cilit është të rregullohet moshë e përfunduar e vijuesve, të cilët mund të përfitojnë nga arsimi kompensiv, nivelet I dhe II të ISCED – klasat 1-9 dhe të mesme të larta, niveli III i ISCED në shkollat publike/private.

Sipas UA, personat që kanë humbur statusin për të qenë nxënës të rregullt dhe nuk e kanë realizuar me kohë të drejtën e arsimit mund të riintegrohen në sistemin arsimor nëpërmjet arsimit dhe aftësimin për të rritur. Kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën për nivelet dhe klasën përkatëse me moshën e tyre, mund të regjistrohen në AARr, arsimin kompensiv sipas një vendimi të veçantë nga MASHT-i. Vijuesi që ka humbur vetëm një vit shkollor mund të regjistrohet në AARr, arsimin kompensiv, vetëm në raste të veçanta, si:

- Qëndrimi në spital;
- Qëndrimi në burg;
- Qëndrimi në strehimore;
- Viktima e dhunës, trafikimit;
- Aftësia e kufizuar.

Regjistrimi i rasteve të veçanta bëhet pasi kandidati sjell dokumentacion përkatës në shkollë. UA parasheh gjithashtu obligimet e shkollës karshi këtyre rasteve.

UA 11/2011, Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur, ka për qëllim përcaktimin e participimit të vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur.

Pagesa e shërbimeve nga vijuesit bëhet në xhironlogarinë përkatëse të institucionit, përmes bankës, dhe përfshin:

Regjistrimin e vitit.....	për një klasë 100 €
Praktika profesionale.....	50 €
Provimi diferencial.....	10 €
Provimet përfundimtare të klasës, certifikata...	30 €
Diploma.....	20 €.

Sipas UA, shkolla është e obliguar që t'i raportojë DKA-së për secilin afat, ndërsa DKA-të janë të obliguara të raportojnë në MASHT për çdo vit shkollor lidhur me përfshirjen e kandidatëve në AARr.

UA 17/2013, Provimet dhe vlerësimet, rregullon procedurat për organizimin e provimeve dhe vlerësimit në tri nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas ligjit, tri nivelet e arsimit organizohen:

- Provimet e klasës;
- Provimet plotësuese, të cilat organizohen për nxënësit të cilët e ndërrojnë profilin arsimor dhe për kandidatët që pas kryerjes së shkollës së mesme duan ta ndërrojnë profilin ose drejtimin arsimor;
- Provimet vjetore dhe kontrolluese;
- Riprovimet dhe provimet përfundimtare (provimet për verifikimin e aftësisë profesionale). Provimi përfundimtar i profesionit realizohet në fund të klasës së 12-të në shkollat profesionale. Provimi i Maturës Shtetërore organizohet me ligjet në fuqi. Provimet pranuese organizohen në shkolla artistike dhe në gjimnaze të specializuara.

UA 5/2012, Qendrat e Kompetencës në Kosovë, rregullon qëllimet, strukturën dhe funksionet e Qendrave të Kompetencës (QK) brenda sistemit kosovar të arsimit dhe aftësimin profesional dhe integrimin e tyre në kontekstin e AAP evropian.

QK, sipas UA, janë institucione të reja në sistemin e AAP-së së Kosovës. Qëllimi dhe funksioni i tyre është të ofrojnë punëtorë të kualifikuar, me njohuri dhe shkathtësi praktike që u përgjigjen nevojave të tregut të punës në Kosovë dhe BE. QK ofrojnë AAP fillestarë dhe të mëtejshëm dhe programet e tyre arsimore dhe aftësuese mund t'u dedikohen të rinjve dhe të rriturve me ose pa kualifikim formal paraprak.

UA për QK rregullojnë edhe kornizën e përgjithshme të QK-ve, qeverisjen e QK-ve, aspekte të menaxhimit dhe administratës, zhvillimin e burimeve njerëzore, nivelet e kualifikimit, kurrikulat, orientimin në tregun e punës, bashkëpunimin e QK-ve dhe shkollave të tjera të mesme të AAP-së, bashkëpunimin dhe rrjetëzimin kombëtar dhe ndërkombëtar, etj.

UA 21/2013, Mbarimi i shkollimit me sistem të vjetër arsimor, përcakton të drejtat, afatet dhe shkollat në të cilat nxënësi mund ta përfundojë shkollën e mesme me sistemin e vjetër arsimor. Të drejtë për t'iu nënshtruar provimeve kanë vetëm nxënësit, të cilët nuk e kanë përfunduar vitin e fundit dhe provimin e maturës. Nxënësi i shkollës profesionale duhet t'i nënshtrohet praktikës profesionale në periudhën prej 15 ditësh për vitin e fundit. Të liruar nga kjo praktikë janë nxënësit që janë në marrëdhënie pune dhe që sjellin dëshmi dhe vlerësim nga punëdhënësi për aftësimin e tij për profesion.

UA 35/2013, Organizimi i provimit profesional përfundimtar, rregullon mënyrën e organizimit të provimit përfundimtar profesional lidhur me: kushtet, bashkëpunimin, detyrat teorike dhe praktike, oraret, mbajtjen e dosjeve për kandidatët, ruajtjen e punimeve, procesverbalet lidhur me mbajtjen e provimeve dhe vlerësimin e rezultateve mësimore.

UA 11/2014, Përmbajtja e kontratës për organizimin e AARr për kandidatë dhe punëdhënës, potencon se të drejtat dhe obligimet e kandidatit, institucioneve për AAP, ndërmarrjeve dhe punëdhënësve për realizimin e AARr-së me përmbajtje të kontratës, përcaktohen kriteret dhe mënyra e bashkëpunimit profesional. UA përcakton përmbajtjen e kontratës ndërmjet kandidatit dhe institucionit të AARr-së, përmbajtjen e kontratës në mes të IAARr-së dhe ndërmarrjes/institucioneve publike dhe private dhe përmbajtjen e kontratës në mes të IAARr-së dhe punëdhënësit publik dhe privat.

UA 31/2014, Njohja e mësimit paraprak (NJMP), përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen në implementimin e marrëveshjes për njohjen e mësimit paraprak, duke përfshirë mësimin formal, joformal dhe informal në kuadër të fushëveprimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë. Ky UA përdoret nga AKK-ja /AAK-ja për të përcaktuar procedurat dhe kriteret që institucioni duhet t'i plotësojë për akreditim të njohjes së mësimit paraprak dhe përmban dispozitat e përgjithshme, fushëveprimin, grupet e synuara për NJMP, parimet që mbështesin NJMP-në, rezultatet mësimore si pikë referimi për NJMP, etj.

UA 04/2015, Themelimi, funksionimi dhe përbërja e Këshillit për arsim dhe aftësim profesional dhe për të rriturit, përcakton rolin, përgjegjësitë dhe funksionin e KAAPRr, strukturën e këtij këshilli, funksionimin e organeve të tij, përbërjen, etj. Sipas UA, ky këshill është i thirrur të bëjë:

- Hulumtime dhe analiza për zhvillimin e politikave për AAPRr;
- Jep rekomandime dhe këshillon për zhvillimin e politikave për AAPRr, në harmoni me politikat e BE-së;
- Siguron integrimin e politikave për të gjitha aktivitetet e AAPRr-së;
- Bën rekomandime të Qeveria dhe të bartësit të AAPRr-së në Kosovë.

UA 14/2014, Agjencia e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit të të rriturve në Kosovë, rregullon qëllimet, objektivat, strukturën dhe funksionet e AAPRr-së në Kosovë dhe integrimin e këtij institucioni në kontekstin e AAP-ve evropiane.

Përveç ligjeve dhe udhëzimeve administrative, nga MASHT-i dhe partnerë bashkëpunues, janë hartuar edhe dokumente të tjera strategjike mbështetëse të proceseve në këtë nënsektor të arsimit.

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës u miratua në vitin 2011, përmes së cilës synohet 'që qytetarët e Kosovës të ballafaqohen me sfidat e shekullit XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës' (KKK, pika 1.2 - Synimi).

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016, që u miratua nga MASHT-i në vitin 2011, është një plan pesëvjeçar që lidh arsimin gjatë gjithë jetës me gjithëpërfshirjen në arsim. Për fushën e AARr-së dokumenti parasheh gjashtë objektiva të përgjithshme, të cilat parashihen të realizohen deri në fund të vitit 2016.

Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale në Kosovë 2013 – 2020 u miratua nga MASHT në vitin 2014, është një skicë e qartë për të ardhmen e praktikës profesionale në Kosovë. Ka 4 prioritetet strategjike:

1. Rritja e numrit të punëdhënësve që ofrojnë vende/mundësi për praktikë profesionale,
2. Rritja e numrit të nxënësve të AAP që marrin pjesë në praktikën profesionale,
3. Përmirësimi i cilësisë së praktikës profesionale,
4. Ofrimi i një kornize për punë të koordinuar mes akterëve vendorë që synon përmirësimin e praktikës profesionale nëpër ndërmarrje,

Përveç prioritetëve, dokumenti orienton edhe procesin e monitorimit dhe vlerësimin të rëndësishëm dhe përmbushjes së prioritetëve strategjike, aktorët potencial për realizimin e dokumentit, si dhe matricën e Planit të veprimit me aktivitetet dhe burimet që kërkohen për ta përkrahur realizimin e strategjisë.

Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim⁴ (SMIA) është gjithashtu një program shumë i rëndësishëm dhe shërben si pikë mbështetje për krijimin e politikave të mirëfillta arsimore, zhvillimin e treguesve në arsim dhe statistikave arsimore në përgjithësi.

Nga analiza e statistikave të ofruara në raportet vjetore të SMIA-s për arsimin e mesëm të lartë në Kosovë, krahasimi i të dhënave për numrin e nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2011/12 deri në 2014/15 nxjerr në pah një rënie të lehtë të përfshirjes së nxënësve në AAP, edhe pse tregohet epërsi në përqindje në raport me gjinmazet për tri vitet e para të raportimit (2011/12, 2012/13 dhe 2013/14, ndërsa në vitin shkollor 2014/15 vërehet një ngritje dhe epërsi e dukshme e përfshirjes së nxënësve në gjimnaze në raport me AAP-në, figura 2.

⁴ http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_neKosove




Figura.2. Pasqyra e përfshirjes së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, 2011-2014.

Një informim i tillë për tendencat e përfshirjes së nxënësve në AAP mund të shërbejë si një tregues dhe pikë referuese për hartimin e politikave arsimore për sektorin e AAP-së, përfshirë edhe AARr-në, në funksion të avancimit, promovimit dhe zhvillimit të cilësisë në këtë nënsektor të arsimit, karshi zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut.

IV. TË DHËNAT PËR PROGRAMET E ARSIMIT FORMAL PËR TË RRRITUR NË SHKOLLAT E AAP-SË

Të dhënat e prezantuara në këtë pjesë të raportit janë të dhëna burimore, të ofruara nga shkollat e AAP-së, të bazuara në librat amë dhe dokumentacionin përcjellës shkollor për arsimin formal të të rriturve dhe i referohen periudhës 2010-2015⁵.

Procesit të evidentimit të shkollave profesionale, të cilat në këtë periudhë realizuan programe të AARr-së, i parapriu kontakti me DKA-të përkatëse në shtatë rajonet e Kosovës. Listat e siguruar për këto shkolla shërbyen pastaj si burim bazë për shtrirjen e hulumtimit në këto shkolla. Përpunimi i të dhënave për AARr-në u shtri në dy rrafshë:

Të dhënat e përgjithshme për profilet, numrin e vijuesve dhe diplomimin e tyre në shkollat e AAP-së, të cilat në periudhën 2010-2015 realizuan programe të AARr-së. Sigurimi dhe përpunimi i informacionit u realizua përmes platformës së thjeshtë elektronike në programin Excel, të hartuar nga IPK-ja dhe të plotësuar nga shkollat përkatëse.

Të dhënat e specifikuar për gjininë, moshën, shkollën/ shkollimin paraprak, vitin e regjistrimit në program, profilin, certifikimin, diplomimin etj., e vijuesve të rritur në mostrën prej 15 shkollave të AAP-së, të cilat në periudhën 2010-2015 realizuan programe të AARr-së.

Sigurimi dhe përpunimi i të dhënave për vijuesit e programeve u realizua përmes platformës së specifikuar elektronike në programin Pivot Table (Excel), të hartuar nga IPK, ndërsa gjetjet u integruan në raportin e studimit. Pjesë e procesit të evidentimit dhe bartjes së të dhënave në shkollat mostër të studimit ishin koordinatorët e programeve të arsimit dhe aftësimit për të rritur, të emërtuar në shkollat përkatëse, ndërsa roli i IPK-së ishte monitorimi i procesit dhe mentorimi i koordinatorëve në realizimin e angazhimeve në raport me të dhënat.

Për të lehtësuar dhe mbështetur këtë proces, IPK-ja realizoi vizita dhe kontakte të vazhdueshme me shkollat mostër, ndërsa në muajt prill dhe maj 2015 u mbajtën dy punëtori njëditore me koordinatorët e angazhuar, ku u përpunuan të gjithë hapat dhe aspektet që i kërkon procesi. Vëmendje e veçantë iu kushtua ndërtimit të kapaciteteve të shkollave për të vazhduar me përpunimin, analizën dhe raportimin e të dhënave për AARr-në në të ardhmen.

4.1. Të dhënat e përgjithshme për shkollat e AAP-së

Gjetjet e studimit të realizuar në shkollat e AAP-së informojnë se në periudhën 2010-2015 programe të arsimit dhe aftësimit formal me të rriturit janë realizuar në 6 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë, Prizren dhe Ferizaj, me 19 komuna të përfaqësuara dhe 36 shkolla profesionale nga komunat përkatëse. Pas përpunimit të librave amë të shkollave të përfshira në mostër të studimit, rezultoi se numri i përgjithshëm i vijuesve të përfshirë në këto

⁵ Bazuar në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, të miratuar në vitin 2013 nga MASHT-i, çdo institucion që ofron programe të aftësimit për të rritur obligohet të mbajë libër amë (Neni 17, evidenca).

programe ka qenë 15535, ndërsa shpërndarja e tyre në komunat përkatëse paraqitet si në figurën nr. 3 në vijim.




Figura 3. Numri i vijuesve të AARr-së në 19 komuna.

Siç shihet në grafikon, numrin më të madh të vijuesve e përbën komuna e Prishtinës, me 2848 vijues ose 18,3%. Kjo arsyetohet me faktin se në këtë komunë janë gjithsej 6 shkolla të mesme profesionale, që kanë realizuar programe të AARr-së, përderisa në komunat e tjera ky numër ka qenë më i vogël, kryesisht 1 deri në 3 shkolla.

Specifikuar në vitin e regjistrimit që figuron në librat amë, numri i vijuesve të regjistruar ndryshon nga viti në vit. Numri më i madh i vijuesve në programet e AARr-së figuron të jetë në vitin shkollor 2011/2012 (3782 ose 28,8%). Të dhënat për vitin 2014/15 i referohen regjistrimit të vijuesve deri më 31 mars 2015. Të gjithë vijuesit e regjistruar më vonë nuk janë të përfshirë në hulumtim, prandaj edhe shifra prej 2013 të regjistruarve për këtë vit nuk mund të merret si e përfunduar. Figura 4 në vijim sjell pasqyrën e përgjithshme të regjistrimit të vijuesve në AARr, ndërsa informacioni i detajuar për numrin e vijuesve, specifikuar në vitin e regjistrimit, rajonin, komunën dhe shkollën përkatëse, ofrohet në tabelën nr. 3 në shtojcë.




Figura 4. Numri i vijuesve sipas viteve të regjistrimit.

Përveç të dhënave për përfshirjen në program të AARr-së, për 36 shkollat që kanë ofruar programe të AARr-së, kemi përpunuar edhe të dhënat lidhur me *përfshirjen e vijuesve në testin e Maturës Shtetërore dhe diplomimin e tyre*. Numri i përgjithshëm i vijuesve të diplomuar në 36 shkollat e AAP-së rezultoi të jetë 3267 vijues ose 21%. Krahasuar me përfshirjen në AARr, përqindje më e lartë e vijuesve që kanë kaluar provimin e Maturës Shtetërore / të diplomuar janë në komunën e Podujevës me rreth 55%, nga 612 vijues sa ishin gjithsej të përfshirë në program, përderisa numër më të vogël të vijuesve të diplomuar kemi në komunën e Suharekës, ku vetëm 7,4% nga 498 vijues figurojnë të jenë të diplomuar në program, figura 5 në vijim, ndërsa tabela nr. 4 në shtojcë ofron informacion të plotë për maturën, ndërsa tabela 6 ofron informacion për për profilet profesionale të ofruara nga shkollat përkatëse në programin e AARr-së.




Figura 5. Përqindja e të diplomuarve në programin e AARr-së.⁶

Numri më i madh i vijuesve të diplomuar figuron të jetë në vitin 2013, me 1195 ose 36,6%. Krahasuar në vite, trendët e përfshirjes së vijuesve në Testin e Maturës kanë treguar rritje dhe rënie në përqindje. Përderisa në vitin 2012 kemi rritje prej 45% të përfshirjes krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2014 kemi rënie për afro 9% të kandidatëve që kalojnë maturën krahasuar me vitin 2013. Figura 6.




Figura 6. Trendët e përfundimit të testit të maturës/diplomimi i vijuesve.

⁶ Për komunën e Drenasit kanë munguar të dhënat për numrin e vijuesve të diplomuar!

4.2. Të dhënat e specifikuara për 15 shkollat e AAP-së

Gjetjet e studimit, të realizuar në shkollat 15 shkollat e AAP-së të përfshira në mostrën e studimit tonë, informojnë se në periudhën 2010-2015 **numri i vijuesve** në këto shkolla ka qenë gjithsej

6085, prej tyre të gjinisë femërore kanë qenë gjithsej 34.9%. Figura nr. 7 në vijim paraqet numrin e vijuesve në shkollat përkatëse, ndërsa tabela nr. 6 në shtojcë ofron të dhënat e specifikuara për shkollat.




Figura 7. Numri i vijuesve në 15 shkollat e përfshira në mostër.

Mosha e vijuesve me rastin e regjistrimit në programe të AARr-së është kalkuluar duke bërë zbritjen e vitit të lindjes së vijuesit nga viti i regjistrimit në AARr (p.sh. nëse viti i lindjes është 1990 - viti i regjistrimit në AARr 2010, atëherë me rastin e regjistrimit në AARr vijuesi rezulton të ketë qenë 20-vjeçar). Shpërndarjen e % së vijuesve specifikuar në moshë e kemi me këtëpasqyrë:

Mosha	15-17	18-20	21-30	31-40	41-50	Mbi 50	Mungon
%	16,3	26,5	26,5	20	5,3	0,8	4,5

Të dhënat e hulumtimit informojnë se në programet e AARr-së, përqindje më të lartë ka rezultuar të kemi vijues të moshës 18-30 vjeç (53%), vijues të moshës 15-17 vjeçare ishin gjithsej 16,31% , përderisa për 4,5% të vijuesve nuk ka mundur të kalkulohet mosha e tyre, meqenëse në librat amë të shkollave ka munguar viti i lindjes ose viti i regjistrimit në AARr. Gjithashtu, vlen të përmendet se në shkollat me regjistrim të vijuesve me moshë 15-17 vjeç nuk kemi hasur ndonjë dëshmi arsyetuese për regjistrim të vijuesve të kësaj moshe në AARr, ashtu siç e specifikon UA 12/2014. *Përrjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur* (MASHT, 2014)! Tabela nr. 7 në shtojcë jep informacionin e plotë për moshën e vijuesve, specifikuar në shkollën përkatëse.

Aspekt tjetër që ne e kemi evidentuar përmes përpunimit të të dhënave ka qenë edhe informacioni se **nga cilat shkolla paraprake kanë ardhur vijuesit në AARr**. Për qëllim të thjeshtësimin të informacionit, në raport kemi përfshirë vetëm informacionin se sa është numri i vijuesve që në AARr vijnë nga po e njëjta shkollë, d.m.th. sa nga vijuesit e së njëjtës shkollë

kanë kaluar nga mësimi i rregullt në mësim për të rritur. Sipas të dhënave, numri i këtyre vijuesve ka qenë 1406 (23,1%), përqindja më e madhe e të cilëve figuron të jetë në shkollën ‘H. Prishtina’ (51,5%) nga numri i përgjithshëm i vijuesve në këtë shkollë, figura nr. 8 dhe tabela nr. 8 në shtojcë.




Figura 8. Përqindja e vijuesve nga e njëjta shkollë

Sa i përket **vitet të regjistrimit të vijuesve në programin e AARr-së**, kemi këtë pasqyrë:

Viti	2010/11	2011/12	2012/13	2013/14	2014/15	Mungon
%	20.2	23.3	19.4	23.7	10.8	2.7

Nga të dhënat shihet se viti 2013/14 prin për nga numri i vijuesve të regjistruar në program, përderisa në vitin 2014 kemi rënie të dukshme të regjistrimeve në AARr. Të dhënat për vitin 2014/15 i referohen regjistrimit të vijuesve deri më 31 mars 2015. Të gjithë vijuesit e regjistruar më vonë nuk janë të përfshirë në hulumtim, prandaj edhe përqindja prej 10,8% e të regjistruarve për këtë vit nuk mund të merret si e përfunduar! Megjithatë, edhe për këtë aspekt u evidentua mungesa e informacionit për 2,8% të vijuesve të evidentuar në librat amë. Tabela nr.9 në shtojcë sjell informacionin e plotë për vitin e regjistrimit specifikuar në shkollat përkatëse.

Sa i përket **suksesit hyrës të vijuesve në program** (suksesi nga shkollimi paraprak) kemi evidentuar se përqindje më të lartë të vijuesve të regjistruar në program kemi me sukses të mjaftueshëm (29,3%) dhe me sukses të mirë (27,05%). Janë në përqindje shumë të vogël vijues me sukses të shkëlqyer (6,8%), por kemi edhe prej atyre që në shkollimin paraprak kanë treguar sukses të pamjaftueshëm (3,6%). Të dhëna për nxënës përsëritës kemi vetëm për shkollën ‘Sh. Gjeçovi’ (1 përsëritës), ‘A. Hadri’ (47 përsëritës) dhe ‘H. Prishtina’ (114 përsëritës), ndërsa për shkollat e tjera nuk figuron se kanë pasur nxënës përsëritës hyrës në program. Shqyrtimi i të dhënave për suksesin hyrës të vijuesve identifikoi edhe shumë parregullsi rreth plotësimit të librave amë nga shkollat për këtë aspekt, meqenëse rezulton që për rreth 24% të vijuesve të regjistruar në AARr nuk dihet suksesi paraprak i tyre. Informacione të detajuara sjell tabela nr. 10 në shtojcë.

Pritjet për regjistrim në programin e AARr-së, kalim nga mësimi i rregullt në AARr, gjithashtu janë evidentuar të jenë të ndryshme nga shkolla në shkollë. Vitet e pritjes janë

kalkuluar duke e bërë zbritjen e vitit të përfundimit të shkollimit paraprak nga viti i regjistrimit në programin e AARr-së (p.sh. nëse viti i përfundimit të shkollimit paraprak është 1990 - viti i regjistrimit në AARr 2010, atëherë rezulton se vijuesi për regjistrim në AARr ka pritur 20 vjet).

Pritjet më të gjata për nga përqindja e vijuesve u evidentuan të kenë qenë nga 2 deri në 5 vjet (19,1%). Është evidentuar se pothuajse të gjitha shkollat kemi vijues të regjistruar në programin e AARr-së pa pritur as edhe një vit për kalim nga mësimi i rregullt në AARr (12,8%), përqindje më të lartë të këtyre rasteve kemi te shkolla 'Sh. Spahija' (39,1%) dhe 'H. Prishtina' (37,3%). Edhe për këtë aspekt, në shkollat e përfshira nuk kemi hasur asnjë dëshmi të arsytimit të regjistrimit të vijuesve pa e kaluar së paku një vit për kalim nga mësimi i rregullt në AARr, ashtu siç është e rregulluar me UA 12/2014, *Përfshirjet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur (MASHT, 2014)*. Për 19,9% të vijuesve nuk ka mundur të kalkulohej vitet e pritjes, meqenëse në librat amë të shkollave ka munguar viti i përfundimit të shkollimit paraprak ose viti i regjistrimit në AARr. Tabela nr. 11 në shtojcë prezanton informacionin e detajuar për distancën kohore me rastin e kalimit nga mësimi i rregullt në AARr.

Të dhënat për ***nivelin e shkollimit paraprak të përfunduar/klasën paraprake të përfunduar*** para kalimit në AARr informon se me përqindje më të lartë në program janë regjistruar vijues që paraprakisht:

- kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët, pra klasën e 8-të ose të 9-të (44,3%),
- kanë përfunduar ndonjë klasë në arsimin e mesëm të lartë, pra klasat 10-të, 11-të, 12-të, apo 13-të dhe të atyre që këtë nivel arsimor e kanë vijuar në sistemin e vjetër arsimor, pra vitet I, II, III apo IV (29,5%).

Informacioni për klasën paraprake mungon në përqindje prej 26,2%, tabela nr. 12 në shtojcë.

Edhe për ***klasën e regjistruar në programin e AARr-së*** të dhënat informojnë se kemi dominim të përqindjes së vijuesve të regjistruar në klasën e 10-të (55,5%), përderisa përqindje më të vogël kemi te regjistrimi i klasës së 12-të (6,1%). Ka edhe raste kur vijuesit kanë bërë ndërrim të profileve, edhe pse kjo përqindje është e ulët, diku rreth 0,8%, përderisa për 1272 vijues (20,9%) u evidentua se në librat amë të shkollave mungojnë të dhënat për lidhur me klasën e regjistruar në program, tabela nr. 13 në shtojcë.

Për vijuesit që para regjistrimit në AARr kanë vijuar arsimin e mesëm të lartë⁷ dhe për arsye të ndryshme e kanë ndërprerë atë dhe kanë kaluar në AARr, në hulumtimin e kemi përfshirë edhe ***evidentimin e profileve paraprake atyre në AARr***, të cilat vijuesit i kanë regjistruar/vijuar. Të gjitha të dhënat për profilet paraprake, atyre në AARr të vijuesve, janë të prezantuara në tabelat 14 dhe 15 në shtojcë.

⁷ Nëse kthehemi te informacioni i ofruar në tabelën nr. 12, shohim se janë 1793 vijues ose 29,5% vijues që janë regjistruar në AML (klasën e 10-të - 12/13).

Lidhur me **suksesin mësimor të vijuesve në programin e AARr-së**, sipas të dhënave, rezultoi se në program vijuesit kanë treguar rezultate kryesisht të mjaftueshme mësimore (33,6%) dhe të mira (32,4%), përderisa nuk kemi asnjë vijues me sukses jo të mirë. Edhe për këtë aspekt, në librat amë të shkollave mungojnë të dhënat për 1645 vijues (27%). Figura 9 në vijim dhe tabela 16 në shtojcë.




Figura 9. Suksesi mësimor i vijuesve në AARr.

Klasa e përfunduar në programin e AARr-së me përqindje më të lartë të vijuesve rezultoi të jetë e 13-ta, me 1932 ose 31,8% vijues. Vlen të përmendet se 44,5 % e vijuesve e kanë përfunduar klasën e 10-të (590 vijues ose 9,7%), klasën e 11-të (777 vijues ose 12,8%), ose të 12-ën (1341 vijues ose 22%). Edhe për klasën e përfunduar nga vijuesit në programin e AARr-së, për 23,7% të tyre, në librat amë të shkollave mungon ky informacion, tabela nr. 17 në shtojcë.

Vijues të certifikuar për nivelin I kemi 415 vijues ose 12,7%, në nivelin II kemi 728 ose 22,2%, në nivelin III janë të certifikuar 2133 ose 65,1% e vijuesve. Për 1364 vijues që kanë përfunduar njëri nga klasat në AARr mungon informacioni për nivelin e certifikimit, tabela nr. 18 në shtojcë.

Numri i vijuesve që i janë nënshtruar **Provimit Shtetëror të Maturës** në periudhën 2010-2015 rezultoi të jetë 1464 ose 24,1 % e numrit të përgjithshëm. Përqindje më të lartë të përfshirjes kemi në vitin 2013, me 42,6%, tabela 19 në shtojcë.

V.PRAKTIKAT E INSTITUCIONEVE PËRKATËSE PËR REALIZIMIN E AARr-SË NË SHKOLLAT PROFESIONALE NË KOSOVË

Në këtë pjesë të raportit prezantohen gjetjet për praktikat, format e organizimit dhe bashkëpunimit lidhur me realizimin e arsimit formal të të rriturve në shkollat profesionale të Kosovës, referuar rezultateve të:

- Anketës së realizuar me koordinatorët dhe mësime dhënësit e angazhuar në programet e mësimit për të rritur dhe me vijuesit e këtyre programeve;
- Intervistës së realizuar me udhëheqësit e shkollave, përfaqësues të MASHT-it, përfaqësues të arsimit të mesëm të lartë në nivel të DKA-ve përkatëse, si dhe me përfaqësues të Agjencisë për arsim profesional dhe arsimin e të rriturve;
- Raporteve të inspektorëve të arsimit të nivelit rajonal/rajoneve të përfshira në studim.

Mostra e përgjithshme e përfshirë në studim arrin shifrën 284. Të dhënat e detajuara për mostrën, përfshirë janë të paraqitura në tabelat nr. 1 dhe nr. 2 në shtojcë në raport, ndërsa rezultatet e analizuara dhe të krahasuara prezantohen në pjesën vijuese të raportit të studimit.

5.1. Opinionet e koordinatorëve, mësime dhënësvë dhe vijuesve të mësimit për të rritur për specifikat e mësimit për të rritur në shkollat e tyre

Rezultatet e prezantuara në këtë nënkapitull i referohen anketës së realizuar me koordinatorët dhe mësime dhënësit e angazhuar në programet e mësimit për të rritur dhe me vijuesit e këtyre programeve. Me qëllim të prezantimit sa më të qartë të gjetjeve, të dhënat e evidentuara po i paraqesim në vijim të klasifikuara sipas strukturës së kërkesave të parashtruara në instrumentet e hulumtimit/pyetësorët e realizuar me ta.

5.1.1. Të dhënat bazë për mostrën e përfshirë në anketim

Pjesa hyrëse e pyetësorëve të anketës së realizuar me koordinatorët, mësime dhënësit dhe vijuesit e programeve, përmban kërkesa për aspekte specifike të mostrës, si moshën, gjininë, kualifikimin dhe përvojën profesionale në programet e AARr-së.

Të dhënat për 16 koordinatorët e përfshirë në mostër informojnë se 31,3% e tyre i përkasin gjinisë femërore (tabela nr. 1 në shtojcë), moshë aktuale me përqindje më të lartë është ajo mbi 50 vjeç (43,8%). Përvoja më e madhe e punës në cilësinë e koordinatorit rezulton të jetë ajo 8-10 vjet (50%), tabela nr. 20 në shtojcë.

Lidhur me shkollimin paraprak të tyre, u identifikua se kemi të përfshirë 53,2% koordinatorë me kualifikim të nivelit bachelor (përfshirë edhe sistemin e vjetër të studimeve bazë), 30,9% me nivel master dhe vetëm 15,9% me Shkollë të Lartë Pedagogjike. Profilet përkatëse të tyre kryesisht u përkasin fushave profesionale, si Inxhinier i makinerisë, Bujqësisë, apo Elektros

(50,2%), asaj të Juridikut (15,4%), Banka dhe Financa (7,7%), si dhe fushave të tjera të mësimdhënies, si Matematikë, BAT dhe Ekonomi (26,7%).

Të dhënat për 124 mësimdhënësit e përfshirë në mostër informojnë se 94,2% janë mësimdhënë⁸ të rregullt në shkollat përkatëse dhe 65,5% janë të angazhuar në fushat/lëndët profesionale. Figura nr.10 ofron informacionet për lëndët specifike dhe angazhimet e tjera të mostrës së mësimdhënësve që ata i realizojnë në shkolla.




Figura 10. Angazhimi i mostrës së mësimdhënësve në lëndët specifike dhe funksionet e tjera në shkollë.

Sa i përket gjinisë (tabela 1 në shtojcë), rezulton se 39,5% e mostrës së mësimdhënësve i përket gjinisë femërore, mosha me përqindje më të lartë rezulton të jetë ajo mbi 41-vjeçare (57,5%), ndërsa përvoja e punës në AARr rezulton të jetë prej 6 deri në 10 vite (30.6%), tabela nr. 20 në shtojcë.

⁸ Në pyetësinë e realizuar me mësimdhënësit, të informacioni për lëndën që ata realizojnë në shkollë, 16,1% janë përgjigjur me 'mësimdhënës', pa e specifikuar qartë fushën specifike të mësimdhënies dhe si e tillë është prezantuar edhe në raport !

Të dhënat për zhvillimin profesional të mësimdhënësve/trajnimin në pesë vitet e fundit informojnë se përqindje më të lartë të tyre kemi te programi Didaktikë /Metodikë (23,9%) dhe ECDL (22.2%), tabela nr. 21 në shtojcë.

Lidhur me mostrën e vijuesve, nga 124 gjithsej të përfshirë në studim, të gjinisë femërore janë 42,7% (tabela 1 në shtojcë), moshë me përqindje më të lartë është ajo 21-25 vjeç (36,3%), tabela nr. 20 në shtojcë, ndërsa kurset/trajnimet paraprake të tyre rezultojnë të jenë ato për gjuhët e huaja (53,6%: gjuhë angleze = 42,3%, gjuhë gjermane = 8,2%, gjuhë serbe = 2,1%, gjuhë boshnjake = 1,0%), trajnime për TIK (23,7%) dhe kurse profesionale (22,7%).

Niveli i shkollimit/klasa e përfunduar para regjistrimit në programet e AARr-së rezultoi të jetë ai i arsimit të mesëm të ulët, me 72,8%, ndërsa 27,2% janë vijues, të cilët paraprakisht kanë përfunduar ndonjë vit mësimor në arsimin e mesëm të lartë dhe pastaj kanë kaluar në AARr. Nga ky numër, arsyeja me përqindje më të lartë të të përgjigjurve për kalim nga mësimi i rregullt në mësimin për të rritur kanë qenë kushtet jo të mira ekonomike të vijuesve (32,1%), figura 11.




Figura 11. Arsye për kalim të vijuesve nga mësimi i rregullt në mësimin për të rritur.

Përqindja më e madhe e vijuesve të përfshirë në mostrën e studimit rezultoi të jetë e atyre që në programet e AARr-së janë regjistruar në vitin 2014 (67,7%), ndërsa 58,9% e mostrës i përkisnin klasës së 12, tabela nr. 22 në shtojcë.

Sipas vijuesve të anketuar, arsyeja për regjistrim në programet e mësimin për të rritur ka qenë përfundimi i shkollës së mesme (25,8%), përderisa marrja e një certificate për profesionin të cilin ata e njohin dhe e ushtrojnë ka qenë një arsye jo edhe aq e fuqizuar (3,6%), tabela nr. 23 në shtojcë.

5.1.2. Roli i koordinatorëve të AARr-së, zhvillimi profesional dhe detyrat e tyre të punës

Rolet e tjera që koordinatorët e programeve të AARr-së kishin në shkollë rezultoi të jenë ai në cilësinë e mësimdhënësit (61,5%), sekretarit të shkollës (15,4%), zv.drejtorit të shkollës (7,7%), si dhe kontabilistit të shkollës (7,7%). Sa i përket zhvillimit të tyre profesional në

pesëvjeçarin e fundit, koordinatorët deklarojnë pjesëmarrje më të madhe në trajnimin për Metodikë/Didaktikë, Didaktikë profesionale dhe ECDL (61,5%), tabela nr. 21 në shtojcë

Sipas koordinatorëve, detyrat e punës së tyre në cilësinë e koordinatorit të mësimit për të rritur, në përqindje më të lartë të të përgjigjurve, kanë të bëjnë kryesisht me verifikimin e dokumentacionit të vijuesve, regjistrimin në librin amë dhe në ditar (69,2%), përpilimin e orarit të mësimit/konsultimeve dhe provimeve (46,2%), me përzgjedhjen e stafit të mësimitdhënësve për angazhim në AARr dhe me regjistrimin e vijuesve (30,8%), tabela nr.24 në shtojcë. Detyrat e angazhimit, sipas tyre, janë të rregulluara në tri forma përbrenda shkollës: Me kontratë të veçantë pune (20%), me marrëveshje me shkrim (12,5%) dhe me marrëveshje me gojë me udhëheqësit e shkollës (62,5%).

5.1.3. Përzgjedhja e stafit të mësimitdhënësve për AARr

Kur jemi të përzgjedhja e stafit të mësimitdhënësve për realizimin e mësimit me të rriturit, në pyetësorin e realizuar me koordinatorë kemi shtruar pyetjen se cilat janë kriteret që shfrytëzohen për përzgjedhjen e stafit të mësimitdhënësve për angazhim në AARr. Përgjigjet e dhëna nga të anketuarit informojnë se nuk ka kriteret të shkruara dhe të unifikuara për përzgjedhjen e këtij stafi, zakonisht në mësimitdhënë përfshihen të gjithë mësimitdhënësit e lëndëve përkatëse, me rrotacion (53,8%), por ka edhe përqindje të të anketuarve që mendojnë se për angazhim në AARr përzgjidhen mësimitdhënësit që janë më të përgatitur dhe më punëtorë (30,8%), mësimitdhënësit që kanë trajnime specifike për fushën e andragogjisë (7,7%) dhe ata që caktohen direkt nga DKA-të përkatëse (7,7%).

Organizatë bazë për ofrimin e trajnimit për aspekte të andragogjisë ka qenë DVV Internacional. Mbi bazën e Kurrikulës për Mësim dhe Arsim Global për të Rritur - Curriculum globALE⁹, DVV ka trajnuar dhe informuar për specifikat e AARr-së mësimitdhënës, koordinatorë dhe staf të disa shkollave profesionale, si dhe trajnerë të Qendrave të Arsimit Profesional.

Në kuadër të angazhimit, koordinatorët janë të thirrur të raportojnë për mbarëvajtjen e punëve në harmoni me detyrat e përcaktuara. Sipas tyre, ata raportojnë te drejtori/zv.drejtori i shkollës me shkrim dhe me gojë (69,2%), te sekretarit i shkollës ofrojnë raportim me gojë (7,7%), te DKA-të përkatëse dhe në MASHT raportim me shkrim dhe me gojë (30,8%).

⁹ Kurrikula për Mësim dhe Arsim Global për të Rritur - Curriculum globALE u dedikohet kryesisht institucioneve dhe organizatave në fushën e Arsimit për të Rritur që dëshirojnë të sigurojnë që niveli i kualifikimeve të edukatorëve të tyre të plotësojnë standardet profesionale. Është e publikuar nga Institut für Zusammenarbeit des Deutschen Volkshochschul Verbands (DVV Internacional) dhe Deutsches Institut für Erwachsenenbildung –Leibniz-Zentrum für Lebenslanges Lernen e.V.(DIE). DVV Internacional, zyra përfaqësuese në Prishtinë ka përkthyer këtë kurrikulë , të cilën e ka përdorur për nevojat e trajnimit.

5.1.4. *Format e realizimit të programeve të AARr-së*

Sipas koordinatorëve të anketuar, programe të mësimit për të rritur shkollat ofrojnë dy herë brenda vitit kalendarik (76,9%), të cilat pastaj realizohen gjatë ditëve të punës pasdite dhe në vikende, kryesisht të shtunave (81,5%).

Paraprakisht shkollat informojnë vijuesit për ofertat programore dhe për kriteret për regjistrim përmes konkursit publik në media (84,6%), shpalljeve në ambientet e shkollës (46,2%) ose në faqen zyrtare të komunës (15,4%).

Pranimi të vijuesve, sipas koordinatorëve, i paraprin një proces i vlerësimit të njohurive të tyre hyrëse në program (81,3%), përderisa pak më shumë se gjysma e mësimdhënësve (54%) dhe e vijuesve (64,5%) deklarojnë se vijuesit testohen me rastin e pranimi të tyre në program.

Për të siguruar informacione më të detajuara për vlerësimin e vijuesve, në pyetësorin e realizuar me mësimdhënës dhe vijues kemi shtruar pyetjen se kur vlerësohen ata, para apo pas regjistrimit në program dhe nga kush vlerësohen, nga komisioni pranues, drejtori/zv.drejtori, nga kujdestari i klasës apo nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse. Të dhënat e fituara nga përpunimi i përgjigjeve informojnë se në përqindje më të lartë mësimdhënësit (42,3%) dhe vijuesit (34,5%) deklarojnë se vijuesit vlerësohen para regjistrimit në program dhe atë nga komisioni pranues, ndërsa vijuesit me përqindje të lartë (53,3%) deklarojnë gjithashtu se ata vlerësohen nga mësimdhënësit e tyre në provimet diferenciale, tabela nr. 25 në shtojcë.

Lidhur me format e organizimit dhe realizimit të programit të mësimit me të rriturit, në përqindje më të lartë nga të tri kategoritë (koordinatorët, mësimdhënësit, vijuesit) rezulton të deklarohet realizimi i orëve mësimore me vijuesit dhe atë më i shprehur te lëndët e përgjithshme (48,1%), përderisa përqindje më të ulët kemi te përdorimi i e-mailëve (25%) apo rrjeteve sociale (20,1) për dërgimin e informacionit dhe materialeve mësimore vijuesve nga ana e mësimdhënësve. Këto forma të këmbimit të informacioneve dhe materialeve mësimore kryesisht është e shprehur te lëndët profesionale, krahasuar me lëndët e përgjithshme që realizohen në program. Figura 12 në vazhdim paraqet këto specifika, ndërsa informacioni i detajuar ofrohet në tabelën nr. 26 në shtojcë.




Figura 12. *Format e realizimit dhe komunikimit në program.*

5.1.5. Informimi i vijuesve lidhur me programin e AARr-së

Mësimdhënësit (94,5%) dhe vijuesit (96%) e përfshirë në studim kanë dhënë informacion se shkollat e tyre i informojnë vijuesit për aspekte që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e mësimit për të rritur. Përqindja më e madhe e tyre deklarojnë se informacioni vijuesve u ofrohet kryesisht për planin dhe programin mësimor të programit (82,5%) dhe për afatet e provimeve, ndërsa më pak ky informim ndodh për kujdestarët e klasave përkatëse (42,6%) dhe për oraret e mësimit konsultativ (49%), tabela nr. 27 në shtojcë.

Për format se si ndodh ky informim lidhur me programin, mësimdhënësit dhe vijuesit e anketuar deklarojnë komunikimin verbal si një ndër format më të shpeshta të informimit, përderisa informimi me telefon dhe shpalljet në tabelat e shkollës figurojnë të jenë më pak të shprehura në shkolla, figura nr.13.




Figura 13. Format e informimit të vijuesve për aspekte të AARr-së.

5.1.6. Planet dhe programet si dhe tekstet / materialet mësimore në programet e AARr-së

Reduktimi dhe përshtatja e planeve dhe programeve mësimore të mësimit të rregullt në ato për realizimin e mësimit me të rriturit ka qenë dhe mbetet ende sfidë e shumë shkollave që ofrojnë këtë formë të mësimit. Me qëllim të marrjes së informacionit se cilat janë praktikrat e shkollave në raport me këto plane dhe programe, në pyetësorin e realizuar me koordinatorët dhe mësimdhënësit e angazhuar në program kemi shtruar pyetjen se cilat janë proceset që ndodhin në shkollë dhe mes shkollave në funksion të tejkalimit të kësaj sfide.

Rezultatet e dala nga përpunimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorë tregojnë se për realizimin e mësimit me të rriturit shkollat i shfrytëzojnë planet dhe programet e njëjta me ato të mësimit të rregullt (65,7%), shkollat profesionale me profile të njëjta profesionale bashkëpunojnë ndërmjet vete në hartimin e planeve dhe programeve të përbashkëta për profile/profesionet përkatëse për punën me të rriturit (20,7%), përderisa praktikrat më të shprehura janë kur planet dhe programet e mësimit të rregullt përshtaten nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse (50,7%) ose nga aktivitetet profesionale (45,7%) dhe si të tilla shfrytëzohen për realizimin e mësimit me të

rriturit. Figura 14 sjell krahasimin e përgjithshëm të përpilimit të planeve dhe programeve mësimore për AARr-në, ndërsa tabela nr. 28 në shtojcë sjell detajet e përgjigjeve nga të dy kategoritë e anketuara: koordinatorët dhe mësimdhënësit.



Figura 14. Planet dhe programet mësimore në AARr.

Edhe posedimi i teksteve dhe materialeve mësimore për realizimin e mësimin me të rriturit, sipas mësimdhënëseve të anketuar, paraqet një problem mjaft të theksuar në realizimin me sukses të këtyre programeve, meqenëse ata kanë identifikuar mungesat/sfidat dhe zgjidhjet që përpiqen t'i gjejnë për tejkalimin e këtij problemi. Sipas tyre, për realizimin e mësimin, shkollat përballen me mungesën e teksteve dhe materialeve mësimore (75,4%), ndërsa sipas përgjigjeve me përqindje përafërsisht të njëjtë të dhëna nga mësimdhënësit dhe vijuesit e anketuar (73,4% vijues dhe 77,4% mësimdhënëse), alternativë është përdorimi i atyre pak teksteve dhe materialeve që i kanë në dispozicion dhe të cilat shfrytëzohen edhe në mësimin e rregullt.

Në alternativat e tjera të dhëna në pyetësor, me përqindje më të lartë mësimdhënësit informojnë se ata kombinojnë materiale të tjera mësimore dhe tekste që i kanë në dispozicion (48,4%), hulumtojnë materiale mësimore nga interneti dhe burime të tjera (44,4%), si dhe hartojnë materiale mësimore dhe ua ofrojnë ato vijuesve të rritur (38,9%), përderisa vijuesit rezultojnë të jenë më pak aktivë në hulumtimin e këtyre teksteve dhe materialeve mësimore nga interneti dhe burimet e tjera (20,2%), si dhe në kombinimin e materialeve dhe teksteve të ndryshme për nevojat e tyre mësimore (19,4%).

Krahasuar me përgjigjet e dhëna nga mësimdhënësit, vijuesit janë gjithashtu më të rezervuar sa i përket mundësisë që mësimdhënësit të hartojnë dhe t'u ofrojnë vijuesve materiale mësimore të përgatitura enkas për punën me të rriturit, meqenëse vetëm (10,5%) prej tyre janë përgjigjur pozitivisht në këtë alternativë, figura 15.




Figura 15 . Tekstat dhe materialet mësimore në AARr.

5.1.7. Bashkëpunimi/komunikimi mësimdhënës/vijues në programet e AARr-së

Aspekt tjetër, për të cilin ne kemi dashur të marrim informacion nga mostra e përfshirë në hulumtim, është edhe fakti se si dhe sa shpesh ndodh bashkëpunimi/komunikimi në mes të mësimdhënësve dhe vijuesve në kuadër të realizimit të programeve të AARr-së.

Sipas përgjigjeve të marra në alternativat e dhëna në pyetësorët e realizuar me ta rezultojnë se në përqindje më të lartë, respondentët janë deklaruar për realizimin e këtij bashkëpunimi/komunikimi me rastin e takimit të tyre në shkollë (mësimdhënës 84,7%, vijues 75%) dhe atë çdo ditë (19,4% mësimdhënës dhe 54,8% vijues) dhe çdo javë (52,4% mësimdhënës dhe 35,5% vijues), përderisa janë përqindje më të ulëta në deklarimin për formën dhe shpeshtësinë e realizimit të komunikimit/bashkëpunimit të tyre me e-mail (mësimdhënës 21% dhe vijues 16,1%), rrjeteve sociale, atij me telefon apo takimeve jashtë shkolle, tabela nr. 29 në shtojcë dhe figura nr. 16 në vijim.




Figura 16. Bashkëpunimi/komunikimi mësimdhënës/vijues.

5.1.8. Praktika profesionale në programet e AARr-së

Realizimi i praktikës profesionale me të rriturit në kuadër të programeve të AARr-së ka qenë gjithashtu mjaft me interes për t'u hulumtuar në studim. Në pyetësonin e realizuar me mësimdhënës dhe vijues kemi shtruar pyetjen se a realizohen dhe ku zhvillohen praktikat profesionale me vijuesit. Përgjigjet e marra në alternativat e parashtruara informojnë se praktika profesionale në programet e mësimimit me të rritur realizohen në laboratorët e shkollave profesionale (89,5%) dhe në firmat ushtrimore të shkollave (75,4%), një numër i madh i vijuesve veç janë në marrëdhënie pune prej nga dhe sjellin dëshmi me vlerësim pozitiv nga punëdhënësi për punën praktike (33,1%). Përgjigjet e specifikuar për PP janë të paraqitura në tabelën nr. 30 në shtojcën nr. 1, ndërsa përgjigjet e përgjithshme janë të prezantuara në figurën nr. 17.




Figura 17. Praktika profesionale (PP) në AARr.

5.1.9. Matja dhe vlerësimi i rezultateve mësimore në programet e AARr-së

Matja dhe vlerësimi i rezultateve mësimore të arritura nga vijuesit e programeve të mësimimit për të rritur sigurisht që është një proces sa i vështirë dhe kompleks, po aq edhe i rëndësishëm dhe tregues i asaj se çfarë arrihet në këto programe. Në pyetësonin e realizuar me mësimdhënës dhe vijues janë parashtruar pyetje lidhur me instrumentet dhe mekanizmat që shkollat i kanë zbatuar/angazhuar në funksion të realizimit të këtij procesi.

Në përgjigjet e dhëna nga mësimdhënësit dhe vijuesit rezultojnë të kemi përqindje më të lartë të përdorimit të testeve për matje dhe vlerësim të rezultateve mësimore (82,3% mësimdhënës dhe 83,9% vijues), përderisa mësimdhënësit përqindje të konsiderueshme japin edhe të matja dhe vlerësimi i punës praktike të vijuesve në laboratorët dhe punëtoritë e shkollës (31,5%), ndërsa vijuesit deklarohen për praktikën e vlerësimit nga ana e mësimdhënësve përmes vrojtimit të drejtpërdrejtë të punës së tyre në klasë, si angazhimi individual, angazhimi në grupe të punës, në diskutime etj. (43,5%). Vlen të përmendet se mbajtja dhe plotësimi i dosjes së vijuesve (portfolios) dhe vlerësimi i raportimit me shkrim/gojë për tema të caktuara, hulumtime,

vetëraportime etj. nuk potencohet të jenë praktikuar edhe aq në këto programe, meqenëse përgjigjet e mësimdhënësve dhe vijuesve në këto alternativa janë të ulëta në përqindje krahasuar me alternativat e tjera të dhëna në pyetësor, tabela nr. 31 në shtojcë.

Edhe te vlerësimi përfundimtar/certifikues i vijuesve, rezultatet e dala nga përpunimi i pyetësorëve të realizuar me mësimdhënës dhe vijues informojnë se në përqindje më të lartë e tyre deklarojnë zbatimin e vlerësimit me teste të vijuesve (mësimdhënës 74,2% dhe vijues 70,2%), përderisa në rend të dytë për nga përqindja mësimdhënësit deklarojnë vlerësimin e vijuesve në përgjigjet verbale (57,3%), ndërsa vijuesit deklarojnë vlerësimin në përgjigjet me shkrim (59,7%), si praktikë e zbatuar nga mësimdhënësit me rastin e certifikimit të tyre për nivelin përkatës. Është me rëndësi të përmendet se nga kategoritë e anketuara (mësimdhënësit dhe vijuesit) vlerësimi i punës praktike të vijuesve nuk është deklaruar të jetë një praktikë e zbatuar në këto programe, meqenëse në këtë alternativë përgjigjet e ofruara nga ta janë më të ulëta krahasuar me alternativat e tjera të ofruara në pyetësor, tabela nr. 32 në shtojcë

Vazhduar me vlerësimin, në pyetjen se nga kush janë vlerësuar rezultatet përfundimtare të vijuesve me rastin e certifikimit për nivelin përkatës (vlerësimi përmbledhës), cilët mekanizma janë marrë me këtë vlerësim, mësimdhënësit dhe vijuesit e përfshirë në studim në përqindje më të madhe deklarojnë angazhimin e mësimdhënësve në vlerësimin përfundimtar të vijuesve (77,4%), ndërsa vlerësimi i vijuesve nga komisionet vlerësuese deklarohet të jetë më i ulët (22,6%).

5.1.10. Vlerësimi i përparësive/mangësive dhe sfidave për realizimin e programeve të AARr-së

Hulumtimi i praktikave të shkollave lidhur me realizimin e AARr-së, si kushtet e shkollave, përparësitë, mangësitë dhe sfidat që kanë shkollat për realizimin e këtyre programeve, është parë si mjaft me rëndësi në funksion të avancimit të këtyre programeve në të ardhmen.

Në shkallën e vlerësimit 5 deri në 1 (*5 = kushte të shkëlqyera; 1 = kushte aspak të mira*) mësimdhënësit vlerësojnë më lart kushtet e shkollave për realizimin e AARr-së, meqenëse përqindje më të lartë të përgjigjeve të tyre kemi te vlerësimi për kushte shumë të mira (41,9%) , përderisa vijuesit me përqindje më të lartë të të përgjigjurve deklarojnë kushtet e mira të shkollave (54,8%). Vlen të theksohet se është edhe një përqindje prej 10,5% e vijuesve që mendojnë se kushtet e shkollave për ofrimin e AARr-së janë jo edhe aq të mira, krahasuar me mësimdhënësit, të cilët te ky nivel i vlerësimit kanë treguar vetëm 3,2%, figura 18.




Figura 18. Kushtet e shkollave për realizimin e AARr-së.

Në pyetjen e hapur që kemi shtruar në pyetësorë lidhur me përparësitë që kanë shkollat për realizimin e këtyre programeve, komentet që mësimdhënësit dhe vijuesit i kanë dhënë për këtë aspekt informojnë se mësimdhënësit i vlerësojnë më lart si përparësi kushtet e objektit/infrastrukturës që ofrojnë shkollat dhe kualifikimin e kuadrit për realizimin e këtyre programeve (71,45), ndërsa vijuesit e vlerësojnë më lart formën e përshpejtuar në të cilën ofrohen këto programe (14,5%), tabela në vijim.

Mësimdhënës	Nr	%	Vijues	Nr	%
I plotëson kushtet me objekt dhe kuadër të kualifikuar	70	71,4	Bashkëpunim i mirë me mësimdhënësit	1	1,8
Laboratorët e pajisura	3	3,1	Drejtime të përshtatshme	2	3,6
Realizimi i punës praktike	7	7,1	Fokusi në lëndët profesionale	3	5,5
Mundëson shkollim/diplomim nxënësve edhe kur ata nuk i vijnë me rregull mësimet	1	1,0	Alternativa për vijim/fleksibilitet	5	9,1
Aftësim i mirë profesional	8	8,2	Infrastruktura e mirë shkollore	5	9,1
Informim me kohë	1	1,0	Kombinim i mësimin teorik dhe praktik	1	1,8
Firma ushtrimore funksionale	1	1,0	Mësimdhënës të kualifikuar	5	9,1
Mundësi shkollimi/diplomimi edhe për ata që janë më të vjetër në moshë	3	3,1	Mësimi kabinetik	7	12,7
Realizimi i mësimin me orar të përshpejtuar	1	1,0	Mësimdhënie e qartë	3	5,5
Mundësi shkollimi/diplomimi edhe për ata që janë më të vjetër në moshë	3	3,1	Kushtet e mira për mësim	6	10,9
			Staf i mirë i shkollës	4	7,3
			Forma e përshpejtuar e mësimin	8	14,5
			Mësimi praktik	2	3,6
			Mundësitë për të studiuar	3	5,5
Gjithsej:	98	79,0	Gjithsej:	55	44,4

Mangësitë që hasen në realizimin e këtyre programeve mësimdhënësit vlerësojnë të jenë mosprezenca e të gjithë vijuesve të regjistruarve në program (29,6%), përderisa vijuesit mangësi kryesore vlerësojnë të jetë mungesa e literaturës adekuate për program (19,2%), tabela në vijim.

Mësimdhënës	Nr	%	Vijues	Nr	%
Mosprezenca e të gjithë vijuesve të regjistruarve në program	21	29,6	Mungesa e kabineteve për lëndët specifike	4	15,4
Literatura jo adekuate për programin	7	9,9	Mungesa e literaturës adekuate	5	19,2
Mungesa e pajisjeve në kabinete	4	5,6	Mosrespektimi i orarit mësimor/konsultimeve	4	15,4
Mosrealizimi i praktikës profesionale në ndërmarrjet jashtë shkolle	6	8,5	Mungesat e arsimtarëve në orarin e caktuar për mësim/konsultime	2	7,7
Mungesa e kandidatëve dhe pagesa e mësimdhënësve	5	7,0	Numri i vogël i vijuesve	1	3,8
Mungesa e teksteve për të gjitha lëndët mësimore	8	11,3	Ndryshimet e shpeshta në orar dhe mësimdhënës	3	11,5
Mungesa e kushteve për nxënës me nevoja të veçanta	6	8,5	Orari i gjatë i mësimin	2	7,7
Mbajtja e mësimin të rregullt me tri ndërrime	4	5,6	Mbajtja e mësimin gjatë vikendeve	4	15,4
Mungesa e laboratorëve dhe punëtorive	2	2,8	Udhëtimi shkollë-shtëpi	1	3,8
Trajnimit i pamjaftueshëm i mësimdhënësve	3	4,2			0,0
Mungesa e vijuesve në mësim dhe kërkesa e tyre për pjesëmarrje në test përfundimtar.	5	7,0			0,0
Gjithsej	71	57,3		26	21,0

Ajo që mësimdhënësit dhe vijuesit sugjerojnë për të ndryshuar në funksion të avancimit të programeve të AARr-së në të ardhmen është që të shkollat mësimin e rregullt ta mbajnë në maksimumi dy ndërrime dhe të ketë pastaj më shumë hapësirë kohore për realizimin e AARr-së, përdorimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe në komunikim, sigurimin e literaturës për lëndët përkatëse, vijueshmëria e vijuesve të jetë më në nivel, pajisja e kabineteve për punën praktike etj, tabela në vijim:

Mësimdhënës	Nr	%	Vijuesit	Nr	%
Të ketë kushte më të mira dhe programe të avancuara	7	11,7	Angazhim më i madh i mësimdhënësve	1	1,9
Vijueshmëria e vijuesve të jetë më e rregullt	8	13,3	Pajisja e kabineteve për punë praktike	6	11,1
Të ketë bashkëpunim me biznese për realizimin e pjesës praktike	4	6,7	Sigurimi i literaturës për lëndët përkatëse	13	24,1
Të ketë unifikim të programeve	1	1,7	Sigurimi i materialeve mësimore	2	3,7
Të ketë pagesa shtesë për mësimdhënës	6	10,0	Mbajtja e orëve shtesë	1	1,9
Të realizohet PP për çdo lëndë profesionale	2	3,3	Përshtatja e orarit me nevojat e grupit	2	3,7
Të shfrytëzohen planet dhe programet adekuate dhe kabinetet	6	10,0	Organizim më i mirë i praktikës profesionale	7	13,0
Të përmirësohet infrastruktura në shkolla	5	8,3	Përdorimi i TIK në mësimdhënie dhe komunikim	16	29,6
Të ketë tekste dhe literaturë adekuate	1	1,7	Të ketë seriozitet në mbajtjen e mësimit	3	5,6
Shkolla të punojë me një ose dy ndërrime, të zgjatet orari mësimor për të rriturit	11	18,3	Të mos ketë mungesa nga ana e mësimdhënësve në orët mësimore dhe praktikë	1	1,9
Mësimi të mbahet gjatë ditëve të punës	1	1,7	Të sigurohet udhëtimi për vijuesit	1	1,9
Të ketë punëtori në shkollë për realizimin e PP-së	4	6,7	Të vazhdojë kështu siç është	1	1,9
Të ndryshojë forma e mësimit, jo vetëm ligjërime, por edhe punë praktike	1	1,7			
Të informohemi për praktikën e këtyre programeve në nivel vendi	2	3,3			
Harmonizimi i planeve mësimore, përshtatja me fondin e orëve.	1	1,7			
Gjithsej:	60	48,4	Gjithsej:	54	43,5

Në fushën e zhvillimit profesional të mësimdhënësve të angazhuar në programet e AARr-së mësimdhënësit shtrojnë nevojën për:

Komentet/kërkesat e mësimdhënësve për aspekte të AARr-së	Nr	%
Trajnim specifik për fushën e Andragogjisë;	37	12,8
Këmbimi i informacioneve/bashkëpunimit në mes kolegëve të së njëjtës shkollë;	42	14,6
Këmbimi i informacioneve/bashkëpunim me shkollat me profile të njëjta profesionale;	44	15,3
Bashkëpunim me shkolla/institucione me vende të tjera me përvoja të avancuara në fushën e arsimit dhe aftësimin të të rriturve;	50	17,4
Posedim i literaturës së përkthyer në fushën e Andragogjisë;	35	12,2
Pjesëmarrja në konferenca dhe seminare për fushën e Andragogjisë;	49	17,0
Pjesëmarrja në takime, debate dhe punëtori me tema nga fusha e Andragogjisë;	31	10,8
Komentet/kërkesat e koordinatorëve për aspekte të AARr-së	Nr	%
Të përcaktohet statusi dhe roli i koordinatorit të AARr-së;	2	15,4
Të përcaktohet qartë kriteri për përzgjedhjen e mësimdhënësve për angazhim në program;	4	30,8
Të unifikohet rregullorja për pagesën e personave/stafit të angazhuar në programin e AARr-së;	3	23,1
Të trajnohen koordinatorët për detyrat e tyre në programin e AARr-së;	1	7,7
Të trajnohen koordinatorët për aspekte të Andragogjisë.	1	7,7

5.2. *Opinionet e përfaqësuesve të institucioneve arsimore për aspekte të caktuara të AARr-së*

Përveç anketës së realizuar me vijuesit, mësimdhënësit dhe koordinatorët e AARr-së, në mostrën e studimit u përfshi edhe realizimi i intervistës me udhëheqës të shkollave dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse që merren me AAP-në dhe AARr-në. Në pyetësinë e realizuar me ta kemi bërë përpjekje që të përfshihen pyetje orientuese për marrjen e informacionit relevant për aspekte të AARr-së që lidhen drejtpërdrejt me kompetencat dhe përgjegjësitë e strukturave të intervistuar.

5.2.1. Struktura e mostrës së përfshirë në intervistë

Në mostrën e udhëheqësve të shkollave profesionale u përfshinë 6 drejtorë, 3 zv.drejtorë dhe 3 sekretarë nga shkollat përkatëse. Përvoja e tyre e punës në pozita udhëheqëse në shkolla sillej nga 3 deri në 15 vjet, ndërsa trajnime specifike për fushën e andragogjisë rezultoi të mos kishte asnjë nga udhëheqësit e intervistuar.

Mostrën tjetër të përfshirë në intervistë e përbëjnë pesë përfaqësuesve të arsimit të mesëm të lartë në nivel të DKA-ve përkatëse, një zyrtar nga zyra për Arsim joformal në MASHT, një përfaqësues nga Agjencia për arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin e të rriturve dhe një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Për detajet e mostrës së përfshirë në intervistë shih tabelën nr .2 në shtojcë.

5.2.2. *Legjislacioni aktual që rregullon organizimin dhe realizimin e AARr-së*

Në intervistën e realizuar me mostrën kemi synuar që fillimisht të marrim informacionin se sa përfaqësuesit e shkollave dhe institucioneve janë të informuar për legjislacionin aktual që rregullon organizimin dhe realizimin e mësimit për të rritur në shkollat e AAP-së dhe në cilin legjislacion mbështesin ata funksionimin e këtyre programeve.

Zyrtarja për arsim joformal në MASHT deklaroi ligjet, specifikisht Ligjin për AARr-në dhe UA përkatëse si dokumentacion bazë për funksionimin e AARr-së. Ligji për arsimin e të rriturve (2013) është më i hapur, nuk i kufizon gjërat, jep mundësi të reja dhe është i harmonizuar me legjislacionin e ri në Kosovë dhe me politikat e BE-së. Ky ligj rregullon se cilat shkolla të AA mund të ofrojnë dhe realizojnë programe të mësimit për të rritur. Shkolla profesionale janë gjithsej 62, janë shkolla publike që ofrojnë mësim të rregullt dhe mësim për të rriturit. Të gjitha profilet që realizohen në mësimin e rregullt janë profile që mund të realizohen edhe me të rriturit. Është në proces rishikimi i rregullores për grumbullimin dhe shpërndarjen e financave në shkollat e AAP-së, përfshirë edhe AARr-në.

Sipas mostrës së udhëheqësve të shkollave dhe përfaqësuesve të DKA-ve, legjislacion kryesor mbi të cilin bazohet organizimi dhe realizimi i mësimit për të rritur në institucionet e AAP-së, janë Ligji për AARr-në, UA që dalin nga ky ligj, p.sh. *UA 1/2014, Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional*, dhe UA të tjera, si dhe rregulloret përkatëse. Ka nga të intervistuarit që me legjislacionin i referohen edhe dokumentacionit shkollor, si librave amë, librit të protokolleve, planeve dhe programeve mësimore (Sh. Gjeçovi), por ka edhe nga ata që përveç ligjit për AARr-në funksionimin e AARr-së e referojnë edhe përmes Ligjit për Qeverisje Lokale, Ligjit për Arsimin e Mesëm të Lartë, Ligjit për AAP, Ligjit për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës (DKA Gjilan).

Sipas përfaqësuesit të AAAPRr-së, legjislacion bazë për AAP-në dhe AARr-në janë pikërisht ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ndryshimet e parapara në legjislacion pritet të ndodhin. Njohja e mësimit paraprak është një ndër risitë që sjell legjislacioni i rishikuar.

5.2.3. *Akreditimi i shkollave të AAP-së*

Sipas MASHT-it, shkolla profesionale në Kosovë janë gjithsej 62. Në viti 2003 deri në 2008, MASHT me një vendim i ka caktuar shkollat dhe profilet për AARr, tani me ligjin e ri, shkollat e AAP-së që kanë kushte të mira kadrovike dhe hapësirë të përshtatshme mund të ofrojnë programe të AARr-së, varësisht nga kërkesat e komunave, ndërsa MASHT vetëm informohet për këto programe.

Sa i përket akreditimit, shkollat e AAP-së ende nuk janë të akredituara në AKK. Sipas përfaqësues së AKK-së, vendimin për të hyrë në proces të validimit të kualifikimit dhe akreditimit të shkollave publike i takon MASHT-it. Parakusht për të hyrë në këto procese jnaë zhvillimi i standardit të profesionit¹⁰, verifikimi i tyre dhe kualifikimi/moduli në formatin e

¹⁰ AKK përcakton standardet për zhvillimin e kualifikimeve, mbi bazën e të cilave ofruesit e AAP-së mund të zhvillojnë kualifikime, të cilat i paraqesin në AAK për akreditim. Këtë rol (rolin e hartuesit të kualifikimeve) mund ta ketë Agjencioni për AAP dhe AARr në të

caktuar nga AKK-ja. Kushtet dhe procedurat për validim të kualifikimit dhe akreditim të ofruesve të AAP janë të përcaktuara në Udhëzim Administrativ.

5.2.4. Bashkëpunimi ndërinstitucional për realizimin e AAP-së dhe AARr-së

Bashkëpunimi i shkollave të AAP-së me MASHT-in, sipas zyrtares së MASHT-it, vlerësohet të jetë i mirë. Më herët (viti 2007), MASHT-i me një vendim i ka caktuar shkollat dhe profilet për AARr, tani me ligjin e ri, shkollat e AAP-së që kanë kushte të mira kuadroviqe dhe hapësirë të përshtatshme mund të ofrojnë programe të AARr-së, varësisht nga kërkesat e komunave, ndërsa MASHT-i vetëm informohet për këto programe. MASHT-i ka bashkëpunim me shkollat në realizimin e trajnimeve, takimeve me koordinatorët e programeve dhe bartjen e të gjitha politikave të shkollat, qoftë përmes DKA-ve apo përmes inspektorëve të arsimit. E vetmja mangësi në raport me AARr-në deri më tani është se shkollat nuk raportojnë në programin SMIA, nuk ka hapësirë në këtë program për t'u përfshirë të dhënat për programet e AARr-së. Është duke u punuar që të sigurohet një hapësirë e veçantë (aneks) në SMIA për përfshirjen e këtyre të dhënave në të ardhmen.

Edhe udhëheqësit e shkollave deklarojnë se bashkëpunimi i tyre me MASHT-in ndodh në sigurimin e legjislacionit, financave (edhe pse aspekti financiar ka kaluar në DKA dhe tani edhe në agjenci), kurrikulave etj. Bashkëpunimi më i madh me MASHT-in potencohet për aspektin e raportimit të statistikave nëse MASHT-i i kërkon ato (QK Malishevë, 'A. Durrsaku'), më pak në fushën e trajnimit të mësimdhënësve ('Gjin Gazuli'), kontakte të vazhdueshme për informacione të ndryshme dhe për raportim në fund të vitit kalendarik ('A. Gllavica'), informimi për risitë nga zyra për AJF në MASHT ('P. Bogdani') dhe bashkëpunimi lidhur me shpërndarjen e mjeteve vetjake ('A. Hadri'). Ka edhe mangësi në komunikimin me MASHT-in, meqenëse shkollat duhet të presin kohë të gjatë për të marrë përgjigje, konsultime nga MASHT-i, zakonisht nuk kthehet përgjigje e shpejtë ('I. Boletini').

Bashkëpunimi i shkollave me DKA-të përkatëse sipas udhëheqësve të shkollave rezulton të jetë më i lehtë dhe më i mirë, zakonisht bashkëpunim lidhur me mjetet financiare dhe për hapjen e konkurseve ('I. Boletini'), ofrimin e statistikave për vijuesit, profilet lidhur me AAP-në, ndërsa për AARr-në jo dhe aq (QK Malishevë), për statistika dhe inspektim përmes Zyrës rajonale ('P. Bogdani'), raportim për vijuesit, financat dhe provimet ('A. Sinani') dhe lidhur me lirimin nga pagesa e vijuesve me status special ('A. Hadri').

ardhmen. AKK, zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve e realizon përmes tri procesve kryesore: Procesit të verifikimit të SP, Procesit të validimit të kualifikimit dhe Procesit të akreditimit të ofruesve të AAP.

Zhvillimi i SP bëhet nëpërmjet bashkëpunimit që përfshin MASHT-in, MPMS-në dhe ministritë tjera relevante dhe partnerët social dhe shoqatat e zejtarëve. Qëllimi i SP është involvimi/kyqja e partnerëve social duke përfshirë edhe bizneset për të paraqitur nevojat e tregut të punës. SP i cili pas verifikimit merr përgjigje pozitive nga AKK, miratohet nga KAAPRr dhe quhet standard kombëtar i profesionit.

Bashkëpunimi i shkollave të AAP-së me bizneset për realizimin e PP-së nga udhëheqësit e shkollave deklarohet si problem dhe sfidë edhe për nxënësit e mësimin të rregullt. Kur bizneset janë të interesuar të marrin nxënës për PP, atëherë ata kërkojnë që ky bashkëpunim të rregullohet me marrëveshje të dyanshme. Sa u përket të rriturve, ata rrallë kryejnë PP, meqenëse shumica e tyre janë të kyçur në biznese dhe paralel me punën e vijnë edhe AARr-në ('Gj. Gazuli', 'Sh. Gjeçovi'), edhe bizneset kanë të punësuar shumë familjarë dhe është pak e vështirë të gjendet vend për PP e vijuesve ('Sh. Gjeçovi'). Ka deklarime se në shkolla organizohet vetëm mësim konsultativ me të rriturit dhe PP realizohet nëpër kabinete/punëtori të shkollës ('A. Durrsaku'), ka edhe raste kur bizneset në fillim të vitit kërkojnë nga shkollat praktikantë, përfshirë edhe të rriturit ('H. Prishtina'). Një numër i madh i nxënësve janë të punësuar, vijnë nga bizneset, shkolla ka vizita në biznese, por jo marrëveshje ('A. Gllavica'), ka edhe shkolla të cilat nuk kanë asnjë bashkëpunim me bizneset lidhur me PP ('A. Hadri').

Bashkëpunimi i shkollave të AAP-së me AAAPARr, shkollat të cilat janë nën ombrellën e agjencisë deklarohen se kanë filluar të kenë bashkëpunim lidhur me AAP-në. Deri më tani këto shkolla janë përfshirë në programe të trajnimit të ofruara nga agjencia. Lidhur me AARr-në me agjencinë shkollat kanë pasur vetëm konsultime dhe diskutime për format e realizimit të këtyre programeve në të ardhmen ('11 Marsi'). Sipas përfaqësuesit të agjencisë, në fazën e pilotimit (2014/16) agjencia më tepër është marrë me konstituimin e tij (misionit, rolit, detyrave, bashkëpunimit, etj.) dhe me Qendrat e Kompetencës (përfshirë edhe shkollat 'SH. Gjeçovi' dhe '11 Marsi') në fushën e AAP-së, ndërsa me realizimin e programeve të mësimin për të rritur planifikojnë të merren në vitin 2015/16 e tutje.

Bashkëpunimi në mes të shkollave të AAP-së lidhur me AARr-në - udhëheqësit kanë deklaruar se bashkëpunimi në mes të shkollave të AAP-së është jashtëzakonisht i pakët. Ka këmbime të informacionit/konsultime mes shkollave me profile të njëjta lidhur dhe modelet e realizimit të AARr-së ('11 Marsi', 'A. Hadri'). Ka raste kur shkollat deklarohen se shkolla e tyre nuk ka bashkëpunim me shkollat e tjera, të tjerët kanë bashkëpunim me ta, meqenëse llogarisin se janë model për AARr-në ('A. Gllavica'). Shumica e shkollave deklarohen se nuk kanë fare bashkëpunime të ndërsjella lidhur me AARr-në (QK Malishevë, 'A. Sinani', 'A. Durrsaku'), dhe deklarohet bashkëpunim në mes të shkollave të cilat janë nën ombrellën e agjencisë, kryesisht pjesëmarrja në trajnime ('11 Marsi').

Bashkëpunimi MASHT-DKA, sipas përfaqësueses së MASHT-it, është i rregulluar me Ligjin për AARr-në dhe me UA të dala nga ligjet. Janë UA specifike që rregullojnë këtë bashkëpunim, si: UA Plani i punës, UA Përfshirësit në moshë, etj. Edhe përfaqësuesit e DKA-ve deklarohen se bashkëpunimi me MASHT-in ndodh me rastin e raportimit të të dhënave për numrin e vijuesve të AARr-së, të cilat dërgohen çdo fillim dhe fund të vitit, të dhënat për maturën (DKA Ferizaj) dhe raport bashkëpunues në bazë të kompetencave reciproke (DKA Mitrovicë). Ka edhe përgjigje për bashkëpunim jo të mirë në mes të DKA-së dhe MASHT-it (DKA Fushë-Kosovë).

Bashkëpunimi MASHT - AAAPARr për AARr-në, sipas MASHT-it, është në krijimin e politikave dhe zbatimin e tyre. Deri më tani ka pasur takime, i janë prezantuar agjencisë të arriturat dhe politikat e MASHT-it për më tutje lidhur me AARr-në. Sipas përfaqësuesit të

agjencisë, bashkëpunimi me MASHT-in potencohet të jetë i ngushtë, sidomos me divizionin e AAP-së në MASHT dhe të AARr-së në hartimin e kornizave ligjore dhe dokumenteve përcjellëse.

Bashkëpunimi në mes të DKA-ve të komunave të përfshira në studim në raport me programet e AARr-së, përfaqësuesit e tyre deklarojnë se ka raporte të mira dhe koordinuese në mes të DKA-ve (DKA Mitrovicë) dhe se bashkëpunimi mes tyre ndodh zakonisht rreth konsultimit për legjislacionin dhe regjistrimet në AAP dhe AARr (DKA Ferizaj). Ka edhe raste kur ky bashkëpunim deklarohet të jetë i mangët (DKA F. Kosovë).

Bashkëpunimi i agjencisë me DKA-të nga përfaqësuesi i agjencisë deklarohet të jetë i mirë në raport me AAP-në dhe AARr-në. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes me DKA-të, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për shkollat e AAP-së kanë kaluar nga DKA-të në agjenci.

5.2.5. Roli dhe detyrat e koordinatorit të AARr-së

Sipas zyrtares së MASHT-it, koordinatorët e AARr-së nuk i cakton MASHT-i, por caktohen nga vetë shkollat. MASHT-i vetëm i ka rregulluar pagesat e personave të angazhuar në program. Si pozitë nuk është e rregulluar me ndonjë legjislacion të veçantë. Meqenëse tani është një formë tjetër e organizimit të mësimin, në takimet me shkollat është biseduar që për nevoja të brendshme, në funksion të avancimit të cilësisë, shkollat të caktojnë koordinatorë të këtyre programeve, të cilët do të koordinojnë punët në program rreth regjistrimit të vijuesve, vijimit dhe mësimin, mbarëvajtjes së mësimin, në përzgjedhjen e mësimdhënësve etj. D.m.th koordinatori e ka rolin e një kujdestari të klasës. Koordinatori përzgjidhet nga drejtori, duhet me qenë mësimdhënës i shkollës, nuk ka kritere të shkruara për përzgjedhje dhe mbetet në të ardhmen rregullimi i detyrave, formës së përzgjedhjes dhe kritereve për angazhim në AARr.

Sipas udhëheqësve të shkollave, për përcjelljen e mbarëvajtjes së proceseve lidhur me organizimin dhe realizimin e AARr-së shkollat kanë emëruar koordinatorë të këtyre programeve. Praktikata e shkollave për përzgjedhjen e koordinatorëve dhe kohëzgjatjen e mandatit ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Zakonisht shkollat caktojnë një koordinator të AARr-së (shkolla 'Sh. Gjeçovi' ka të angazhuar dy koordinatorë të AARr-së). Zakonisht koordinatorin e përzgjedh drejtori i institucionit (QK Malishevë, 'A. Sinani', 'A. Durrsaku'), apo kur propozimin e bën drejtori dhe në konsultim me aktorët e brendshëm të shkollës merret vendim për personin që angazhohet në këtë cilësi ('11 Marsi', 'I. Boletini', 'Sh. Gjeçovi', 'Gj. Gazuli'). Ka edhe raste kur përzgjedhja bëhet nga DKA-ja përkatëse me një kontratë njëvjeçare të punës, shkolla nuk ka qasje në këtë proces ('A. Gllavica'). Kritere të shkruara për angazhim në këtë pozitë nuk ka, zakonisht angazhimi dhe suksesi në punë merren për bazë me rastin e përzgjedhjes (të gjitha shkollat). Sa i përket mandatit, ka raste kur koordinatori është përzgjedhur që nga koha e pasluftës dhe vazhdon ende me angazhimin në këtë cilësi ('Sh. Gjeçovi'), që nga viti 2009 ('11 Marsi'), apo me mandat 3-4-vjeçar ('H. Prishtina', 'A. Sinani'). Edhe detyrat dhe obligimet e koordinatorit të angazhuar nuk janë të rregulluara me ndonjë dokument apo vendim të veçantë pune. Zakonisht detyrat e koordinatorit janë të barabarta me rolin dhe detyrat e një kujdestari të klasës ('P. Bogdani'). Një vendim të lëshuar nga drejtori i shkollës (në bazë të autorizimeve dhe kompetencave), me rastin e emërtimit të koordinatorit të AARr-së, e kemi hasur vetëm te Qendra e Kompetencës në Malishevë.

Arsyetimin për emërtim drejtori e orienton në nevojën për t'u përgatitur si qendër për fillimin e procesit arsimor dhe aftësimin për të rritur për vitin shkollor 2014-2015, ndërsa në dokument (ose në ndonjë dokument tjetër plotësues) nuk përcaktohen roli ose detyrat e personit të angazhuar në këtë cilësi.

5.2.6. *Angazhimi i mësimit në programet e AARr-së*

Lidhur me përzgjedhjen dhe angazhimin e mësimit në programet e AARr-së, zyrtarja e intervistuar në MASHT deklaroi se mësimit të angazhuar janë mësimit të rregullt, nuk ka kritere të shkruara për përzgjedhjen e tyre, marrëveshje e brendshme është që ata me qenë mësimit të suksesshëm. Një pjesë e kemi përfshirë në punëtori apo seminare informuese lidhur me angazhimin e tyre në programet e mësimit me të rritur.

Udhëheqësit e shkollave kanë deklarata të përafërta lidhur me angazhimin e mësimit në programin e AAP-së. Udhëheqësit deklarohen se nuk ka kritere të caktuara për angazhimin e mësimit në program dhe është me rëndësi që mësimit të jetë i angazhuar edhe në mësimit të rregullt dhe të njëjtën lëndë ta realizojë edhe në AARr. Kryesisht angazhimi i mësimit të interesuar bëhet me rotacion.

5.2.7. *Regjistrimi i vijuesve në AARr*

Sipas MASHT-it, konkursi për regjistrim në AARr është i rregulluar me ligj. MASHT-i i ka hartuar kriteret, tani komunat dhe shkollat i përshtaten ligjit.

Edhe udhëheqësit e shkollave deklarojnë formë të njëjtë të hartimit dhe shpalljes së konkursit (bazuar në legjislacion). Përmbajtja e konkursit hartohet nga shkolla, dërgohet në DKA për verifikim dhe shpallet në faqe të komunës.

Përfaqësuesit e DKA-ve kanë shpjegim tjetër për procedurën e konkursit. Sipas tyre, konkursin e harton DKA-ja në bashkëpunim me shkollat, shpallet në DKA (DKA Ferizaj). Konkursi hartohet nga MASHT-i (DKA Pejë), nga DKA-ja, në bashkëpunim me shkollat (DKA F. Kosovë).

Sipas përfaqësuesit të agjencisë, ky institucion ende nuk është marrë me regjistrimet në AARr dhe në marrëveshje e ka edhe rregullimin e çështjeve të konkursit në të ardhmen.

Agjencia shqyrton mundësitë që në të ardhmen të ketë bashkëpunim me AKK-në dhe vijuesve të këtyre programeve tu mundësohet njohja e mësimit paraprak dhe në programet e AARr-së tu nënshtrihen vetëm provimeve diferenciale në lëndët shtesë. Sipas përfaqësueses së AKK-së, është miratuar UA për *Njohjen e Mësimit Paraprak*, gjithashtu është në zhvillim e sipër dokumenti i politikave mbi procedurën e kriteret e vlerësimit mbi njohjen e mësimit paraprak. AKK është në proces të fillimit të pilotimit të NjMP. Pas pilotimit të këtyre kriterëve dhe procedurave për vlerësimin e njohes së mësimit paraprak, AKK do të jetë e hapur që të akreditojë institucione që do të ofrojnë njohjen e mësimit paraprak.

Lidhur me regjistrimin e vijuesve, udhëheqësit deklarojnë procedura të njëjta sikurse te regjistrimi i nxënësve në mësimit të rregullt, kritere për regjistrimin e të rriturve, që vijuesi të jetë mbi 18 vjeç, të ketë të përfunduar klasën e 8-të (sistemi i vjetër) ose klasën e 9-të ('A. Hadri', 'Sh. Gjeçovi'). Për përsëritës ka UA të veçantë ('11 Marsi', 'Gj. Gazuli'), mosha mbi 17 vjeç, për më të rinjtë kërkohet pëlqimi i prindit ('11 Marsi', 'Sh. Gjeçovi'), dëftesa e

shkollimit të obliguar/ shkollimit paraparak, certifikata e lindjes, mosha mbi 18 vjet. Shkolla nuk ka numër të madh të kandidatëve, prandaj edhe nuk ka kritere ('A. Durrsaku'), kriter është shkolla paraprake dhe mosha ('H. Prishtina', 'A. Sinani').

Në pyetjen se a testohet/vlerësohet parapraakisht niveli hyrës i vijuesve, të gjithë udhëheqësit e shkollave deklarohen se jo, regjistrimi i vijuesve bëhet si në mësimin e rregullt, pa testim paraparak, por ka edhe rast kur udhëheqësi i shkollës deklaron se para regjistrimit vijuesit testohen për nivelin e tyre hyrës në shkrim dhe lexim ('11 Marsi').

5.2.8. Dokumentacioni i brendshëm shkollor për realizimin e AARr-së

Në pyetjen vijuese, lidhur me atë se a hartojnë shkollat dokumentacion të brendshëm shkollor për nevojat e AARr-së, udhëheqësit e shkollave deklarojnë se në momentin që hapet konkursi orarin e mësimave dhe provimeve, afatet/oraret e konsultimeve etj., i harton koordinatori i AARr-së ('Sh. Gjeçovi', 'Gj. Gazuli', 'I. Boletini'). Pastaj lëndët, mësimdhënësit dhe gjithë informacionin, për të cilat me një njoftim të veçantë apo telefonatë informohen vijuesit ('A. Durrsaku'), gjithashtu edhe me pjesëmarrjen e aktiveve të klasave dhe ky dokumentacion publikohet edhe në uebfaqen e shkollës ('H. Prishtina'). Ka edhe shkolla që deklarojnë se ky dokumentacion nuk e ka formën e një dokumenti të plotë, por hartohet gradualisht dhe publikohet në tabelën e njoftimeve në shkollë (QK. Malishevë), apo deklarim kur shkolla këto dokumente i merr të gatshme nga MASHT-i ('A. Gllavica').

Nga shkollat e përfshira në studim kemi kërkuar që për qëllime studimi të ofrojnë dëshmi të dokumentacionit shkollor të hartuar për AARr-në. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezultoi se shkollat nuk kanë Plan zhvillimor për arsimin formal të të rriturve të integruar në PZSHH-në e shkollës, përderisa shumica e shkollave kanë Plan vjetor të punës për AARr-në, i cili është i hartuar veçmas, jo i integruar në Planin vjetor të punës së institucionit ashtu siç e jep *UA 13/2014 Plani vjetor i punës dhe Plani zhvillimor i ofruesve të arsimit dhe aftësisimit formal për të rritur*.

Lidhur me planet dhe programet mësimore për realizim në AARr, përfaqësuesja e MASHT-it deklaroi se janë plane dhe programe të njëjta me mësimin e rregullt, duhet vetë të përshtaten për specifikat e AARr-së. Shkollat i hartojnë/adaptojnë këto plane (aktivet profesionale, mësimdhënësit). Shkollat nuk kanë ndonjë bashkëpunim për hartimin e planeve dhe programeve mësimore.

Sipas përgjigjeve të udhëheqësve të shkollave, ky dokumentacion hartohet nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse, ka bashkëpunim me aktivet profesionale brenda shkollës lidhur me hartimin e Planeve dhe programeve për AARr-në. Kryesisht merren modelet e brendshme të shkollës, nuk ka bashkëpunim me shkollat e tjera në hartim të këtij dokumentacioni, e as në marrjen e modeleve (qoftë edhe të shkollave me profileve të njëjta profesionale). Për bazë merren planet dhe programet mësimore zyrtare për AAP-në, të cilat përshtaten dhe harmonizohen me kërkesat e AARr-së, apo deklarime se shkolla nuk harton fare plane dhe programe për AARr-në ('A. Hadri').

Sipas përfaqësuesve të DKA-ve, bashkëpunimi i ndërsjellë në mes të shkollave dhe DKA-ve përkatëse lidhur me dokumentacionin shkollor potencohet të jetë i pakët. Roli i DKA-ve në

këtë rast është ai këshillues (DKA Ferizaj), ka bashkëpunim me drejtorët e shkollave ose me koordinatorët (DKA Mitrovicë), apo ka deklarim kur DKA-ja bazohet në UA përkatëse për rregullimin e këtij bashkëpunimi (Gjilan).

Përfaqësuesi i agjencisë deklaroi se ky institucion i themeluar në vitin 2014 ende nuk ka filluar të merret me aspekte që ndërlidhen me AARr-në dhe se kjo për agjencinë mbetet prioritet për realizim në të ardhmen.

5.2.9. Tekstet dhe materialet mësimore për realizimin e AARr-së

Udhëheqësit e shkollave të intervistuar në studim deklarojnë se kanë sfida të jashtëzakonshme lidhur me sigurimin e literaturës profesionale, teksteve dhe materialeve mësimore. Ky problem i përcjell shkollat edhe në realizimin e mësimit të rregullt (të gjitha shkollat), por për programin e AARr-së kjo sfidë është edhe më e ndërlikuar, referuar specifikave të këtyre programeve. Zakonisht zgjidhja bëhet nga ana e mësimitdhënësve, meqenëse ata janë të angazhuar edhe në mësimin e rregullt dhe tashmë kanë përvojë edhe me programet e AARr-së ('11 Marsi', 'A. Sinani'), mësimitdhënësit përgatisin skripta, sigurojnë materiale nga interneti, kopje të materialeve ('H. Prishtina', 'Gj. Gazuli', 'I. Boletini', '11 Marsi'), por shërbehen edhe me materiale të njëjta si në mësimin e rregullt ('A. Durrsaku'), ka raste kur vetë mësimitdhënësit ndihen të obliguar që të ofrojnë materiale të gatshme për vijuesit dhe këto materiale ata i hulumtojnë, i përmbledhin në formë të skriptave, materialeve të shtypura dhe i ofrojnë në faqe të internetit, burime të tjera ku vijuesit kanë qasje ('P. Bogdani').

5.2.10. Format e realizimit të AARr-së

Udhëheqësit e shkollave të intervistuar deklarojnë se format më të shpeshta të realizimit të mësimit me të rriturit në shkollat e tyre janë kryesisht ato të mësimit konsultativ ('Sh. Gjeçovi', 'A. Durrsaku'), ku vijuesit u nënshtrohen vlerësimeve të brendshme, ndërsa PP vlerësohet në punëtoritë e shkollës. Vijuesit i nënshtrohen edhe testit të jashtëm të maturës ('Sh. Gjeçovi'). Ka edhe raste kur programi realizohet përmes orëve mësimore me vijuesit ('A. Gllavica', 'H. Prishtina'), apo edhe kombinim të të dy formave, varësisht nga numri i vijuesve (ka rënie të numrit!), pra në lëndët teorike mbahen orë mësimore, ndërsa lëndët profesionale realizohen përmes mësimit konsultativ ('11 Marsi', 'A. Sinani') ose në rastet kur nxënësit bëjnë ndryshim të profileve, lëndët teorike i kanë të përfunduara dhe për lëndët profesionale mbahet mësimi konsultativ, ose sillen dëshmi nga punëdhënësi ('H. Prishtina'). Ka deklarim për mbajtjen e orëve mësimore me rastin kur numri i vijuesve është mbi 7, ndërsa në numër më të vogël të tyre shkolla mban vetëm mësimit konsultativ ('A. Hadri').

5.2.11. Pagesat për shërbimet dhe angazhimet në AARr

Lidhur me rregullimin e pagesave për shërbimet e ofruara në programet e AARr-së, zyrtarja e MASHT-it deklaroi se ekziston një rregullore e hartuar në vitin 2004, e cila edhe sot e tutje shërben si bazë për rregullimin e pagesave të vijuesve për programin, pagesën e personave që angazhohen në mësimin për të rritur (koordinatori, mësimitdhënësit, drejtori, zv.drejtori dhe

stafi tjetër i shkollës). Kjo rregullore nuk është ende e miratuar dhe pritet rishikimi dhe miratimi i një rregulloreje të re për këtë aspekt.

Lidhur me pagesën me këtë aspekt, udhëheqësit e shkollave deklarojnë se kjo pagesë bëhet nga vijuesit në xhirollogarinë përkatëse të institucionit përmes bankës dhe është e rregulluar me UA nga MASHT-i. Ka UA edhe për lirimin e kategorive të caktuara nga pagesa, të cilat sjellin dëshmi dhe lirohen nga kjo pagesë ('A. Durrsaku'). Ka edhe sfida për rregullimin e pagesave, meqenëse ka raste kur në program vijnë familjarë (burrë dhe grua) dhe kërkojnë ulje të çmimit ('A. Gllavica'). Problem paraqesin rastet kur në shkolla vijnë një numër i madh i kategorive të liruara nga pagesa dhe kur këto shpenzime pastaj nuk i marrin institucionet përkatëse, por mbetet barrë e shkollës mbulimi i shpenzimeve dhe pagesa e stafit/mësimdhënësve për punën me ta ('A. Durrsaku').

Lidhur me pagesën e stafit të angazhuar për ofrimin e shërbimeve në programet e AARr-së, të intervistuarit deklarojnë se kjo çështje është e rregulluar me rregullore të lëshuar nga DKA/MASHT.

Kemi disa modele të rregullimit të këtij aspekti: Vijuesit paguajnë përmes fletëpagesës dhe mjetet shkojnë në xhirollogarinë e shkollës, të menaxhuar nga DKA. Shkolla përgatit dhe dërgon në DKA listat e mësimdhënësve të angazhuar në program dhe DKA-ja bën pagesën e mësimdhënësve nga këto mjete ('Sh. Gjeçovi'). Mbështetur në rregulloret e MASHT-it për shpërndarjen e pagesave, shkolla ia bashkëngjijt rregulloren dokumentacionit që e dërgon në DKA: përmes kërkesave, listave të mësimdhënësve, memorandumëve me MEF, rregulloreve me DKA-të për të hyrat vetjake të shkollave ('Gj. Gazuli'); Pagesa bazuar në rregulloren e hartuar nga shkolla mbi modelin e rregullores së DKA-së, mësimdhënësit paguhet për orë të angazhimit, ndërsa administrata paguhet me përqindje ('I. Boletini'); Me rregulloren e hartuar dhe të miratuar nga bordi i shkollës, ku janë të përcaktuara mënyrat dhe shumatat për të gjithë personat e angazhuar (QK. Malishevë); Me rregullore, me mësimdhënësit dhe personat e tjerë të angazhuar në AARr bëhet kontratë e veçantë pune, listat dërgohen në DKA dhe mjetet paguhet me paga ('P. Bogdani'). Ka edhe raste kur shkollat kanë probleme për realizimin e këtyre pagesave. Të hyrat shkojnë në DKA, por pagesat nuk realizohen, meqenëse MASHT-i ka konsideruar se nuk ka hapësirë për shpërndarjen e mjeteve, nuk ka legjislacion ('A. Gllavica').

Për të evidentuar informacionin e marrë nga shkollat lidhur me pagesat, nga to kemi kërkuar që të ofrojnë nga një kopje të rregulloreve mbi të cilat ata e rregullojnë këtë aspekt. Nga verifikimi i dokumentacionit të siguruar është evidentuar që këto rregullore u referohen disa nga ligjeve që tashmë janë të shfuqizuara dhe të zëvendësuara me legjislacion të rishikuar, p.sh. Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Rregullores së UMNIK-ut 2002/19, Ligjit për Arsim dhe Aftësim Profesional (versionit paraprak), UA të MASHT të vitet 2003, 2004, 2005 dh 2006, etj.

Koha e hartimit dhe miratimit të rregulloreve nga Këshilli i shkollës në shkollat përkatëse figuron të jetë ajo e vitit 2007, apo raste kur rregullorja nuk ka datë fare të hartimit dhe miratimit të saj, apo kur ky dokument është i miratuar në vitin 2014, mbi bazën e modelit dhe

dokumenteve të njëjta referuese krahasuar me rregulloret e cekura më lart. Për dëshmi të informacionit, në vijim po i paraqesim katër nga dokumentet/rregulloret për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake të siguruara në shkollat e përfshira në studim. Fotoja në vijim.

<p>Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Procedurat e Prokurimit, në bazë të nenit 29 të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm Rregullorja e UNMIK-ut2002/19, në bazë të nenit 19 të Ligjit mbi Arsimin profesional, Udhëzimeve Administrative të MASHT-it nr. 1/2003, 3/2004, 71/2004, 5/2005 dhe 41/2006 si dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit ne mes MASHT-it dhe MEF-it, Këshilli i shkollës <u>Qendra e Kompetencës Malishevë</u> në mbledhjen e mbajtur më dt. <u>27.03.2014</u> aprovoj:</p> <p style="text-align: center;">RR E G U L L O R E N PËR MBLEDHJEN DHE SHPENZIMIN E TË HYRAVE VETANAKE</p> <p style="text-align: right;"><small>Republic of Kosovo-Republic of the e Qendra e Kompetencës-Centre of Competence Malishevë</small></p>	<p><u>nr: 1090 dt. 30.11.2017</u></p> <p>Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Procedurat e Prokurimit, në bazë të nenit 29 të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm Rregullorja e UNMIK-ut2002/19, në bazë të nenit 19 të Ligjit mbi Arsimin profesional, Udhëzimeve Administrative të MASHT-it nr. 1/2003, 3/2004, 71/2004, 5/2005 dhe 41/2006 si dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit ne mes MASHT-it dhe MEF-it, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më dt. <u>30.11.2017</u> aprovoj:</p> <p style="text-align: center;">RR E G U L L O R E N PËR MBLEDHJEN DHE SHPENZIMIN E TË HYRAVE VETANAKE</p>
<i>Qendra e Kompetencës, Malishevë</i>	<i>'Andera Durrsaku', Dardanë</i>
<p>Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Procedurat e Prokurimit, Udhëzimeve Administrative të MASHT-it nr. 1/2003, 3/2004, 71/2004, 5/2005 dhe 41/2006 si dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit ne mes MASHT-it dhe MEF-it, Këshilli i shkollës <u>institucioni edukativo-arsimor, aftësues në mbledhjen e mbajtur më dt. <u>12/11/2017</u> aprovoj:</u></p> <p style="text-align: center;">RR E G U L L O R E N PËR MBLEDHJEN DHE SHPENZIMIN E TË HYRAVE VETANAKE</p>	<p>Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjit për Procedurat e Prokurimit, në bazë të nenit 29 të Ligjit mbi Arsimin fillor dhe të mesëm Rregullorja e UNMIK-ut2002/19, në bazë të nenit 19 të Ligjit mbi Arsimin profesional, Udhëzimeve Administrative të MASHT-it nr. 1/2003, 3/2004, 71/2004, 5/2005 dhe 41/2006 si dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit ne mes MASHT-it dhe MEF-it, Këshilli i shkollës <u>je me imz të: nika në F.11.2017</u> në mbledhjen e mbajtur më dt. <u>12/11/2017</u> aprovoj:</p> <p style="text-align: center;">RR E G U L L O R E N PËR MBLEDHJEN DHE SHPENZIMIN E TË HYRAVE VETANAKE</p>
<i>'Shtjefën Gjeçovi', Prishtinë</i>	<i>'Pjetër Bogdani', Ferizaj</i>

Përveç aspektit kohor, ka raste kur rregulloret e shqyrtuara nuk janë të harmonizuara me UA 11/2011, *Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësisimit për të rritur, të hartuar dhe miratuar nga MASHT-i në vitin 2011*, sa i përket mbledhjes së të hyrave vetjake. Në fakt, rregulloret për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake shumë pak i japin hapësirë rregullimit të mbledhjes së të hyrave, sidomos pagesës së vijuesve të arsimit formal të të rriturve, meqenëse rregulloret e shqyrtuara orientohen më tepër në rregullimin e formave dhe përqindjeve të shpërndarjes/shfrytëzimit të të hyrave vetjake të shkollave. Bazuar në nenin 6 të rregulloreve - *Shfrytëzimi i të hyrave vetjake në përqindje*, vërehet se ka mosharmonizim të rregulloreve për kategoritë e pagesave (mjete të grumbulluara nga të hyrat e kandidatëve për provime, nga të hyrat e përgjithshme nga prindërit, nxënësit, përveç diplomës, nga provimi i diplomës, nga shërbimet prodhuese etj.)

Edhe në konkurset e shpallura nga shkollat, pagesat e parapara për vijuesit e AARr-së, nuk janë të harmonizuara me kërkesat e UA-së. Një shembull të tillë mund ta gjejmë te konkursi i shpallur nga DKA e Prishtinës, datë 11.11.2014, ku krahasuar me kërkesat e UA-së konkursi ka këtë pasqyrë:

Regjistrimin e vitit..... për një klasë 100€	Për regjistrim të viti për një klasë..... 100.00€
Praktika Profesionale..... 50€	Për dhënien e provimeve plotësuese dhe diferenciale..... 08.00€
Provimi diferencial..... 10€	Për lëndët me shkrim dhe praktikë..... 10.00€
Provimet përfundimtare të klasës, certifikata... 30€	Pagesa për punë praktike do të bëhet varësisht nga drejtimi, në max 50.00€
Diploma..... 20€	
<i>UA 11/2011, Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur, të hartuar dhe miratuar nga MASHT-i në vitin 2011.</i>	<i>Konkurs i DKA-së së Prishtinës, i shpallur më 11.11.2014.</i>

Edhe përfaqësuesit e DKA-ve të përfshirë në intervistë deklarojnë se realizimi i pagesave në programet e AARr-së bazohet ende në rregulloret e ‘vjetra’ të hartuara nga MASHT-i dhe se janë duke punuar në hartimin e Rregullores që ka të bëjë me rregullimin e pagesave dhe shpërndarjes së mjeteve për shkollat e AAP-së (DKA Ferizaj).

5.2.12. Shkollat model për realizimin e AARr-së

Respondentët e përfshirë në intervistë janë pyetur rreth asaj se si i vlerësojnë ata kushtet e shkollave të tyre për realizimin e AARr-së dhe a mendojnë se ka ndonjë shkollë në Kosovë që mund të merret model pozitiv për realizimin e AARr-së.

Përfaqësuesja e MASHT-it deklaroi se shkollat që tanimë ofrojnë mësim për të rritur i plotësojnë kushtet kuadrore edhe të infrastrukturës, prandaj edhe i ofrojnë këto programe. Mbetet detyrë e Autoritetit Kombëtar në procesin e akreditimit të shkollave të vlerësojnë se cilat shkolla mund të ofrojnë mësim për të rritur, ata e bëjnë vlerësimin e performancës së shkollave edhe lidhur me këto programe.

Për këto aspekte, të gjithë udhëheqësit e shkollave vlerësojnë kushtet e shkollave të tyre si të mira për realizimin e AARr-së. Ata potencojnë se shkollat kanë kuadër të përgatitur dhe kushtet për AARr-në janë të njëjta, sikurse edhe në mësimin e rregullt, kështu që duhet vazhduar me këtë formë të mësimin. Aspekte që duhet avancuar, sipas tyre, mund të jenë: Ngritja e kostos për vijuesit, meqenëse ofrimi i shërbimeve cilësore kërkon kosto të lartë (‘Sh. Gjeçovi’), pajisja e kabineteve dhe firmave ushtrimore në kuadër të shkollës (‘Gj. Gazuli’).

Sa u përket modeleve të avancuara, të gjithë udhëheqësit e intervistuar vlerësojnë se shkollat e tyre mund të jenë model për të tjerët në raport me organizimin dhe realizimin e AARr-së. Të njëjtit pohojnë se ka pak bashkëpunim në mes të shkollave dhe se ata nuk e kanë informacionin e plotë se çfarë ndodh në shkollat e tjera lidhur me këto programe, andaj edhe nuk mund të kenë shumë ide se çfarë ndodh në këto programe.

5.2.13. Njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në programet e AARr-së

Njohuritë dhe shkathtësitë e vijuesve, të fituara në programet e AARr-së nga udhëheqësit e shkollave, vlerësohen si jo të njëjtit nivel me ato të nxënësve të mësimin të rregullt. Sipas tyre, në lëndët profesionale ndodh që vijuesit janë shumë të suksesshëm, mirëpo kanë mangësi në lëndët e përgjithshme (‘Sh. Gjeçovi’). Një pjesë e vogël e tyre kanë interesim shumë të madh dhe mund të themi se vlerësohen bars me nxënësit e mësimin të rregullt, por kemi edhe të tillë që nuk dinë edhe aq mirë shkrim dhe lexim, por që në profesion janë të mirë dhe atyre u duhet një certifikatë patjetër, edhe pse problemet me shkrimin dhe leximin shkollat i kanë

edhe me nxënësit e mësimi të rregullt ('Gj. Gazuli'). Udhëheqësit deklarojnë se të rriturit kanë probleme me përpunimin e njohurive dhe praktikave të reja në mësimdhënie, meqenëse ata e kanë ndërprerë/ përfunduar shkollimin paraprak shumë më herët dhe tani kanë diferencë edhe në moshë. Me rëndësi është që ka ndryshime pozitive në nivelin hyrës dhe atë dalës në program, ka arritje (QK Malishevë).

Udhëheqësit e shkollave deklarohen se janë pak skeptikë sa i përket barasvlerës së diplomave të programeve të AARr-së me ato të mësimi të rregullt. Sugjerohet të rishikohen mundësitë që për këta persona të ofrohen diploma pune, jo diploma që mundësojnë studime në universitet.

Lidhur me këtë çështje, përfaqësuesja e zyrës për arsim joformal në MASHT deklaron se diplomat që të rriturit i fitojnë në programet e mësimi për të rritur janë dhe duhet të jenë të barasvlershme me ato të mësimi të rregullt. Përderisa një i rritur i nënshtrohet procesit të Maturës Shtetërore dhe e kalon atë me sukses, atëherë ai është i thirrur të ketë diplomën për këtë nivel të arsimit. Barasvlera e diplomës është përvojë e vendeve të rajonit dhe Kosova e ka marrë këtë model, mbetet të punohet më tepër në ngritjen e cilësisë.

Sipas udhëheqësve të shkollave, duhet rishikuar barasvlera e diplomave që u ofrohen vijuesve në këto programe.

5.2.14. Proceset aktuale dhe planet për realizimin e lidhur me AARr-së

MASHT-i aktualisht është i angazhuar në hartimin e Rregullores për grumbullimin dhe shpërndarjen e financave në shkollat e AARr-së, në draftimin e udhëzimeve administrative, në hartimin e Strategjisë për AAP dhe AARr, pjesë e cila do të integrohet në Strategjinë 2020.

Udhëheqësit e shkollave deklarojnë se aktualisht ata janë të interesuar që të krijojnë kushte edhe më të mira për realizimin e mësimi me të rriturit, sidomos në pajisjen e laboratorëve dhe punëtorive për realizimin e PP-së. Planet e tyre për të ardhmen janë që të vazhdohet me realizimin e këtyre programeve, meqenëse shkolla tanimë e ka një përvojë të mirë me këto programe ('Sh. Gjeçovi'), plane për t'i dhënë prioritet avancimit të cilësisë në këto programe dhe krijimin e kushteve për hartimin e materialeve mësimore nga ana e mësimdhënësve ('P. Bogdani'), rritjen e numrit të vijuesve në të ardhmen, por edhe caktimin e kriterëve për regjistrim (QK Malishevë), përshtatjen e programeve me kërkesat e tregut të punës ('A. Hadri'). Ka edhe shkolla që kanë dilema rreth vazhdimi të këtyre programeve në të ardhmen, meqenëse, sipas udhëheqësve, numri i vijuesve është gjithnjë në rënie, ndërsa obligimet e shkollës janë të mëdha rreth dokumentacionit dhe rreth krijimit të kushteve specifike për këto programe ('Gj. Gazuli').

Sipas përfaqësuesve të DKA-ve të intervistuar, proceset që DKA-të i realizojnë aktualisht në raport me AARr-në kanë të bëjnë me rishikimin e rregulloreve që rregullojnë pagesat dhe çështjet financiare në kuadër të këtyre programeve.

Sipas përfaqësuesit të agjencisë për AAP dhe AARr, proceset aktuale që realizon ky institucion i themeluar rishtas dhe që aktualisht është në fazën e pilotimit kanë të bëjnë me hartimin e planit strategjik për AAP-në. Aktivitetet e zhvilluara në fazën e pilotimit kryekëput u referohen specifikave të AAP-së në 6 Qendra të Kompetencës (përfshirë edhe shkollën 'Shtjefën Gjeçovi' në Prishtinë dhe shkollën '11 Marsi' në Prizren). Agjencia planifikon që në të ardhmen të ketë nën ombrellë të gjitha shkollat profesionale të Kosovës dhe të jetë bartëse e

të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me AAP-në dhe me AARr-në, përfshirë financat, buxhetin, cilësinë në infrastrukturë, burime njerëzore dhe materiale të shkollave etj.

5.3. Raportet e inspektorëve të arsimit, të nivelit rajonal për AARr-në

Për të plotësuar informacionin lidhur me mbarëvajtjen e proceseve arsimore dhe organizative në programet e AARr-së, në studim kemi përfshirë edhe shqyrtimin e raporteve të inspektorëve rajonalë të realizuara në vitin 2015 për këtë komponent. Për mostër të studimit kemi marrë raportet e inspektimit të dy rajoneve të Kosovës: Prishtinës dhe Ferizajt.

Shqyrtimi i raporteve të inspektimit për komponentin e AARr-së ka evidentuar se këto raporte bazohen në procesverbalet e mbajtura nga inspektorët me rastin e inspektimit në shkollat përkatëse profesionale.

*Raporti i inspektorëve për rajonin e Prishtinës*¹¹ informon se qëllimi i inspektimit ka qenë ‘Raportimi final për organizimin e arsimit për të rritur respektivisht atij joformal për periudhën e pasluftës për arsimin parauniversitar në regjionin e Prishtinës’¹².

Shkollat e AAP-së që në këtë rajon kanë ofruar programe të AARr-së sipas raportit rezultojnë të jenë 10: ‘Fan S. Noli’ në Podujevë, ‘28 Nëntori’ në Prishtinë, ‘Abdyl Frashëri’ në Prishtinë, ‘Hoxhë K. Prishtina’ në Prishtinë, ‘Fehmi Lladrovci’ në Drenas, ‘Isa Boletini’ në Podujevë, ‘Hasan Tahsini’ në Obiliq, ‘Shtjefën Gjeçovi’ në Prishtinë, ‘7 Shtatori’ në Prishtinë, ‘Gjin Gazuli’ në Prishtinë. Numri i vijuesve në periudhën 2006/07 deri në 2014/15 rezultojnë të jetë 10079.

Raporti i referohet periudhës së pasluftës në Kosovë dhe aspektet që trajtohen/shqyrtohen në këtë raport lidhur me AARr-në kanë të bëjnë me:

- Numrin e shkollave, nxënësve dhe profilet sipas shkollave dhe periudhës së realizimit të AARr-së;
- Periudhat e realizimit të AARr-së në shkollat përkatëse;
- Vijuesit e liruar nga pagesat në shkollat përkatëse;
- Numri i vijuesve të certifikuar në shkollat përkatëse;
- Numri i vijuesve që kanë përfunduar maturën në shkollën përkatëse;
- Shuma e pagesave për AARr-në specifikuar në vite në shkollën përkatëse.

Brenda dokumentit janë disa modele të raportimit për shkollat përkatëse:

- Raport në formën e statistikave tabelore për numrin e vijuesve në vitet dhe profilet përkatëse, numrin e vijuesve të liruar nga pagesa, numrin e vijuesve të certifikuar dhe për numrin e vijuesve të diplomuar (tabela të ndara);
- Raport në formën e statistikave tabelore të përmbledhura për numrin e vijuesve në profilet përkatëse (brenda një tabele);

¹¹ Raporti i Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, Sektori i Inspeksionit të Arsimit (SIA) në Prishtinë, Ref. 10/1- Nr. Prot. dt: 09.06.2015.

- Raport përshkrues/narrativ për numrin e vijuesve, profilet dhe periudhën e përfshirjes në rastet (në rastet kur kanë munguar tabelat statistikore për këto aspekte).

Pjesa e përmbledhjes së gjetjeve kryesore të raportit dhe rekomandimeve për përmirësim mungon në këtë raport.

Raporti i inspektorëve për rajonin e Ferizajt informon se programe të AARr-së në këtë rajon realizohen që nga viti 2007/08. Janë tri shkolla profesionale që ofrojnë këtë formë të mësimi: shkolla 'Pjetër Bogdani' në Ferizaj, shkolla 'Feriz Guri' dhe 'Vëllëzërit Çaka' në Kaçanik dhe shkolla 'Adem Gllavica' në Lipjan. Numri i vijuesve rezulton të jetë gjithsej 2700.

Aspektet që trajtohen/shqyrtohen në këtë raport lidhur me AARr-në kanë të bëjnë me:

- Numrin e shkollave, nxënësve dhe profilet sipas shkollave dhe periudhës së realizimit të AARr-së;
- Periudhat e realizimit të AARr-së në shkollat përkatëse;
- Informacion për stafin e mësimdhënësve të angazhuar në AARr;
- Përparësitë dhe mangësitë/sfidat e shkollave për realizimin e AARr-së.

Përveç prezantimit të specifikave, raporti ka edhe pjesën e përfundimeve për gjetjet kryesore gjatë inspektimit. Disa nga gjetjet dhe përfundimet kryesore të prezantuara në raport janë:

- Programet e AARr-së në rajonin e Ferizajt janë realizuar në harmoni me ligjet në fuqi;
- Moshë e vijuesve ka qenë dhe është mbi 18 vjeç;
- Stafi i mësimdhënësve është po i njëjti me atë të mësimi të rregullt;
- Dëshmi për mbarëvajtjen dhe regjistrimin e vijuesve janë librat e klasave, librat amë, procesverbalet, libri i diplomave të lëshuara;
- Shkalla ka përzgjedhur personin që e udhëheq këtë proces;
- Punohet me plane dhe programe të përshtatura/reduktuara për punën me të rriturit, të cilat plane dhe programe hartohen nga mësimdhënësit;
- Mësimi realizohet në dy forma, mësimi i rregullt dhe mësimi konsultativ, varësisht nga numri i vijuesve;
- Ka mungesë të literaturës për mësimin e rregullt dhe për AARr;
- Ka vonesa për pagesën e mësimdhënësve dhe vështirësitë për realizimin e të hyrave vetjake të shkollave;
- Etj.

Marrë në përgjithësi, gjetjet e prezantuara në raportet e inspektimit nuk përputhen me gjetjet e Institutit Pedagogjik të Kosovës, të prezantuara te kapitulli IV i këtij raporti lidhur me numrin e vijuesve dhe specifikat e tjera të AARr-së për shkollat përkatëse dhe referuar periudhës së njëjtë kohore. Pasqyra në vijim.

	Gjetjet e inspektorëve arsimorë						Gjetjet e IPK-së					
	2010/ 11	2011/ 12	2012/ 13	2013 /14	201 4/15	Gjith.	2010/ 11	2011/ 12	2012/ 13	2013/ 14	2014/ 15	Gjith.
28 Nëntori	161	34	399	263	68	925	96	56	102	102	64	420
H.K. Prishtina	613	649	585	502	177	2526	181	198	186	146	0	711
I.Boletini	56	117	73	98	98	442	54	117	73	98	0	342
P.Bogdani	315	302	295	173	201	1477	63	95	94	84	58	394

Vlen të përmendet edhe një herë që burim të informacionit për numrin e vijuesve dhe aspekte të tjera të prezantuara në raport IPK-ja i ka pasur librat amë të shkollave. Evidentimi, përpunimi dhe raportimi i të dhënave ka qenë një proces i realizuar së bashku me koordinаторët e AARr-së në këto shkolla (shih pikën 2.2., Metodologjia e hulumtimit te kapitulli II i raportit).

Për të dhënat e ofruara në raportet e inspektorëve arsimorë nuk figuron pjesa e metodologjisë së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, prandaj mbetet të ofrohen sqarime nga shkollat (burimi i informacionit) dhe inspektorët (përpunuesit) për saktësinë e të dhënave.

VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull prezantohen përfundimet lidhur me specifikat e programeve të mësimin për të rritur, të realizuar në shkollat e AAP-së, në periudhën 2010-2015, si dhe rekomandimet për avancim të praktikave të organizimit dhe realizimit të programeve të AARr-së në të ardhmen.

6.1. Përfundime

Analiza e legjislacionit dhe dokumenteve përcjellëse, e statistikave dhe gjetjeve të hulumtimit me aktorët e përfshirë në studim lidhur me programin e arsimit dhe aftësimin formal me të rritur, që realizohet në shkollat e AAP-së, informon se:

- **Baza legjislative për AAP-në dhe AARr-në:**

1. Rregullimi i sektorit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe nënsektorit të Arsimit dhe Aftësimin të të Rriturve (AARr) i nënshtrohet legjislacionit aktualisht në fuqi në Kosovë, përfshirë ligjet, udhëzimet administrative, strategjitë, rregulloret dhe dokumentacionin përcjellës;
2. Në periudhën 2010-2015 janë rishikuar tri ligjet kryesore që rregullojnë organizimin dhe realizimin e AAP -së dhe AARr-së:
 - ✓ Ligji për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011);
 - ✓ Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional (2013);
 - ✓ Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve (2013).
3. Mbi bazën e ligjeve, janë hartuar dhe rishikuar akte nënligjore, si:
 - ✓ UA 1/2014, Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional;
 - ✓ UA 13/2014, Plani vjetor i punës dhe plani zhvillimor i ofruesve të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur;
 - ✓ UA 2/2014, Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP-së, resurset dhe infrastruktura shkollore, siguria e nxënësve;
 - ✓ UA 16/2011, Kalimi i nxënësve të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin, ose prej një shkolle në shkollën tjetër;
 - ✓ UA 14/12, Testi pranues për shkolla të caktuara profesionale të nivelit 3 të ISCED-it;
 - ✓ UA 12/2014, Përjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur;
 - ✓ UA 11/2011, Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur;
 - ✓ UA 17/2013, Provimet dhe vlerësimet;
 - ✓ UA 5/2012, Qendrat e Kompetencës në Kosovë;
 - ✓ UA 21/2013, Mbarimi i shkollimit me sistem të vjetër arsimor;
 - ✓ UA 35/2013, Organizimi i provimit profesional përfundimtar;

- ✓ UA 11/2014, Përmbajtja e kontratës për organizimin e AARR për kandidatë dhe
- ✓ UA 31/2014 Njohja e mësimit paraparak (NJMP);
- ✓ 04/2015, Themelimi, funksionimi dhe përbërja e Këshillit për arsim dhe aftësim profesional dhe për të rriturit;
- ✓ 14/2014, Agjencia e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit të të rriturve në Kosovë.

Me gjithë këtë, ka ende mangësi në plotësimin e legjislacionit që rregullon proceset në AARR sa i përket mbledhjes dhe shfrytëzimit të të hyrave vetanake në shkolla. Deri më tani, rregullimi i pagesave për shërbimet e ofruara në program është bazuar në *Rregulloren për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake*, e cila është hartuar nga MASHT në vitin 2004, por që nuk është ende e miratuar nga institucionet përkatëse. Gjithashtu, ka edhe mosharminizim në mes të shkollave në modelin dhe shfrytëzimin e këtij dokumenti sa u përket çështjeve të pagesës.

Përveç ligjeve dhe udhëzimeve administrative, nga MASHT-i dhe partnerë bashkëpunues janë hartuar edhe dokumente të tjera strategjike mbështetëse të proceseve për këtë nënsektor të arsimit.

- ✓ Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, 2011;
- ✓ Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016, MASHT 2011.

Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim (SMIA) për regjistrimet e nxënësve në vitin shkollor 2011/12 deri në 2014/15 nxjerr në pah një rënie të lehtë të përfshirjes së nxënësve në AAP.

Rezultatet e studimit të realizuar informojnë se përfaqësuesit e DKA-ve dhe të shkollave nuk janë edhe aq të informuar dhe të familjarizuar me legjislacionin aktual në fuqi që rregullon aspekte të AARR-së. Nga ta, shpeshherë legjislacioni ngatërrohet me dokumentacionin e brendshëm apo të jashtëm shkollorë, konkretisht me librat amë, librat e protokolleve, planet dhe programet etj.

- **Statistikat për vijuesit e AARR-së për periudhën 2010-2015:**

- *Të dhënat për 36 shkollat e AAP-së, të cilat në periudhën 2010-2015 realizuan programe të arsimit dhe aftësimit formal për të rritur:*

- ✓ Në periudhën 2010-2015, programe të arsimit dhe aftësimit formal me të rriturit janë realizuar në 6 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Ferizaj, të përfaqësuara me 19 komuna dhe 36 shkolla profesionale nga komunat përkatëse;
- ✓ Numri i vijuesve në 36 shkolla të AAP-së ka qenë 15535, Komuna e Prishtinës ka avancuar me 2848, ose 18,3% vijues;
- ✓ Numri më i madh i vijuesve në programet e AARR-së figuron të jetë në vitin shkollor 2013/2014, me 1442 vijues ose 23,7%;

- ✓ Numri i përgjithshëm i vijuesve të diplomuar në 36 shkollat e AAP-së rezultoi të jetë 3267 vijues ose 21%. Krahasuar me përfshirjen në AARr, përqindje më e lartë e vijuesve /të diplomuar janë në komunën e Podujevës me rreth 55%;
 - ✓ Numri më i madh i vijuesve të diplomuar figuron të jetë në vitin 2013 me 1195 ose 36,6%. Në vitin 2014 kemi rënie për afro 9% të kandidatëve që kalojnë maturën krahasuar me vitin 2013.
- *Të dhënat për 15 shkollat e përfshira në mostër të studimit:*
- ✓ Dokumentacioni shkollor për evidentimin e regjistrimeve dhe të dhënave për vijuesit e programeve të arsimit dhe aftësimin formal për të rritur, shkollat e përfshira në studim shfrytëzojnë librat amë, të cilat janë të ngjashme me dokumentacionin shkollor për evidentimin e të dhënave për nxënësit e mësimin të rregullt;
 - ✓ Raportimi i statistikave për vijuesit nga shkollat në DKA është i rregullt, përderisa raportimi nga shkollat në MASHT zakonisht bëhet me rastin që MASHT-i i kërkon këto statistika;
 - ✓ Edhe pse UA 11/2011, *Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur*, rregullon obligimin e raportimit për çdo vit shkollor lidhur me përfshirjen e kandidatëve në AARr-së nga shkollat në DKA dhe nga DKA në MASHT, për periudhën 2010-2015, DKA-të dhe MASHT-i nuk kanë statistika për vijuesit e arsimit dhe aftësimin formal për të rritur për shkollat e AAP-së;
 - ✓ Për nevoja të studimit, DKA-të kanë ofruar vetëm listën e shkollave që në këtë periudhë kanë realizuar programe të arsimit dhe aftësimin formal me të rriturit në komunën përkatëse, ndërsa të gjitha statistikat për vijuesit janë siguruar drejtpërdrejtë nga shkollat;
 - ✓ Të dhënat për vijuesit, përveç evidencës për emër dhe mbiemër, në librat amë të AARr-së në shkolla ka mangësi në plotësimin e kërkesave për vitin e lindjes, vitin e regjistrimit, shkollimin paraprak të vijuesit (shkollën, klasën, profilin, suksesin dhe vitin e përfundimit) dhe të dhëna të tjera plotësuese;
 - ✓ Bazuar në evidencat e mbajtura në librat amë, numri i vijuesve në periudhën 2010-2015 në 15 shkolla ka qenë 6085, prej tyre të gjinisë femërore kanë qenë gjithsej 34,9% vijues;
 - ✓ Moshë e vijuesve me rastin e regjistrimit në programe të AARr-së me përqindje më të lartë ka rezultuar të jetë ajo 21-30 vjeç (26,5%), të moshës 15–17-vjeçare ishin gjithsej 16,31% e vijuesve, nuk ka dëshmi arsyetuese për regjistrim të vijuesve të kësaj moshe në AARr, ashtu siç e specifikon UA 12/2014 *Përfshirjet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur* (MASHT, 2014); përderisa për 4,5% të vijuesve mungon informacioni për moshën,
 - ✓ Numri i vijuesve që në AARr vijnë nga po e njëjta shkollë ka qenë 1406 (23,1%),
 - ✓ Viti 2013/14 prin për nga numri i vijuesve të regjistruar në program me 23,7%, për 2,7 të vijuesve mungon informacioni për vitin e regjistrimit në AARr;

- ✓ Suksesi nga shkollimi paraprak me përqindje më të lartë të vijuesve rezultoni të jetë me sukses të mjaftueshëm (29,3%) dhe me sukses të mirë (27,1%). Ndërsa për rreth 24% të vijuesve mungon ky informacion;
- ✓ Nxënës përsëritës kemi në shkollën 'Sh. Gjeçovi' (1 përsëritës), 'A. Hadri' (47 përsëritës) dhe 'H. Prishtina' (114 përsëritës);
- ✓ Pritjet më të gjata për regjistrim në AARr kanë qenë 2 deri në 5 vjet (19,1%). Me 0 vjet pritje kemi 12,8% të vijuesve. Edhe për këtë aspekt, në shkollat e përfshira nuk kemi hasur asnjë dëshmi të arsytimit të regjistrimit të vijuesve pa e kaluar së paku një vit për kalim nga mësimi i rregullt në AARr, ashtu siç është e rregulluar me UA 12/2014, *Përfshirjet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur (MASHT, 2014)*;
- ✓ Me përqindje më të lartë në program janë regjistruar vijues që paraprakisht e kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët, pra klasën 8 -të ose të 9-të (44,3%). Informacioni për klasën paraprake mungon për 26,2% të vijuesve;
- ✓ Kemi dominim të përqindjes së vijuesve të regjistruar në AARr në klasën e 10-të (55,5%), mungon informacioni për 20,9% të vijuesve lidhur me klasën e regjistruar në AARr;
- ✓ Në program vijuesit kanë treguar rezultate kryesisht të mjaftueshme mësimore (33,6%), mungojnë të dhënat për 27% të vijuesve;
- ✓ Klasa e përfunduar në programin e AARr-së me përqindje më të lartë të vijuesve rezultoi të jetë ajo e 13-të, me 31,8%. Për 23,7% mungon informacioni për klasën.
- ✓ Të certifikuar për nivele përkatëse për nivelin I kemi 415 vijues ose 12,7%, në nivelin II kemi 728 ose 22,2%, në nivelin III janë të certifikuar 2133 ose 65,1% e vijuesve. Për 1364 vijues mungon informacioni për nivelin e certifikimit;
- ✓ Numri i vijuesve që i janë nënshtruar Provimit Shtetëror të Maturës në periudhën 2010-2015 rezultoi të jetë 1464 ose 24,1 % e numrit të përgjithshëm. Përqindje më të lartë të përfshirjes kemi në vitin 2013 me 42,6%.

- **Opinionet e përfaqësuesve të institucioneve dhe shkollave për aspekte të AARr-së**

- *Baza legislative:*

- ✓ Përfaqësuesit e njësisë së AARr-së në MASHT, përfaqësuesit e DKA-ve dhe institucioneve të tjera janë të familjarizuar me ligjet dhe legjislacionin në fuqi dhe rregullimin e AARr-së e bazojnë kryesisht në Ligjin për AAP, në Ligjin për AARr dhe dokumentet përcjellëse që dalin nga këto ligje. Udhëheqësit dhe mësimdhënësit gjithashtu realizimin e AARr-së e bazojnë në dokumente legislative (ligje, UA dhe rregullore), por ka edhe nga ata që me legjislacion nënkuptojnë edhe dokumentacionin shkollor, si librat amë, librat e klasave, planeve dhe programeve mësimore etj.
- ✓ Përveç ligjeve, organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në shkollat e AAP-së është i rregulluar me UA 1/2014, *Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional*;

- ✓ Realizimit të programeve të AARr-së nuk i ka paraprirë ndonjë analizë e tregut të punës dhe e identifikimit të nevojave për profile/kuadro përkatëse profesionale. Shkollat e AAP-së që kanë kushte të mira kuadrovike dhe hapësirë të përshtatshme mund të ofrojnë programe të AARr-së, varësisht nga kërkesat e komunave, ndërsa MASHT-i vetëm informohet për këto programe;
 - ✓ Proceset që zhvillohen në programet e AARr-së janë të rregulluara me *UA 13/2014 të MASHT-it, Plani vjetor i punës dhe Plani zhvillimor i ofruesve të arsimit dhe aftësisimit formal për të rritur*;
 - ✓ Nga shkollat nuk potencohet ndonjë rol ose funksionim i theksuar i Këshillit të shkollës në raport me AARr-në. Ka raste kur ky këshill sugjeron për përzgjedhjen e koordinatorëve, apo postafit të mësimdhënësve të angazhuar në program.
- *Puna në AAP dhe akreditimi i tyre*
- ✓ Sipas MASHT-it, shkolla profesionale në Kosovë janë gjithsej 62, janë publike, të cilat ofrojnë mësim të rregullt dhe mësim për të rriturit;
 - ✓ Në vitin 2007, MASHT-i me një vendim i ka caktuar shkollat dhe profilet për AARr. Tani, me ligjin e ri, shkollat e AAP-së që kanë kushte të mira kuadrovike dhe hapësirë të përshtatshme, mund të ofrojnë programe të AARr-së, varësisht nga kërkesat e komunave, ndërsa MASHT-i vetëm informohet për këto programe;
 - ✓ Sa i përket akreditimit, shkollat e AAP-së ende nuk janë të akredituara në AKK. Vendimi për të hyrë në proces të validimit të kualifikimit dhe akreditimit të shkollave publike i takon MASHT-it. Kushtet dhe procedurat për validim të kualifikimit dhe akreditim të ofruesve të AAP-së janë të përcaktuara në Udhëzim Administrativ.
- *Konkursi dhe regjistrimi në AARr:*
- ✓ Programe të mësimit për të rritur shkollat ofrojnë dy herë brenda vitit kalendarik, të cilat pastaj realizohen gjatë ditëve të punës pasdite dhe në vikende, kryesisht të shtunave;
 - ✓ Regjistrimi i vijuesve është i rregulluar me ligj, janë caktuar kriteret, komunat dhe shkollat duhet t'i përshtaten ligjit;
 - ✓ Ka paqartësi rreth përgjegjësve dhe përgjegjësive lidhur me konkursin për regjistrim. Në shumicën e rasteve, shkollat rezultojnë të jenë hartuese të konkursit, DKA-të e publikojnë atë në faqet zyrtare të komunave përkatëse;
 - ✓ Shkollat informojnë vijuesit për ofertat programore dhe për kriteret për regjistrim përmes konkursit publik dhe shpalljeve në ambientet e shkollës;
 - ✓ Agjencia për AAP dhe AARr ende nuk është marrë me regjistrimet në AARr dhe në marrëveshje e ka edhe rregullimin e çështjeve të konkursit në të ardhmen;
 - ✓ Procedurat për regjistrimin e vijuesve janë të njëjta me ato të regjistrimit të nxënësve në mësimin e rregullt;
 - ✓ Shkollat nuk kanë një listë të unifikuar të kriterëve, prandaj interpretimi i ligjeve dhe UA-ve për këtë aspekt ndryshon nga shkolla në shkollë;

- ✓ Pranimit të vijuesve nuk i paraprin testimi pranues para regjistrimit të tyre në program dhe ka raste kur ata vlerësohen për njohuritë hyrëse në program, sidomos në shkrim – lexim. Ky vlerësim ka më tepër karakter të sistemit të tyre në profile, sesa vendimmarrje, për regjistrim ose jo të vijuesve;
 - ✓ Vijuesit vlerësohen nga komisioni pranues dhe nga mësimitdhënësit e tyre në provimet diferenciale para regjistrimit në program;
 - ✓ *UA 14/12, Testi pranues për shkolla të caktuara profesionale të nivelit 3 të ISCED-it*, pritet të zbatohet nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe e të Rriturve në të ardhmen.
- *Roli dhe detyrat e koordinatorit të AARr-së*
- ✓ Sipas MASHT-it, koordinatorët e AARr-së caktohen nga vetë shkollat. MASHT-i vetëm i ka rregulluar pagesat e personave të angazhuar në program.
 - ✓ Si pozitë nuk është e rregulluar me ndonjë legjislacion të veçantë. Meqenëse tani është një formë tjetër e organizimit të mësimin, MASHT-i në takimet me shkollat ka diskutuar që në funksion të avancimit të cilësisë shkollat të caktojnë koordinatorë të këtyre programeve, të cilët do të koordinojnë punët në program rreth regjistrimit të vijuesve, vijimit, mbarëvajtjes së mësimin, në përzgjedhjen e mësimitdhënësve etj;
 - ✓ Koordinatori ka rolin e një kujdestari të klasës;
 - ✓ Sipas shkollave, koordinatori përzgjidhet nga drejtori, duhet me qenë mësimitdhënës i shkollës, nuk ka kritere të shkruara për përzgjedhje, prandaj mbetet në të ardhmen rregullimi i detyrave, formës së përzgjedhjes dhe kritereve për angazhim në AARr.
 - ✓ Praktikantët e shkollave për përzgjedhjen e koordinatorëve dhe kohëzgjatjen e mandatit ndryshojnë nga shkolla në shkollë.
 - ✓ Sa i përket mandatit, ka raste kur koordinatori është përzgjedhur që nga koha e pasluftës dhe vazhdon ende me angazhimin në këtë cilësi;
 - ✓ Edhe detyrat dhe obligimet e koordinatorit të angazhuar nuk janë të rregulluara dhe me ndonjë dokument apo vendim të veçantë pune. Zakonisht detyrat e koordinatorit janë të barabarta me rolin dhe detyrat e një kujdestari të klasës;
 - ✓ Një vendim të lëshuar nga drejtori i shkollës (në bazë të autorizimeve dhe kompetencave), me rastin e emërtimit të koordinatorit të AARr-së, e kemi hasur vetëm te Qendra e Kompetencës në Malishevë.
- *Angazhimi i mësimitdhënësve në programet e AARr-së*
- ✓ Sipas MASHT-it, mësimitdhënësit e angazhuar në AARr janë mësimitdhënës të rregullt, nuk ka kritere të shkruara për përzgjedhjen e tyre, dhe marrëveshje e brendshme është që ata me qenë mësimitdhënës të suksesshëm;
 - ✓ Një pjesë të tyre janë përfshirë në punëtori apo seminare informuese lidhur me angazhimin e tyre në programet e mësimin me të rriturit;
 - ✓ Edhe shkollat deklarojnë se nuk ka kritere të caktuara për angazhimin e mësimitdhënësve në program dhe është me rëndësi që mësimitdhënësi të jetë i angazhuar edhe në mësimin e rregullt dhe të njëjtën lëndë ta realizojë edhe në

- AARr. Kryesisht angazhimi i mësimitdhënësve të interesuar në AARr bëhet me rotacion;
- ✓ Zhvillimin profesional të mësimitdhënësve/trajnimin në pesë vitet e fundit e kemi te programi Didaktikë/Metodikë dhe ECDL, përderisa vijues të seminareve apo punëtorive me karakter andragogjik rezulton të kemi vetëm 1,1%.
- *Format e organizimit/realizimit, informimi i vijuesve*
- ✓ Në programet e AARr-së deklarohet realizimi i orëve mësimore në lëndët e përgjithshme, si dhe realizimi i konsultimeve në mes të mësimitdhënësve dhe vijuesve individualë apo në grup;
 - ✓ Përdorimi i e-mailëve apo i rrjeteve sociale për dërgimin e informacionit dhe materialeve mësimore vijuesve nga e mësimitdhënësve është më pak i praktikuar në program. Mësimitdhënësit më tepër praktikojnë ofrimin e materialeve mësimore të shtypura vijuesve;
 - ✓ Vijuesit informohen kryesisht për planin dhe programin mësimor të programit dhe për afatet e provimeve, ndërsa më pak ky informim ndodh për kujdestarët e klasave përkatëse dhe për oraret e mësimit. Informimi ndodh përmes komunikimit verbal, përderisa praktikantët e informimit me telefon dhe shpalljet në tabelat e shkollës figurojnë të jenë më pak të shprehura në shkollë.
- *Dokumentacioni i brendshëm shkollor për nevojat e AARr-së*
- ✓ Shkollat kanë dokumentacion të brendshëm për realizimin e AARr-së, nuk është se ato ofrojnë një plan të mirëfilltë pune enkas për këtë kategori, por dokumentacioni i hartuar nga shkollat përmban orarin e mësimeve/konsultimeve, afatet e provimeve, lëndët përkatëse, listën e mësimitdhënësve;
 - ✓ Ky dokumentacion hartohet nga koordinatorët, diku-diku edhe me pjesëmarrjen e aktiveve profesionale. Ka raste kur shkollat e hartojnë dokumentacionin menjëherë pas shpalljes së konkursit publik, por ka edhe raste kur ky dokumentacion hartohet në faza deri në përfundim të programit. Publikohet brenda shkollës, por edhe në faqet zyrtare të shkollës etj. Edhe në këtë pikë, shkollat nuk janë aq sa dihet të familjarizuar me përmbajtjen dhe kërkesat e UA 13/2014, *Plani vjetor i punës dhe plani zhvillimor i ofruesve të arsimit dhe aftësisimit formal për të rritur.*
- *Planet dhe programet mësimore dhe tekstet/ literatura përkatëse*
- ✓ Reduktimi dhe përshtatja e planeve dhe programeve mësimore të mësimit të rregullt në ato për realizimin e mësimit me të rriturit ka qenë dhe mbetet ende sfidë e shumë shkollave që ofrojnë këtë formë të mësimit;
 - ✓ Shkollat shfrytëzojnë planet dhe programet e njëjta me ato të mësimit të rregullt, praktikantët më të shprehura janë kur planet dhe programet e mësimit të rregullt përshtaten nga mësimitdhënësit e lëndëve ose nga aktivitetet dhe ka pak bashkëpunim në mes të shkollave (qoftë edhe të atyre me profile të njëjta) në hartimin/përshtatjen e planeve dhe programeve mësimore për AAR-në.

- *Tekstet dhe materialet mësimore*
 - ✓ Shkollat përballen edhe me mungesën e teksteve dhe materialeve mësimore për mësimin e rregullt, por edhe për realizimin e AARr-së;
 - ✓ Alternativë është përdorimi i atyre pak teksteve dhe materialeve që i kanë në dispozicion dhe të cilat shfrytëzohen edhe në mësimin e rregullt, kombinimi i materialeve të tjera mësimore dhe teksteve që i kanë në dispozicion, hulumtimi i materialeve mësimore nga interneti dhe burime të tjera, si dhe hartimi i skriptave dhe materialeve të shtypura.

- *Bashkëpunimi/komunikimi në mes të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm*
 - ✓ Bashkëpunimi/komunikimi në mes të mësimdhënësve dhe vijuesve në AARr ndodh me rastin e takimit të tyre në shkollë, janë më të rralla bashkëpunimet/komunikimet e tyre përmes e-mailit, rrjeteve sociale, me telefon, apo takimeve jashtë shkolle;
 - ✓ Bashkëpunimi i shkollave me MASHT-in vlerësohet të jetë i mirë. Bashkëpunimi ndodh në realizimin e trajnimeve, takimeve me koordinatorët e programeve dhe bartjen e të gjitha politikave të shkollat, qoftë përmes DKA-ve apo përmes inspektorëve të arsimit, për aspektin e raportimit të statistikave nga shkollat në MASHT sa herë që MASHT-i i kërkon ato;
 - ✓ Sistemi i SMIA-s ende nuk ka hapësirë të veçantë për raportimin e AARr-së dhe kjo nga MASHT-i vlerësohet si nevojë që duhet përmbushur në të ardhmen;
 - ✓ Ka edhe mangësi në komunikimin me MASHT-in, meqenëse shkollat duhet të presin kohë të gjatë për të marrë përgjigje, konsultime, etj., ngase nga MASHT-i zakonisht nuk kthehet përgjigje e shpejtë;
 - ✓ Bashkëpunimi i shkollave me DKA-të përkatëse rezultojnë të jetë më i lehtë dhe më i mirë, zakonisht bashkëpunim lidhur me mësimin e rregullt. Për AARr-në shkollat raportojnë në DKA statistikën përkatëse;
 - ✓ Bashkëpunimi i shkollave të AAP-së me bizneset për realizimin e PP-së deklarohet si problem dhe sfidë edhe për nxënësit e mësimin të rregullt. Sa u përket të rriturve, ata rrallë kryejnë PP, meqenëse shumica e tyre janë të kyçur në biznese dhe paralel me punën e vijnë edhe AARr-në, me ç'rast ata sjellin dëshmi të vlerësimit nga punëdhënësi;
 - ✓ Bashkëpunimi i shkollave të AAP-së me agjencinë, shkollat të cilat janë nën ombrellën e agjencisë deklarojnë se kanë filluar të kenë bashkëpunim lidhur me AAP-në. Deri më tani këto shkolla janë përfshirë në programe të trajnimit të ofruara nga agjencia. Lidhur me AARr-në, me agjencinë shkollat kanë pasur vetëm konsultime dhe diskutime për format e realizimit të këtyre programeve në të ardhmen;
 - ✓ Meqenëse në fazën e pilotimit (2014/16), agjencia më tepër është marrë me Qendrat e Kompetencës në fushën e AAP-së, ndërsa me realizimin e programeve të mësimin për të rritur agjencia planifikon të merret në vitin 2015/16 e tutje;
 - ✓ Bashkëpunimi në mes të shkollave të AAP-së lidhur me AARr-në është jashtëzakonisht i pakët. Nuk ka bashkëpunim në hartimin e planeve dhe programeve mësimore, në vizita të ndërsjella, apo në këmbimin e literaturës përkatëse. Mes një

numri të vogël të shkollave me profile të njëjta, herë pas here ka këmbime të informacionit/konsultime lidhur dhe modelet e realizimit të AARr-së;

- ✓ Ka raste kur shkollat deklarohen sa shkolla e tyre nuk ka bashkëpunim me shkollat e tjera, të tjerët kanë bashkëpunim me ta, meqenëse ata vetë si shkollë konsiderojnë se janë model për realizimin e AARr-së;
- ✓ Bashkëpunimi MASHT-DKA është i rregulluara me Ligjin për AARr-në dhe me UA të dala nga ligjet. Bashkëpunimi me MASHT-in ndodh me rastin e raportimit të të dhënave për numrin e vijuesve të AARr-së, të cilat dërgohen në çdo fillim dhe në fund të vitit;
- ✓ Bashkëpunimi MASHT- Agjenci për AARr-në është në krijimin e politikave dhe zbatimin e tyre;
- ✓ Bashkëpunimi në mes të DKA-ve të komunave të përfshira në studim në raport me programet e AARr-së rezultoi se ka raporte të mira dhe koordinuese në mes të DKA-ve dhe se bashkëpunimi mes tyre ndodh zakonisht rreth konsultimit për legjislacionin dhe regjistrimeve në AAP dhe AARr;
- ✓ Bashkëpunimi i agjencisë me DKA-të deklarohet të jetë i mirë në raport me AAP-në dhe AARr-në. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes me DKA-të, të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë për shkollat e AAP-së kanë kaluar nga DKA-të në agjenci.

- *Praktika profesionale në AARr*

- ✓ Praktika profesionale në programet e mësimimit me të rritur realizohen në laboratorët e shkollave profesionale dhe në firmat ushtrimore të shkollave. Një numër i madh i vijuesve veç janë në marrëdhënie pune, prej nga edhe sjellin dëshmi me vlerësim pozitiv nga punëdhënësi për punën praktike.

- *Vlerësimi i rezultateve në AARr*

- ✓ Matja dhe vlerësimi i rezultateve mësimore bëhet kryesisht me teste, në laboratorët dhe punëtoritë e shkollës dhe përmes vrojtimit të drejtpërdrejtë të punës së tyre në klasë, si angazhimi individual, angazhimi në grupe të punës, në diskutime etj. Plotësimi i dosjes së vijuesit (portfolios) dhe vlerësimi i raportimit me shkrim/ gojë për tema të caktuara, hulumtime, vetëraportime etj. nuk potencohet të jenë praktikuar edhe aq në këto programe;
- ✓ Vlerësimi përfundimtar/certifikues i vijuesve rezulton të jetë përmes realizimit të testeve me vijues dhe vlerësimi të vijuesve në përgjigjet verbale dhe me shkrim. Vlerësimi i punës praktike të vijuesve nuk është deklaruar të jetë një praktikë e zbatuar në këto programe;
- ✓ Testet vlerësues me rastin e certifikimit për nivelin përkatës (vlerësimi përmbledhës) bëhet nga komisionet vlerësuese.

- *Pagesat për shërbimet dhe angazhimet në AARr*

- ✓ Pagesave për shërbimet e ofruara në programet e AARr-së (koordinatori, mësimdhënësit, drejtori, zv.drejtori dhe stafi tjetër i shkollës) janë të rregulluara

- me Rregulloren për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake të hartuar nga MASHT-i në vitin 2004;
- ✓ Kjo rregullore nuk është ende e miratuar dhe pritet rishikimi dhe miratimi i një rregulloreje të re për këtë aspekt;
 - ✓ Mbi bazën e rregullores së MASHT-it, shkollat kanë hartuar modelet e veta të rregulloreve dhe shpeshherë këto rregullore nuk janë të harmonizuara ndërmjet shkollave;
 - ✓ Rregulloret për mbledhjen dhe shpenzimin e të hyrave vetjake shumë pak i japin hapësirë rregullimit të mbledhjes së të hyrave, sidomos pagesës së vijuesve të arsimit dhe aftësisit formal të të rriturve, meqenëse rregulloret e shqyrtuara orientohen më tepër në rregullimin e formave dhe përqindjeve të shpërndarjes/shfrytëzimi të të hyrave vetjake të shkollave;
 - ✓ Pagesat e vijuesve për vijim të programeve të aftësisit formal për të rritur janë të rregulluara me UA 11/2011, *Participimi i vijuesve të arsimit dhe aftësisit për të rritur, të hartuar dhe miratuar nga MASHT-i në vitin 2011*;
 - ✓ Shkollat ende kanë mangësi në harmonizimin e konkurseve me UA në fjalë.
- *Kushtet e shkollave për realizimin e AARr-së*
- ✓ Kushtet e shkollave për realizimin e AARr-së vlerësohen si mesatarisht të mira.
- *Përparësitë, mangësitë dhe rekomandimet*
- ✓ Përparësitë që kanë shkollat për realizimin e këtyre programeve kanë të bëjnë me kushtet e objektit/infrastrukturës që ofrojnë shkollat dhe kualifikimin e kuadrit të për realizimin e këtyre programeve;
 - ✓ Vijuesit e vlerësojnë më lart formën e përshpejtuar në të cilën ofrohen këto programe;
 - ✓ Mangësi më e potencuar nga mësimdhënësit potencohet të jetë mosprezenca e gjithë vijuesve të regjistruar në program, përderisa vijuesit mangësi kryesore vlerësojnë të jetë mungesa e literaturës adekuate për program;
 - ✓ Rekomandimet për të ardhmen orientojnë në kërkesën për trajnimin e mësimdhënësve dhe stafit të angazhuar për programe të fushës së andragogjisë (të punës me të rriturit) dhe në sigurimin e teksteve dhe materialeve mësimore.
- *Proceset aktuale dhe planet për realizimin e lidhur me AARr-së*
- ✓ MASHT-i aktualisht është i angazhuar në hartimin e rregullores për grumbullimin dhe shpërndarjen e financave në shkollat e AARr-së, në draftimin e udhëzimeve administrative, në hartimin e strategjisë për AAP dhe AARr, pjesë e cila do të integrohet në Strategjinë 2020;
 - ✓ Shkollat aktualisht janë të interesuara që të krijojnë kushte edhe më të mira për realizimin e mësimin me të rriturit, sidomos në pajisjen e laboratorëve dhe punëtorive për realizimin e PP-së;

- ✓ Planet e tyre për të ardhmen janë që të vazhdohet me realizimin e këtyre programeve, meqenëse shkolla tanimë e ka një përvojë të mirë me këto programe;
- ✓ Ka edhe shkolla që kanë dilema rreth vazhdimit të këtyre programeve në të ardhmen, meqenëse, sipas udhëheqësve, numri i vijuesve është gjithnjë në rënie, ndërsa obligimet e shkollës janë të mëdha rreth dokumentacionit dhe rreth krijimit të kushteve specifike për këto programe;
- ✓ Proceset që DKA-të i realizojnë aktualisht në raport me AARr-në kanë të bëjnë me rishikimin e rregulloreve që rregullojnë pagesat dhe çështjet financiare në kuadër të këtyre programeve;
- ✓ Proceset aktuale që i realizon agjencia për AAP dhe AARr kanë të bëjnë me hartimin e strategjive dhe planit strategjik për AAP-në.
- ✓ Agjencia planifikon që në të ardhmen të ketë nën ombrellë të gjitha shkollat profesionale të Kosovës dhe të jetë bartëse e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me AAP-në dhe me AARr-në, përfshirë financat, buxhetin, cilësinë në infrastrukturë, burimet njerëzore, materialet e shkollave etj.

- **Raportet e inspektorëve arsimorë**

- ✓ Raportet e inspektorëve rajonalë të arsimit u referohen zhvillimeve në AAP, që nga periudha e pasluftës e deri më sot;
- ✓ Të dhënat e raportit të studimit të IPK-së për AARr-në nuk përkojnë me të dhënat e inspektorëve rajonalë, referuar të njëjtave shkolla dhe të njëjtës periudhë kohore të raportimit;
- ✓ Për të dhënat e ofruara në raportet e inspektorëve arsimorë nuk figuron pjesa e metodologjisë së grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave dhe mbetet të ofrohen sqarime nga shkollat (burimi i informacionit) dhe inspektorët (përpunuesit) për saktësinë e të dhënave.

6.2. Rekomandime

Bazuar në gjetjet kryesore të hulumtimit “*Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë, 2010/2015*” dhe me qëllim të avancimit të programeve të arsimit dhe aftësimin formal të të rriturve në shkollat e AAP-së në të ardhmen, janë nxjerrë rekomandimet në vijim:

- Mbi bazën e legjislacionit aktual në fuqi, të përmbyllet cikli i akteve nënligjore që rregullojnë aspekte të caktuara të AARr-së;
- Të hartohet rregullore përkatëse për mbledhjen dhe shpërndarjen e të hyrave vetjake të shkollave për programet e AARr-së;
- MASHT-i të iniciojë bashkëpunim më të madh me DKA-të dhe ndërmjet DKA-ve dhe institucioneve përkatëse, në raport me informimin për legjislacion dhe monitorimin e zbatimit të tij në fushën e AARr-së;

- DKA-të të iniciojnë bashkëpunim me agjencinë dhe shkollat dhe ndërmjet shkollave të AAP-së lidhur me çështje që kanë të bëjnë me organizimin dhe realizimin e AARr-së;
- Agjencia për AAP dhe AARr, përveç konsultimeve dhe trajnimeve fillestare, të fillojë të merret me programet e AARr-së që ofrohen në shkollat e AAP-së (sidomos të atyre që agjencia i ka nën ombrellë), specifikisht të ofrojë mbështetje në hulumtimin dhe analizën e tregut të punës dhe kërkesave për profile profesionale, në përpilimin dhe hapjen e konkurseve për AARr-në, hartimin e planeve dhe programeve mësimore, teksteve dhe materialeve mësimore, mbajtjen e evidencave dhe analizën e tyre, trajnimin në fushën e andragogjisë dhe aspektet të tjera të punës me të rriturit, dhe nënaspekte të tjera të parapara me *UA 14/2014, Agjencia e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit të të rriturve në Kosovë*.

Deri në funksionalizimin e plotë të agjencisë, shkollat e AAP-së duhet që:

- Të mbajnë evidenca të sakta për vijuesit e arsimit dhe aftësimin formal të të rriturve dhe t'i raportojnë ato rregullisht në DKA dhe në MASHT;
- Të bëjnë analiza të rregullta për trendët e kërkesave dhe përfshirjes në programet e AARr-së dhe mbi bazën e tyre të planifikojnë strategji të zhvillimit të këtyre programeve në të ardhmen, si pjesë e PZSHS-së së institucionit;
- Të integrojnë planifikimin e aktiviteteve të programeve të AARr-së në planet vjetore të përgjithshme të tyre;
- Të planifikojnë kritere dhe afate për regjistrimin e vijuesve në AARr, ashtu siç është e rregulluar me LAARr dhe me akte nënligjore përkatëse;
- Të hartojnë dhe të realizojnë teste vlerësuese për regjistrim të vijuesve në programin e AARr-së;
- Të hartojnë kritere për angazhim të stafit në programet e AARr-së (koordinatorët, mësimdhënësit dhe stafi tjetër mbështetës), si dhe të specifikohen detyrat dhe rolet që secili angazhim ka në program;
- Praktika profesionale me vijuesit e rritur, përveç laboratorëve, punëtorive dhe firmave ushtrimore në shkolla, të realizohet edhe në biznese dhe kompani private, me të cilat shkollat duhet të ndërtojnë partneritet dhe bashkëpunim reciprok;
- Të ketë bashkëpunim më të madh në mes të shkollave të AAP-së (sidomos të atyre me profile të njëjta profesionale) për harmonizimin e planeve dhe programeve, teksteve dhe materialeve mësimore, planifikimin mësimor dhe aspektet e të tjera në kuadër të AARr-së;
- Shkollat të krijojnë kushte të veçanta pune për mësimdhënësit e angazhuar në programet e AARr-së: pajisje të TIK-ut dhe qasja në internet, kabinete/kënde për punë dhe planifikim mësimor, material pune, fotokopje dhe materiale të tjera;
- Të zbatohet TIK-u në mësimdhënie dhe komunikim të ndërsjellë mësimdhënës-vijues;
- Të trajnohet stafi i mësimdhënësve për specifikat e punës me të rriturit (trajnime të fushës së andragogjisë);

- Të këmbëhen informacione, bashkëpunime dhe përvoja në mes të shkollave të AAP-së në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Praktikrat e mira të shkollave të diskutohen, adaptohen dhe përvetësohen nga shkollat në harmonizim me legjislacionin në fuqi.

Për inspektorët rajonal të arsimit:

- Të hartojnë formë të unifikuar të kërkesave të raportimit për procesin e inspektimit në shkolla, përfshirë metodologjinë e grumbullimit, përpunimit dhe raportimit të të dhënave, dëshmi/siguri dhe vërtetësi për të dhënat e raportuara etj;
- Të realizojnë inspektime të rregullta në AAP edhe lidhur me programet e AARr-së bazuar në UA 11/2005, *Procedurat administrative të inspektimit në institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore*.

Për Institutin Pedagogjik të Kosovës

- Të shtrihet mbështetja për analizën dhe raportimin e të dhënave për AARr-në edhe në shkollat që nuk janë përfshirë në studim,
- Të trajnohen mësimdhënësit për aspekte të Andragogjisë,
- Të inicohet analiza dhe hulumtimi i programeve në nivel shkolle,
- Të organizojë takime, informacione, fushata vetëdiesuese, promovime të AARr-së,
- Të mbështesë /bashkëpunojë me MASHT-in , DKA-të agjencionë, shkollat, organizatat për aspekte të AARr-së

Rekomandimet e dala nga takimi i mbajtur me rastin e prezantimit të raportit të studimit

Datë: 21.07.2015

Pjesëmarrës në takim: Përfaqësues të institucioneve arsimore, udhëheqës të shkollave, koordinatërë të AARr-së, mësimdhënës dhe vijues të AARr-së.

Rekomandimet:

- Të ndryshojë shumica e participimit të vijuesve në AARr sipas pikës së UA11/2011, ndërsa shumica e pagesës për praktikën profesionale të harmonizohet me shpenzimet e nevojshme për profilin përkatës;
- Të rishikohet mënyra e mbledhjes dhe e shpërndarjes së të hyrave të grumbulluara nga pagesat e vijuesve (mjetet të mos mbledhen dhe shpërndahen nëpërmes komunës);
- Të fuqizohet Udhëzimi administrativ për koordinator të cilësisë;
- Të respektohet afati i regjistrimit të vijuesve;

- Të njihet vendi i punës së koordinatorit të cilësisë me normë të plotë apo 50%;
- Obligimet e pagesës për kategoritë e liruara nga pagesa t'i mbulojë komuna ose institucioni përkatës, në mënyrë që shkolla të ketë mbulesë për pagesën e stafit të angazhuar në program;
- DKA-të të qartësojë mënyrën e zgjedhjes, funksionet dhe përgjegjësitë e koordinatorit të AARr-së në bashkëpunimi me Këshillin e Shkollës, drejtorin dhe MAShT-in;
